Rruga e Arbërit

www.rrugaearberit.com GAZETË E PAVARUR. NR. 2 (174) SHKURT 2021. ÇMIMI: 50 LEKË. 20 DENARË.

Bigmarket
DI ÇFARË ZGJEDH!
NË PESHKOPI
Çdo muaj me
SUPER OFERTA

AKTUALITET

Aksidentet e pahetuara rrisin pasigurinë në minierën e Bulqizës

Nga **SAMI CURRI** — Faqe 5

STUDIM / PJESA E FUNDIT

Të dhëna arkeologjike mbi disa fortifikime të periudhës së Skënderbeut

Nga prof. **ADEM BUNGURI** — Faqe 8-9

PORTRET

Mensur Shehu, pensionisti që bën punë të mëdha

Nga **OSMAN XHILI** — Faqe 7

IN MEMORIAM

Lamtumirë Nderi i Kombit, Agim Krajka!

Nga **SAIMIR SHATKU** — Faqe 23

Irena Puca, mësuesja e bukur

Nga **ARTAN GJYZEL HASANI** — Faqe 22

PARTITË POLITIKE NISIN FUSHATËN ME RIPREMTIMET PËR RRUGËN TIRANË-DIBËR

‘Rruga e Arbrit’, fushata e fundit e premtimeve?

Në fjalorin e politikanëve të qeverisë dhe opozitës, Rruga e Arbrit duket se do të jetë një çështje elektorale edhe këto zgjedhje parlamentare



Pamje nga traseja e rrugës së Arbrit në Xibër, Klos. Foto: © Hysen Uka 27 shkurt 2021

Hidrocentrali i Skavicës

Qeveria po punon për të ndërtuar variantin me digën më të lartë



Benet Beci: Projekti i Hidrocentralit të Skavicës do të jetë një investim publik. I vendosur në rrjedhën e sipërme të HEC-eve ekzistuese të kaskadës së lumit Drin dhe do të ketë ndikim në operimin e të gjithë kaskadës. Në këtë mënyrë është shumë e dobishme për vendin dhe sistemin tonë elektroenergjetik që ky projekt të jetë një investim publik. Për vlerësimin e efekteve që do të ketë ky projekt në mjedis, ekosistem dhe në popullsinë e zonës po realizohet një studim i kujdesshëm, i cili ndër të tjera do të përcaktojë edhe masat zbutëse/ kompensuese të nevojshme sipas praktikave më të mira ndërkombëtare”

— Faqe 3

Ibrahim Kaziu, mjeku që rron në mijëra emra dhe zemra

Nga **SHAQIR ÇERPJA** — Faqe 18

REAGIM

Ne, kalabardhasit, jemi lisa qindra shekullorë në tokën tonë amtare iliro-arbërore

Reagim rreth shkrimit “Golloborda dhe Dibra, një ngulmim për të krijuar një panoramë sa më të plotë dhe sa më të qartë njohëse historike””, shkruar nga Halil Teodori, tetor 2020.

Kalabardhasit janë 100% shqiptarë në gjak, në shpirt e në etnokulturë (norma e kanune, doke e zakone). Kjo është e vërteta e pakundërshtueshme. Në regjistrimin e vitit 1989, në Shqipëri nuk është regjistruar asnjë me kombësi bullgare, ndërsa 0.148% e popullsisë u regjistruan si maqedonas dhe ato jo në zonën tonë.

Sapo Shqipëria të bëhet vend i BE dhe nuk ka nevojë më kush për pasaportë sllave. Se të gjithë e dinë, se pasaporta bullgare kanë marrë më shumë shqiptarë nga Tirana, Elbasani, Durrësi, Shkodra, Fieri, Vlora etj., sesa kalabardhasit dhe të gjithë kanë ikur në vendet evropiane për punë, asnjë në Bullgari.

Nga **KADRI DAUTI** - Faqe 10-11

NË BRENDËSI:

■ Ansambli Artistik **“Hazis Ndreu”**- “Nderi i Kombit” në 10-vjetorin e krijimit ■ **100 vjet** në luftë për liri dhe dinjitet kombëtar ■ **Agim Krajka**: Amerika për mua është vetëm Shqipëria ■ **Bulqizë**, minatori 49 vjeçar humb jetën në galerinë e kromit ■ **Plagoset** një minator pas një aksidenti në galeritë e Albchrome ■ **Një minator** rregjistron në KQZ kandidaturën për deputet në Kuvend ■ **Denisi**, blegtori i ri, me ide të reja dhe punë arrin suksesin ■ Kontributi i **fisit Shehu** për çlirim kombëtar e përparim shoqëror ■ Botohet libri “Një jetë maleve, kujtime 4” me autor **Bashkim Lleshi** ■ “5 SKENARË…” të **Bujar Kapexhiut** ■ 70-vjetori i lindjes, publicistika dhe produkti letrar i **Mevlud Bucit** ■ **Sheh Iljazi** i Vleshës ■ “**Besa** e dibranit musteqekuq” ■ Poezi nga **Alide Lloga-Dika** dhe **Nuhi Shehu**

Gazeta “Rruga e Arbërit” është një media e lirë dhe e hapur.
Çdo kontribut me shkrime, abonime ose donacione është i mirëpritur!
Bëj pajtimin tënd me **PayPal** përmes emailit <rrugaearberit@gmail.com>
Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro.
Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.
Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.

Posta e Rruga e Arbërit

Gazetë e pavarur. Nr. 2 (174). Shkurt 2021
Gazeta doli nga shtypi, 3 Mars 2021.
Gjendet në treg gjatë gjithë muajit Mars 2021.

Redaksia e gazetës falënderon lexuesit dhe bashkëpunëtoret e saj për mesazhet dhe shkrimet e sjella për botim.

Kujtojmë bashkëpunëtorët, të cilët duan që shkrimet e tyre të botohen patjetër në numrin e radhës, të konfirmojnë më parë sjelljen e materialit në numrat e telefonit të redaksisë ose emailin e gazetës.

Shkrimet refuzohen për botim vetëm në rast se merrni përgjigje me email. Për çdo rast tjetër shkrimet priten për botim në numrat e radhës.

Shkrimet në redaksi për numrin e radhës priten deri më **datë 20** të muajit, përveç rasteve të bashkëpunëtorëve të rregullt.

Gjithashtu, ju **kujtojmë bashkëpunëtorëve se shkrimet deri në dy faqe daktilografike kanë përparësi botimi.**

GJITHASHTU, KUJTOJMË SE ÇDO SHKRIM I BOTUAR NË NJË MEDIA TJETËR APO RRJETE SOCIALE NUK KA PËRPARËSI BOTIMI.

JU LUTEMI, SHKRIMET QË VIJNË PËRMES EMAIL-it, TË KENË PATJETËR ZANOREN “ë”.

Ju falënderojmë që jeni pjesë e gazetës!

BOTUES:
Musa Riçku
Bujar Karoshi
Shaqir Skarra

Editor i faqes online: Agim Deva

Kontribuan për këtë numër:
Osman XHILI
Abdurahim ASHIKU
Sami CURRI
Esat RUKA
Artan GJYZEL HASANI
Adem BUNGURI
Muharrem GJOKA
Halil RAMA
Shaqir ÇERPJA
Saimir SHATKU
Albert ZHOLI
Kadri DAUTI
Agim VINCA
Rexhep BARDULLA
Lavderim SHEHU
Mehdi MARKU

KËRKOHEN KORRESPONDENTË NË PESHKOPI DHE DIBËR TË MADHE

Të interesuarit për korrespondentë/menaxherë duhet të kenë pasion gazetarinë. Përbën avantazh përvoja në shtypin e shkruar ose në qoftë se kanë mbaruar studimet për gazetari dhe letërsi / marketing. Të jenë të angazhuar për punën në grup dhe të jenë të pavarur politikisht gjatë kohës që bashkëpunojnë me gazetën.
Të interesuarit të shkruajnë email
në adresën <rrugaearberit@gmail.com>
ose të telefonojnë në numrin
069 20 68 603.

Arkivi i gazetës është PA pagesë në faqen e internetit **www.rrugaearberit.com.**
Falënderojmë z. **AGIM DEVA** për kontributin e vazhdueshëm për mirëmbajtjen e faqes së gazetës në internet dhe arkivin online.
Pajtimet në gazetë mund t’i bëni në çdo kohë duke komunikuar në adresat e redaksisë.
Bëj pajtimin tënd me **PayPal** përmes emailit
<rrugaearberit@gmail.com>
Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro. Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.
Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.
Për kontribute për gazetën mund të kontaktoni redaksinë ose mund t’i bëni ato përmes numrit të llogarisë më poshtë:
Raiffeisen Bank
Rruga e Arberit
Nr. llog. në lekë: 0010036640
IBAN: AL44 2021 1219 0000 0000 1003 6640

Adresa e gazetës:
Rr. “Zenel Baboçi”,
Pall. “Ferar”, Tiranë
Tel. +355 4 22 33 283
+355 69 20 68 603
E-mail: rrugaearberit@gmail.com

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e redaksisë

Çdo shkrim apo foto e botuar i nënshtrohet ligjit për respektimin e të drejtave të autorit. Ndalohet riprodhimi, fotokopjimi, shpërndarja apo ribotimi pa lejen e autorit të shkrimit apo redaksisë.

PARTITË POLITIKE NISIN FUSHATËN ME RIPREMTIMET PËR RRUGËN TIRANË-DIBËR

‘Rruga e Arbrit’, fushata e fundit e premtimeve?

Në fjalorin e politikanëve të qeverisë dhe opozitës, Rruga e Arbrit duket se do të jetë një çështje elektorale edhe këto zgjedhje parlamentare



Pamje nga traseja e rrugës së Arbrit në Xibër, Klos. Foto: © Hysen Uka

Rruga e Arbrit duket se do të jetë një çështje elektorale edhe këto zgjedhje parlamentare. Kryeministri i Shqipërisë Edi Rama dhe kandidatët për deputetë në Dibër nga ana e opozitës janë përfshirë në njoftime kontradiktore në lidhje me ecurinë e punimeve në Rrugën e Arbrit.

Si një tregues i “mbajtjes së premtimeve”, kryeministri Edi Rama postoi më 23 shkurt në faqen e tij të Facebookut një video prej 100 sekondash* që tregon punimet në Urën e Vashës që nga fillimi deri në ditën e përfundimit. Kjo video ka marrë mbi 800 ndarje dhe mbi 900 komente, të cilat sa janë optimiste dhe mbështetëse, po aq ka edhe kritika.

“Ky është një premtim i mbajtur nga Kryeministri, prandaj dibranët duhet të votojnë PS”, është një mesazh që përcillet nga një pjesë e madhe e komentuesve.

Një ditë më pas, më 24 shkurt, Dhurata Çupi Tyli, ish deputete e Dibrës dhe me sa duket do të jetë edhe numri 2 i listës së së deputetëve në këtë qark për zgjedhjet parlamentare të 25 prillit, përcolli në facebook një video prej 57 sekondash, në të cilën thekson se Edi Rama “dështoi me Rrugën e Arbrit”**

“Sa herë ka zgjedhje, Edi Rama mashtron dibranët për Rrugën e Arbrit. Në 8 vjet, ai dështoi në mënyrë të turpshme për të mbaruar Rrugën e Arbrit, e nisur nga PD që në vitin 2012. Premtime pas premtimesh të pambajtura të Edi Ramës dhe dibranët janë akoma më të izoluarit dhe më të braktisurit e kësaj qeverie të dështuar.”, shkruan ajo në Facebook.

“Kam qenë e bindur gjithmonë se Rrugën e Arbrit do ta përfundojë PD!”, thekson ajo.

Një ditë më pas, më 25 shkurt, ajo publikoi një video tjetër me pamje nga rruga e Arbrit, të cilat tregojnë punime të pambaruara***.

“Pamja sot nga Rruga e Arbrit. Asgjë e ngjashme me propagandën qeveritare. Rruga ngjan si vetë qeveria Rama, e lodhur, e copëtuar, pa shpresë.

Sipas premtimit të Edi Ramës, rruga duhet të jetë e përfunduar tërësisht për më pak se 3 muaj. E vërteta është se rruga-shpëtim e dibranëve, me ritmin e Edi Ramës, nuk përfundon as vitin tjetër. Ne na duhet Rruga e Arbrit për t’i dhënë fund izolimit dhe zbrasjes së qarkut të Dibrës nga njerëzit në këto 8 vjet dështim të Edi Ramës”, shkroi Dhurata Çupi Tyli në profilin e saj në Facebook.

* * *

Ndërtimi i rrugës së Arbrit, që nga ideja deri në realizimin e saj ka kaluar përmes një procesi politik të gjatë: plot me premtime dhe afate përfundimi. Edhe tani kur ajo po shkon drejt përfundimit - sado që jo në standardet e kërkuara, përfshirja në debatin parazgjedhor duket se do të jetë i pranishëm edhe këtë herë.

Që prej korrikut të vitit 2005, kur kryeministri i asaj kohe, Fatos Nano nisi punimet në Fushë-Bulqizë një javë para zgjedhjeve, për 16 vite me radhë rruga e Arbrit është përfshirë në fjalorin elektoral përmes premtimesh, të cilat kanë rezultuar gënjeshtra të radhës.

Më poshtë po sjellim disa deklarime publike vetëm të Kryeministrit të Shqipërisë, që nga viti 2004, në lidhje me premtimet për nisjen dhe përfundimin e punimeve në Rrugën e Arbrit.

1. Kryeministri Fatos Nano, Peshkopi, 26.10.2004: “Vitin e ardhshëm do të fillojnë punimet për Rrugën e Arbrit. Kjo rrugë do të kushtojë 120 milion dollarë dhe distanca juaj me tregjet kombëtare dhe rajonale do të shkurtohet ndjeshëm, ndërsa rruga Peshkopi-Tiranë nga 180 km që është aktualisht do të jetë vetëm 72 km. Qeveria shqiptare për mirëmbajtjen e kësaj rruge ka marrë një kredi prej 72 milion lekë nga Banka Botërore.”.

2.Kryeministri Sali Berisha, Bulqizë, shkurt 2007: “Në mandatin 4 vjeçar ju jap fjalën se Rruga e Arbrit është prioritet absolut dhe kombëtar për qeverinë.”

3. Kryeministri Sali Berisha, Bulqizë, 21 qershor 2009: Sapo inauguruam segmentin e parë të rrugës së Arbrit me një gjatësi 20 km. Në datën 15 (qershor) u shpall tenderi për segmentin tjetër Bulqizë-Klos dhe unë ju garantoj se brenda vitit do të nisë edhe Klos-Tiranë, Tiranë-Klos.

4.Kryeministri Sali Berisha, Bulqizë, 28 gusht 2009: “Dua t’u garantoj Ju se në krye të dy viteve, do të vini në Tiranë dhe do të zbrisni drejt brigjeve të Shqipërisë, në rrugën më të re të Ballkanit, në rrugën e Arbrit. Ju garantoj se në 2 vjet kjo rrugë do të kapë Tiranën dhe ju do të zbrisni në Tiranë në një kohë prej 40 deri në 60 minuta”.

5. Kryeministri Edi Rama, Beograd, 16 dhjetor 2014: “U nënshkrua memorandumi i bashkëpunimit me Chinese Exim Bank për hapjen e një kantieri projektesh në Shqipëri me financime kineze. Projekti i parë që do të çelë siparin e një epoke të re bashkëpunimi mes Shqipërise e Kinës do të jetë Rruga e Arbrit, e cila do të nise vitin e ardhshëm”.

6. Edi Rama, Bulqizë, 8 Qershor 2015: “... me këtë tunel jepet edhe mesazhi shumë i qartë për gjithë Dibrën, që rruga e Arbrit nuk është më një fantazmë elektorale që shfaqet vetëm nëpër fushata, por është një realitet mbi të cilin ne po punojmë fort. Kemi siguruar edhe financimin për pjesën më të vështirë, me një kompani ndër më të mëdhatë e Kinës.



7. Edi Rama, Pekin, 27 nëntor 2015: “Takimi me kryeministrin për të diskutuar ecurinë e projekteve të përbashkëta mes Shqipërisë dhe Kinës; finalizimin sa më parë të negociatave financiare për të nisur punimet në Rrugën e Arbrit”.

8. Kryeministri Edi Rama, postim në Facebook, 12 prill 2017: “Projekti i parë i Programit Kombëtar 1 Miliardë për Rindërtim hyri sot në fazën finale: RRUGA E ARBERIT. Pas 25 vjetësh premtime boshe e zhgënjime pas çdo votimi, viti 2017 është viti i nisjes së punës për këtë aks, që e bën Dibrën fqinje të afërt të Tiranës dhe do t’i japë hov zhvillimit ekonomik, social e turistik të një zone të tërë bukurish e burimesh të jashtëzakonshme natyrore, që për çerekshekulli u la në rrënimin e harresës”.

***

Kontrata me kompaninë Gjoka Konstruksion për ndërtimin e Rrugës së Arbrit u firmos në fillim të vitit 2018, ndërsa më 28 mars qeveria shqiptare e miratoi kontratën në mbledhjen e Këshillit të Ministrave. Ndërsa punimet kishin nisur, zyrtarisht ato nisën në Klos më 17 qershor 2018. Pavarësisht se afati i kontratës është 44 muaj (rreth 4 vite) në ceremoninë e inaugurimit, presidenti i kompanisë Rrok Gjoka premtoi se “punimet do të mbarojnë për dy vite”, periudhë e cila përkon me zgjedhjet parlamentare të këtij viti. Vështirësitë e krijuara në tunelin e Murrizit mund ta shtyjnë afatin e përfundimit të punimeve, por premtimi për nisjen e qarkullimit mund të mbahet edhe para zgjedhjeve. Dhe për këtë u desh ndërtimi i një by-passi rreth 9.5 km të gjatë.

Në projekt rruga është e parashikuar sipas strandardit C2, me dy korsi lëvizje nga 3.5 metra dhe shpejtësi 60 deri 100 km/orë.

Nisja e qarkullimit në rrugë para zgjedhjeve parlamentare mund të jetë një kërkesë apo dëshirë e qeverisë, por standardet e ndërtimit dhe të sigurisë në qarkullim janë më të rëndësishme për përdoruesit e rrugës.

BUJAR KAROSHI

**https://fb.watch/3-n9WfxYX3/*
***https://www.facebook.com/1642908865/videos/10222085419758180/*
****https://www.facebook.com/1642908865/videos/10222090978217138/)*

aktualitet

"Zhvillimi i projekteve të kësaj natyre shoqërohet me një ndikim social-mjedisor në zonën e cila preket nga projekti. Edhe në këtë rast, ndërtimi i hidrocentralit të Skavicës do të shkaktojë përmbytje në zonën ku do të krijohet rezervuari. Për vlerësimin e efekteve që do të ketë ky projekt në mjedis, ekosistem dhe në popullsinë e zonës po realizohet një studim i kujdesshëm, i cili ndër të tjera do të përcaktojë edhe masat zbutëse/kompensuese të nevojshme sipas praktikave më të mira ndërkombëtare"

HEC Skavica, qeveria po punon për të ndërtuar variantin me digën më të lartë

Benet Beci: Projekti i Hidrocentralit të Skavicës do të jetë një investim publik. I vendosur në rrjedhën e sipërme të HEC-eve ekzistuese të kaskadës së lumit Drin dhe do të ketë ndikim në operimin e të gjithë kaskadës. Në këtë mënyrë është shumë e dobishme për vendin dhe sistemin tonë elektroenergjetik që ky projekt të jetë një investim publik.

"Ndërtimi i hidrocentralit të Skavicës nuk do të ketë vetëm efekte negative në mjedis, ekosistem dhe në popullsinë e zonës ku do të krijohet rezervuari, por do të ketë edhe shumë efekte pozitive në këtë zonë, madje efektet pozitive do të jenë dominuese. Konkretisht, zhvillimi i këtij projekti është një mundësi e jashtëzakonshme për zhvillimin ekonomik dhe punësimin në këtë zonë. Gjatë fazës së ndërtimit do të ketë një punësim masiv direkt, por edhe indirekt të banorëve të zonës".



"Projekti për ndërtimin e Hidrocentralit të Skavicës ka ngjallur interes të lartë te donatorët dhe financuesit e mundshëm. Hidrocentrali, që do ta kthente vendin në një lider rajonal në prodhimin e qëndrueshëm të energjisë, vlerësohet të kushtojë midis 308 deri në 510 milionë euro, në varësi të lartësisë së digës" shkruan revista "Monitor" që botohet në Tiranë me fokus ekonominë, në hyrje të një interviste me z. Benet Beci, administrator i Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare (KESH).

Beci i thotë revistës "Monitor" se "projekti i Hidrocentralit të Skavicës do të jetë një investim publik. Hidrocentrali i Skavicës do të jetë i vendosur në rrjedhën e sipërme të HEC-eve ekzistuese të kaskadës së lumit Drin dhe do të ketë ndikim në operimin e të gjithë kaskadës. Në këtë mënyrë është shumë e dobishme për vendin dhe sistemin tonë elektroenergjetik që ky projekt të jetë një investim publik."

Drejtori i KESH thotë se "kostot e vlerësuara deri në fazën e parafizibilitetit për këtë projekt janë respektivisht 308 milionë euro për alternativën me digë të ulët (deri në kuotën 388 m.m.n.d) dhe gati 510 milionë euro për alternativën me digë të lartë (deri në kuotën 443 m.m.n.d).".

Duke iu përgjigjur pyetjes mbi burimet e financimit për Skavicën, Beci thotë se "burimet e financimit për projektin janë ende duke u diskutuar mes Qeverisë Shqiptare dhe donatorëve të mundshëm. Deri tani mund të pohojmë se ka interes të lartë për financimin e veprës, si një ndër investimet më të mëdha të mundshme në rajon, në burimet e energjisë së rinovueshme".

Në vazhdim të intervistës, drejtori i KESH thotë se "ky projekt e shlyen vlerën e investimit brenda dekadës së parë pas vendosjes në funksionim. Nëse marrim në konsideratë faktin që jetëgjatësia e këtyre investimeve është deri në 100 vite, atëherë duket qartë leverdishmëria ekonomike e investimit".

"Së pari, prodhimi i energjisë elektrike: aktualisht Shqipëria, në një vit mesatar, importon energji elektrike në sasi të konsiderueshme dhe prodhimi i pritshëm i hidrocentralit të Skavicës, i cili do të jetë deri 1,000 Gwh/vit do të kontribuonte ndjeshëm në reduktimin e importit dhe në sigurinë energjetike të vendit. Nga ana tjetër, leverdishmëria e këtij projekti qëndron në optimizimin e prodhimit të energjisë elektrike nga hidrocentralet ekzistuese të kaskadës së lumit Drin. Kjo lidhet me faktin që hidrocentrali i Skavicës do të jetë hidrocentrali i parë i vendosur në kaskadën e lumit Drin dhe ndërtimi i tij do të ketë ndikim dhe në hidrocentralet e tjerë të kaskadës".

Beci mbështet ndërtimin e alternativës me digë më të lartë. "Do të kishte një efekt të konsiderueshëm në optimizimin e prodhimit në hidrocentralet ekzistuese të kaskadës së lumit Drin, ku vlerësohet se hidrocentralet ekzistuese mesatarisht do të prodhojnë 80 GËh/vit më shumë energji elektrike nëse Skavica zhvillohet sipas kësaj alternative", thotë Beci në intervistën për ekonomiken "Monitor".

Duke iu referuar ndikimeve në mjedis, ekosistem dhe popullsinë e zonës, drejtori i KESH thotë se për këtë "po realizohet një studim i kujdesshëm".

"Zhvillimi i projekteve të kësaj natyre shoqërohet me një ndikim social-mjedisor në zonën e cila preket nga projekti. Edhe në këtë rast, ndërtimi i hidrocentralit të Skavicës do të shkaktojë përmbytje në zonën ku do të krijohet rezervuari. Për vlerësimin e efekteve që do të ketë ky projekt në mjedis, ekosistem dhe në popullsinë e zonës po realizohet një studim i kujdesshëm, i cili ndër të tjera do të përcaktojë edhe masat zbutëse/kompensuese të nevojshme sipas praktikave më të mira ndërkombëtare"

"Vlen të theksohet - thotë Benet Beci, se ndërtimi i hidrocentralit të Skavicës nuk do të ketë vetëm efekte negative në mjedis, ekosistem dhe në popullsinë e zonës ku do të krijohet rezervuari, por do të ketë edhe shumë efekte pozitive në këtë zonë, madje efektet pozitive do të jenë dominuese. Konkretisht, zhvillimi i këtij projekti është një mundësi e jashtëzakonshme për zhvillimin ekonomik dhe punësimin në këtë zonë. Gjatë fazës së ndërtimit do të ketë një punësim masiv direkt, por edhe indirekt të banorëve të zonës".

Shoqata për Mbrojtjen e Pellgut të Drinit të Zi vazhdon të protestojë për ndërtimin e Skavicës. Muajin e kaluar nisën një peticion në drejtim të autoriteteve më të larta në vend, por deri më tani nuk kanë marrë asnjë përgjigje. Asnjë prej institucioneve më sipër nuk ka kthyer një përgjigje, duke vështirësuar hapësirat për protestën e tyre. Aktet normative të qeverisë shqiptarë në lidhje me situatën e pandemisë kanë penguar ushtrimin e të drejtës për të protestuar. Dy anëtarët e saj janë penalizuar me gjobë prej 5 milionë lekësh.

"Pas përfundimit të ndërtimit, shfrytëzimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit do të krijojë vende pune të cilat do të jenë të qëndrueshme dhe cilësore... Veç punësimit, ndërtimi i hidrocentralit të Skavicës do të krijojë kushte të favorshme edhe për zhvillimin e sektorëve të tjerë të ekonomisë, si turizmi apo peshkimi. Ndërtimi i hidrocentralit të Skavicës do të shoqërohet me një infrastrukturë të përmirësuar. Në këtë drejtim do të kemi ndërtime të reja në infrastrukturë, si ura, rrugë, qendra banimi, godina shërbimesh, qendra shëndetësore, arsimi etj.".

Duke folur për përfitimet ekonomike, drejtori i KESH thotë se "hidrocentrali i Skavicës do të reduktonte mesatarisht 55% importet vjetore të energjisë elektrike".

* * *

Shoqata për Mbrojtjen e Pellgut të Drinit të Zi vazhdon të protestojë për ndërtimin e Skavicës. Një peticion i nisur muajin e kaluar në drejtim të autoriteteve më të larta në vend, Presidentit të Republikës, Kryeministrit të Shqipërisë, Kryetarit të Parlamentit Shqiptar, Ministrit të Energjisë dhe Infrastrukturës, Ambasadores së SHBA në Tiranë dhe kompanisë amerikane "Bechtel", ku kërkojnë ndalimin e planeve për ndërtimin e HEC të Skavicës, duket se nuk ka sjellë reagimin e duhur. Asnjë prej institucioneve më sipër nuk ka kthyer një përgjigje, duke vështirësuar hapësirat për protestën e tyre. Aktet normative të qeverisë shqiptarë në lidhje me situatën e pandemisë kanë penguar ushtrimin e të drejtës për të protestuar. Dy anëtarët e saj janë penalizuar me gjobë prej 5 milionë lekësh.

Tani që ka filluar realisht edhe fushata elektorale për zgjedhjet parlamentare të 25 prillit, pritet që debati për ndërtimin e HEC të Skavicës të jetë më i prekshëm. Opozita, e cila në çdo gjë kundërshton qeverinë, për HEC-in e Skaviës është duke heshtur. I vetmi kundërshtim i saj duket se është në terren dhe kjo lidhet me çmimet e shpronësimeve.

Gjatë këtij muaji, edhe Kryeministri Edi Rama ka folur për ndërtimin e HEC të Skavicës.

"Ne jemi në proces, në bashkëpunim me qeverinë amerikane, për ndërtimin e Skavicës", tha kryeministri Edi Rama në Fier, gjatë një turi takimi bashkëbisedimi me qytetarët më 20 shkurt 2021.

Ndërsa më 26 shkurt, gjatë një takimi të ngjashëm në Berat, duke folur për investimet në energji, tha se "kemi investimin tjetër të rëndësishëm për Skavicën nga kompania amerikane, që do të jetë dhe një ndryshim i madh i profilit të sektorit të energjisë sonë, sepse më në fund do të kemi atë që mungon në Kaskadën e Drinit, që është balancuesi i ujit. Kur kemi ujë më shumë sesa na duhet, nuk e derdhim, por e ruajmë dhe kur nuk kemi shi sa duhet, e fusim në përdorim. Kështu kemi një tjetër mundësi për të eksportuar dhe njëkohësisht nuk jemi të lidhur skallvërisht me qiellin, po nuk ra shi, në thatësirë, në pikun e energjisë të importojmë me çmime të kripura".

* * *

Por deri më tani në Dibër askush nuk po flet për Skavicën: problematikat që sjell dhe përfitimet për banorët, sidomos ata që shpërngulen. Për këtë, me sa duket do të flitet disa ditë para votimeve të 25 prillit, atëherë kur gënjeshtra dhe e vërteta kalojnë përmes premtimesh.

Të plotë intervistën e Drejtorit të KESH e lexoni këtu: https://www.monitor.al/skavica-mund-te-kushtoje-midis-308-dhe-510-milione-euro-2/?fbclid=IwAR2eOXJf_MC-z54Cm3s29DI3W38TE7XD97qe-1o4Vv7Vgm0j-HkoJbyj90oU

Bulqizë, minatori 49 vjeçar humb jetën në galerinë e kromit

24 shkurt 2021. Një 49-vjeçar humbi jetën, pasi u zu poshtë prej një masivi gurësh në galerinë e kromit të kompanisë "Kaci shpk" në Zonën D të minierës së Bulqizës. Sipas Drejtorisë Vendore të Poliisë në Dibër, ngjarja ka ndodhur rreth orës 12:10. "Në galerinë e një miniere kromi, dyshohet se gjatë punës është aksidentuar dhe për pasojë ka humbur jetën shtetasi F. K., 49 vjeç."

Minatori që humbi jetën ishte babai i katër fëmijëve, me banim në fshatin Kokërdhak të njësisë administrative Fushë-Bulqizë.

Vetëm pak muaj më parë në galeritë e kromit në Selishtë të Dibrës humbën jetën 2 minatorë dhe një inxhinier minierash, teksa ishin duke punuar.

Shkak për aksidentet me pasoja fatale në miniera është mungesa e kushteve të sigurisë në punë, pasi prej vitesh në galeritë nuk investohet nga firmat që i shfrytëzojnë. Zona D ku ndodhi aksidenti, është cilësuar në vazhdimësi nga specialistët e minierës si më e pasigurta dhe me numrin më të lartë të aksdienteve të ndodhura në minierën e Bulqizës.

Bilancit tragjik të aksidenteve në miniera iu shtuan pesë të vdekur dhe 28 të plagosur gjatë vitit 2020, por vetëm gjysma e rasteve u inspektuan dhe hetuan nga AKSEM.

Qarku i Dibrës, ku ndodhet miniera e Bulqizës, mban vendin e dytë për numrin e lartë të aksidenteve dhe të fatalitetëve në vendin e punës pas Tiranës. Gjatë vitit 2020, Inspektoriati Shtetëror i Punës raportoi se 7 persona humbën jetën dhe 27 të tjerë u aksidentuan në vendin e punës në këtë qark. Pesë prej viktimave ishin minatorë. *(bulqizaime.al)*

Arrestohet armatori dhe procedohet brigadieri i kompanisë

25 shkurt 2021. Drejtoria Vendore e Policisë në Dibër njoftoi se është arrestuar armatori i subjektit minerar, si dhe është proceduar penalisht brigadieri, pas vdekjes së minatorit 49-vjeçar në Bulqizë.

"Ç. D, 61 vjeç, banues në Bulqizë, (me detyrë armator në një subjekt minerar në zonën D), si dhe filloi procedimi penal në gjendje të lirë për shtetasin F. K., 50 vjeç, banues në Bulqizë, (me detyrë brigadier), për veprën penale "Shkelja e rregullave të mbrojtjes në punë", thuhej në deklaratën e Policisë.

"Personat e mësipër kanë pasur si detyrim ligjor kontrollin e vazhdueshëm të gjendjes teknike të galerisë. "Ku si pasojë e neglizhencës së tyre, mesditën e datës 24.02.2021, në një nga nënkatet e subjektit minerar, është shembur një pjesë armature duke i shkaktuar vdekjen një 49-vjeçari (me detyrë vagonist)."

Materialet për aksidentin i kanë kaluar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Dibër, për veprime të mëtejshme. *(bulqizaime.al)*

Bëj një abonim online ose në print...

Kushton vetëm 600 lekë në vit...

email: rrugaearberit@gmail.com



Minator gjatë montimit të minave dhe ndezjes së tyre për hapjen e forntit të ri të punës, në Minierën e Bulqizës. Foto Ilustruese:Geri Emiri / reporter.al

Plagoset një minator pas një aksidenti në galeritë e Albchrome

Kompania: Minatori është plagosur për shkak të pakujdesisë.Ai ka frakturë të lehtë të pjesës së sipërme të këmbës së djathtë.

1 mars 2021. Një minator u plagos në galeritë e menaxhuara nga Albchrome në Minierën e Bulqizës. Policia e Dibrës njoftoi se ngjarja ka ndodhur rreth orës 12.40 të datës 1 mars, "se gjatë punës është aksidentuar dhe për pasojë ka mbetur i lënduar shtetasi A. Gj". Burime nga spitali i Bulqizës bëjnë me dije se i plagosuri kishte dëmtime në këmbë, fraktura të thyerjes se kockave dhe është dërguar drejt spitalit të Traumës, Tiranë për ndihmë më të specializuar dhe është jashtë rrezikut për jetën.

Sindikata e Minatorëve të Bashkuar të Bulqizës e identifikoi minatorin si Agron Gjeta, dhe tha se ai ishte aksidentuar gjatë punës në sektorin e transportit të brendshëm. "Kërkojmë hetim serioz të aksidentit dhe kushteve të sigurisë teknike. Ky aksident i ndodhur në minierën e Albchrome, nuk është rast i rrallë, as i veçuar. Pavarësisht propagandës për "investime të jashtëzakonshme", Albchrome është shndërruar nga minierë kromi në minierë aksidentesh", - thuhet në njoftimin e sindikatës.

Galeria ku ndodhi aksidenti menaxhohej nga kompania AlbChrome –pjesë e grupit Balfin, që është koncensionari më i madh në zonën e Bulqizës. E pyetur nga mediat, kompania tha se minatori ishte plagosur për shkak të pakujdesisë. "Në turnin e parë të punës në nivelin e 17-të të minierës të administruar nga AlbChrome në Bulqizë, gjatë procesit të levizjes së vagoneve, për shkak të pakujdesisë së punonjësit A. Gj, 51 vjeç, me profesion manovrues vagonash (ndihmës elektrovozist), ky i fundit pësoi një lëndim të lehtë", - thuhet në reagimin e Albchrome.

Kompania Albchrome the se minatori i lënduar ka frakturë të lehtë të pjesës së sipërme të këmbës së djathtë.

Ndërkohë SMBB deklaron se investimet e Albchrome për të rritur prodhimin e kromit, nuk kanë shkuar në linjë me rritjen e sigurisë së minatorët. "Përkundrazi, rritja e prodhimit është rrezik i shtuar për punëtorët dhe koha po e tregon", thuhet në deklaratën e SMBB.

Përgjatë muajit janar 2021 ndodhën 3 aksidente në minierën e kontrolluar nga Albchrome në Bulqizë.

Bilancit tragjik të aksidenteve në miniera iu shtuan pesë të vdekur dhe 28 të plagosur gjatë vitit 2020, por vetëm gjysma e rasteve u inspektuan dhe hetuan nga AKSEM. *(bulqizaime.al)*

NJOFTIM PËR SHOQATA DHE ORGANIZATA JOQEVERITARE

Redaksia e gazetës vendos në dispozicion të shoqatave me fokus Dibrën dhe organizatave joqeveritare hapsira për botimin e veprimtarive apo studimeve të tyre.
Kostot e botimit për shoqata dhe OJQ-të janë me kostot e botimit të gazetës.
Për më shumë informacion telefononi në numrin **0692068603** ose shkruani emailit: **rrugaearberit@gmail.com**

Na ndiqni:

RRUGA E ARBËRIT
https://www.facebook.com/gazeteerajonitteDibres

ose

www.rrugaearberit.com

Dibër, një minator rregjistron në KQZ kandidaturën për deputet në Kuvend



Elton Debreshi, zyrtarizon kandidaturën për deputet në qarkun Dibër. Ai dorëzon në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve 1350 firma dhe dokumentacioni i nevojshëm për regjistrimin e kandidaturës.

Elton Debreshi, njëkohësisht Kreu i Sindikatës së Minatorëve të Bashkuar të Bulqizës, ka njoftuar regjistrimin si kandidat i pavarur në zgjedhjet e 25 prillit.

Ai do të kandidojë në qarkun e Dibrës. Në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve janë dorëzuar 1350 firma dhe dokumentacioni i nevojshëm për regjistrimin e kandidaturës.

"Sapo depozituam firmat e kandidaturës së pavarur për minatorët, për problematikat e minatorëve dhe zonës së Dibrës. Ne jemi djemtë e asaj zone. Më mirë sesa e dimë ne situatën sesi është në Dibër, nuk e di askush nga këta politikanët që rrinë këtej nëpër zyra e resorte." tha Debreshi për mediat.

Brezi i tretë i minatorit në familje, ai ka thënë se ka 30 vite që statusi i minatorit përdoret në çdo fushatë elektorale, por sapo vijnë në pushtet, partitë nuk interesohen më.

Më 21 dhjetor 2020 Sindikata e Minatorëve të Bashkuar të Bulqizës, dorëzoi në Kuvend peticionin me 10 mijë e 700 firma për miratimin e Statusit të Minatorit.

Qarku i Dibrës ka në total 5 mandate dhe në zgjedhjet e fundit kanë marrë pjesë 73 mijë votues. *(bulqizaime.al)*

aktualitet

Bilancit tragjik të aksidenteve në miniera iu shtuan pesë të vdekur dhe 28 të plagosur gjatë vitit 2020, por vetëm gjysma e rasteve u inspektuan dhe hetuan nga AKSEM - një praktikë që sipas ekspertëve rrit pasigurinë në punë dhe krijon terren për fatalitete.



Grafikë ilustruese nga Jurgena Tahiri / reporter.al

AKSIDENTET E PAHETUARA rrisin pasigurinë në minierën e Bulqizës

Nga **SAMI CURRI**

Mëngjesin e 21 janarit, gjatë një shpërthimi të programuar eksplozivi në galerinë e kromit në Bulqizë, zjarrmëtari me inicialet B.C dëmtoi rëndë këmbën e djathtë.

Minatori- punëtor i kompanisë koncesionare Albchrome, u dëmtua nga shembja e masivit shkëmbor nën të cilin po strehohej për t'u mbrojtur nga shpërthimi.

Aksidente të tilla konsiderohen ngjarje rutinore në minierën e Bulqizës, ku vetëm gjatë muajit janar u shënuan katër raste të klasifikuara si 'plagosje të lehta' në ambientet e menaxhuara nga kompania Albchrome.

Megjithatë, asnjëri prej aksidenteve nuk u hetua nga Autoriteti Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera, AKSEM, i cili i tha BIRN në një përgjigje me shkrim se inspektimet për kushtet e sigurisë i kryenin vetëm për aksidentet me pasoja fatale apo ato me plagosje të rënda.

"Për këto aksidente nuk ka akte inspektimi," tha AKSEM lidhur me aksidentet e janarit, duke shtuar se verifikimin për këto raste duhej ta bënte vetë kompania.

"Nuk janë dërguar grupe inspektorësh në vendngjarje, për rrjedhojë nuk është kryer ekspertizë nga inspektorët e AKSEM," shtoi Autoriteti.

Qarku i vogël i Dibrës, ku ndodhet miniera e Bulqizës, mban vendin e dytë për numrin e lartë të aksidenteve dhe të fatalitetеve në vendin e punës pas Tiranës. Gjatë vitit 2020, Inspektoriati Shtetëror i Punës raportoi se 7 persona humbën jetën dhe 27 të tjerë u aksidentuan në vendin e punës në këtë qark. Pesë prej viktimave ishin minatorë.

Statistikat e institucioneve shihen me dyshim nga ekspertët e sigurisë dhe të drejtave në punë, të cilët thonë se aksidentet me pasoja të lehta as nuk raportohen dhe as nuk hetohen si duhet.

"Shqipëria raporton një numër më të ulët aksidentesh në punë për frymë se Kroacia dhe Sllovenia, edhe pse vendi ka siguri në punë mjaft të ulët," tha Edison Hoxha nga Qendra për të Drejtat e Punës, CLR.

"Duke mos dalë në pah gjendja reale e aksidenteve të lehta në punë, situata paraqitet më e lehtë nga ç'është realisht", shtoi Hoxha, duke theksuar se hetimi i të gjitha aksidenteve mund të shmangte fatalitetet në vendin e punës.

E pyetur nga BIRN, kompania Albchrome i ironizoi pyetjet për aksidentet me fjalinë : "Jemi shumë të lumtur që ashtu sikurse ne, edhe ju kujdeseni e kujtoheni shpesh për kolegët tanë", ndërsa shtoi se aplikon standardet më të larta të sigurisë në punë në Shqipëri.

Kompania nuk dha detaje për aksidentet e janarit, por tha se asnjë prej minatorëve nuk ndodhej në spital dhe se njëri prej aksidenteve, i regjistruar nga AKSEM si plagosje e lehtë, nuk kishte ndodhur për shkak të punës.

TË FSHEHURA DHE TË PAHETUARA

Përgjatë vitit 2020, Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore shënoi 182 punëmarrës të aksidentuar në vendin e punës në të gjithë Shqipërinë, nga të cilët 36 humbën jetën.

Sektori i "minierave dhe karrierave" zë vendin e tretë për numrin e lartë të aksidenteve në punë pas ndërmarrjeve prodhuese dhe ndërtimit në rang vendi – me 28 aksidente të regjistruara gjatë vitit 2020 dhe pesë minatorë të vdekur.

Nga numri total i aksidenteve në miniera të raportuara në Inspektoriatin Shtetëror të Punës për vitin 2020, AKSEM inspektoi dhe hetoi 14 raste –ose vetëm gjysmën e aksidenteve të raportuara përgjatë vitit.

Ndryshe nga sektorët e tjerë, përgjegjësia për inspektimin e aksidenteve në miniera ndahet mes dy institucioneve; Inspektoriatit Shtetëror të Punës dhe AKSEM. Ndërsa Inspektoriati mban raportet dhe bën procesverbalet, verifikimi i kushteve të sigurisë nëntokë kryhet nga AKSEM, i cili përcakton edhe shkakun e ndodhjes së ngjarjes si dhe rregullat e shkelura.

Të dhënat e Inspektoriatit Shtetëror të Punës tregojnë një bilanc tragjik të aksidenteve në miniera, ku vetëm gjatë tre viteve të fundit u plagosën 99 minatorë dhe humbën jetën 18 të tjerë.

Ndërsa numri i aksidenteve dhe fatalitetеve ka shënuar luhatje të vogla nga viti 2018, ndështkimet administrative me gjoba kanë qenë minimale dhe kanë rënë ndjeshëm në vitin 2020.

Sipas Inspektoriatit, për aksidentet në këtë kategori u vendosën 2.5 milion lekë gjoba në vitin 2018, 5.4 milionë lekë në vitin 2019 dhe vetëm 930 mijë lekë gjoba në vitin 2020.

Kryetari i Sindikatës së Minatorëve të Bashkuar të Bulqizës, Elton Debreshi, i cili kandidon si i pavarur për një vend në Parlament në zgjedhjet e 25 prillit, fajëson mungesën e masave nga institucionet për numrin e lartë të aksidenteve në miniera.

"Arsyet e aksidenteve janë të shumta, lidhen me mos-zbatimin e rregullores të sigurimit teknik, mungesa e investimeve për sigurinë në punë, rritjen e normave si dhe shfrytëzimin pa kriter të minierave," tha Debreshi për BIRN.

Debreshi akuzoi gjithashtu kompanitë, se jo vetëm që nuk i hetojnë aksidentet, por shpesh janë në përpjekje aktive për t'i fshehur ato.

"Një tjetër fenomen mjaft i rëndë me aksidentet në miniera është ai që lidhet me fshehjen apo tentativat për të fshehur këto aksidente," shtoi ai.

Edhe Edison Hoxha nga Qendra për të Drejtat e Punës, CLR, mendon se roli formal i institucioneve në mbrojtje të punëtorëve i ka lënë minatorët dhe punëtorët në përgjithësi të vetëm përballë punëdhënësve, duke rritur mundësinë që aksidente të tilla të fshihen.

Hoxha fajëson edhe mosfunksionimin e sindikatave, që sipas tij mund të ishin një 'sy i mirë' për të raportuar rastet e aksidenteve në punë.

"Mosfunksionimi i këtyre strukturave në vendin e punës ka bërë që kur ndodhin raste të tilla, punonjësi të jetë i vetëm përballë punëdhënësit, i cili mundohet me çdo mënyrë qoftë me joshje të ndryshme, qoftë me presion të drejtpërdrejtë ndaj punëmarrësit të aksidentuar lehtë që ta fsheh ngjarjen," tha Hoxha.

Hoxha theksoi gjithashtu se mosnjoftimi apo mungesa e hetimeve serioze të aksidenteve të vogla e bën të vështirë korrigjimin e gabimeve.

"Mosnjohja e gjendjes reale e bën pastaj të pamundur të ndërmerren ndërhyrjet, masat e duhura nga institucionet për përmirësimin e situatës,"shtoi ai.

PASOJAT E AKSIDENTEVE

Sipas Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, AKBN, gjatë vitit 2018 në galeritë e kromit punonin 3170 punonjës, ose rreth 1 në çdo 10 banorë të Bulqizës sipas censusit të vitit 2011. Kjo është pjesa dërrmuese e krahut të punës në Bulqizë.

Sipas të dhënave nga AKSEM, numri më i madh i aksidenteve me plagosje vitin e kaluar ndodhi në atë që njihet si zona famëkeqe D në Bulqizë, ku veprojnë një numër kompanish të vogla në mjaft raste edhe të parregulluara.

Sipas AKSEM, dy prej aksidenteve në këtë zonë ndodhën te kompania Alb-Mi, dy raste të tjera tek Albmine & Chrome dhe nga një aksident në kompanitë Gerda 07 dhe Lubima.

Aksidentet e tjera u rregjistruan në minierën e bakrit në Spaç, që kontrollohet nga Tete Albania Tunnel & Mining dhe minierat e kromit Algej, Kostur Krom, Kaprolla Kompani dhe Global Enterprise Group, në Dibër.

Kompania më e madhe e nxjerrjes së kromit në vend, Albchrome në pronësinë e biznesmenit Samir Mane shënoi gjatë vitit 2020 tre aksidente me plagosje.

Bilanci tragjik i të plagosurve dhe viktimave në minierë nuk është shoqëruar me hetime të plota nga institucionet e drejtësisë apo ndëshkime. Në procesin e vetingut, dy prokurorë që kishin punuar në zonën e Dibrës, u shkarkuan nga detyra edhe me arsyetimin se kishin bërë hetime të cekëta, që kishin favorizuar subjektet minerare dhe ngarkonin me faj viktimat.

Përtej rrezikut, minatorët nuk kanë ende një status që mund t'i mbronte në aksidente që shpesh i lënë pa punë, pa mundësi të ardhurash për një kohë të gjatë dhe në mëshirë të kompanive.

Një familjar i një punëtori të aksidentuar në minierë në një subjekt minerar në zonën mineral-mbajtëse D në dhjetor 2020, i tha BIRN në kushte anonimati se kompania nuk po ju përgjigjej për shpenzimet spitalore.

"Është me hekra në këmbë. Nuk i japin as shpenzimet nëpër spitale e as raportet," tha familjari. "Ai të paktën edhe për nja dy vjet nuk bëhet më për punë. Me kalamaj të vegjël, me atë rrogë hante bukë," përfundoi ai.

Burimi: https://www.reporter.al/aksidentet-e-pahetuara-rrisin-pasigurine-ne-minieren-e-bulqizes/

Rruga e Arbërit nr. 174

profil

Gjithçka nisi si një lojë fillimisht, si punë tregtie. Djaloshi bleu ca viça me një çmim të leverdisshëm, i mbajti pak kohë dhe i shiti me një çmim po të tillë.

Denisi, blegtori i ri, *me ide të reja dhe punë arrin suksesin*

Nga **OSMAN XHILI**



Në fillimet e tij, dikush mund të qe shprehur se Denisi vetëm i ka dëgjuar zërin blegtorisë, por tashmë çdo gjë është bërë e qartë për këdo. Blegtori i ri e ka trasuar rrugëtimin e tij të jetës, përmes një biznesi, që e dashuron dhe i fali vitet e tij më të bukura. Nga zemra na del një urim i sinqertë për njeriun e punës, për të patur sa më shumë suksese e të ardhura për familjen e tij.

As vetë ai nuk e kishte menduar se do të bëhej një blegtor i tillë, aq i pasionuar. Jo se i mungonte fuqia dhe vullneti, por mendonte që fuqinë dhe energjinë e tij do ti kanalizonte në një drejtim tjetër. Fare mirë mund ti bashkëngjitej babait të tij, bletarit të shquar Haxhi Miftarit, në udhën e bukur që kishin nisur dekada më parë. Nuk kishin pak, por gati 500 koshere, që ishin nder dhe krenari për familjen Miftari.

Gjithçka nisi si një lojë fillimisht, si punë tregtie. Djaloshi bleu ca viça me një çmim të leverdisshëm, i mbajti pak kohë dhe i shiti me një çmim po të tillë. Mori një parti tjetër malli e kështu me radhë. Më pas bleu ca të imta, duke bërë të njëjtën gjë me to. Të gjitha këto përpjekje krijuan te Denisi dashurinë për kafshët, ndjenjë të cilën ai e kishte pasur vetëm për bletën, me të cilën qe rritur. Por, një rrugëtim i tillë, shtroi para tij një detyrë tepër urgjente, ndërtimin e një stalle, ku do të strehonte blegtorinë.

Nuk ju desh shumë kohë që ta shihte veten me një stallë të tillë me sipërfaqe totale mbi 100 metër katrorë. Kështu vazhdoi disa vite. Zgjerimi i përmasave të aktivitetit, shtronte si detyrë zgjerimin e kapaciteteve strehuese. Stallës së parë iu shtuan kështu dhe 100 metër katrorë të tjerë, duke e dyfishuar sipërfaqen. Pak kohë më vonë u ndërtua një objekt tjetër, ngjitur me të parat, por tashmë duke e shtuar ndjeshëm sipërfaqen. Bëhej fjalë për një objekt me përmasa 42 metra gjatësi me 5 metra gjerësi, pra mbi 200 metër katrorë të tjerë, duke e çuar në gati 500 metër katrorë sipërfaqen e strehimit të blegtorisë. U duk se e gjithë kjo hapësirë do ta ngopte përfundimisht syrin e djaloshit, por jo, nuk ishte ashtu. Vitin e kaluar u ndërtua një tjetër objekt i ri, tashmë në krahun tjetër të atyre ekzistuese. Të tre përmasat, gjatësi, gjerësi dhe lartësi ishin kombinuar hijshëm, duke dhënë një rezultante prej mbi 220 metra katrorë, vetëm në katin e parë, pasi i dyti do të shërbente për mbajtjen e bazës ushqimore gjatë dimrit. Ashtu si çdo gjë, që e ka një limit të caktuar dhe odiseja e ndërtimeve mbaron këtu. Nuk do të ketë më rritje të kapaciteteve strehuese, përveç ndërtimit të avllive, apo mureve rrethuese për objektet, që do të kishin shumë funksione për blegtorinë e mbarështuar. Dikush që se ka parë fermën blegtorale, krijon idenë e disa objekteve jo funksionalë, por në fakt, rezulton se të gjitha këto paskan qenë një projekt i mirëstudiuar në mendjen e Denisit dhe i zbatuar hap pas hapi, në kohë.



BLEGTORIA QË MBARËSHTON

Folëm për kapacitetet strehuese të blegtorisë dhe unë që i kam parë gati të gjitha në Dibër, them se në këtë drejtim, nuk ka të barabartë me të. Treguam që historia nisi me viça për mish dhe Denisi nuk ka hequr dorë akoma prej tyre. Nuk ka një numër konstant të trajtimit të tyre. Ai fillon që nga numri njëzetë dhe mund të shkojë deri në pesëdhjetë dhe më shumë akoma. I merr zakonisht me një peshë, diku te 170 kilogramë, për i shitur me një peshë afër 400 kilogramë, pas pesë, apo gjashtë muajsh. Pak jonxhë, vetëm kashtë e tagji e bollshme, janë të mjafta për të plotësuar një racion të plotë ushqimor, në sasi e cilësi. Vetëm misër mund të shpenzohen diku tek 10 kuintalë për një viç.

Por me kalimin e kohës, Denisi provoi të mbarështojë dhe të imtat. Për pak kohë i kishte pasur vetëm si objekt tregtie të shpejtë, por dy tre vitet e fundit vendosi që të mbante një tufë të mirëfilltë me 150 krerë. Në stallë, gjatë vizitës time, gjeta vetëm qengjat pasi delet ishin në kullotë. Ata mbarështoheshin tek objekti i ri, i ndërtuar një vit më parë. Mjedisi i bollshëm, i pastër dhe higjenik, si dhe kondicioni i qengjave të lindur deri tani, tregonin për pasionin dhe seriozitetin e punës së djaloshit. Grazhdet e dhenve i kishte marrë në Durrës. Të bukura, të forta dhe të lëvizshme, ata ishin mjaft funksionale, si pjesë e rëndësishme e mbarështimit të blegtorisë. 180 krerë qengja të lindur ishin deri tani, kur kishin ngelur akoma dhe pak dele për pjellje, pra numri total, mund të shkonte në 200 krerë qingja. Denisi tregon se rreth 30 krerë prej tyre kanë një peshë mbi 30 kilogramë dhe janë gati për tu shitur në treg.

Kishte pak kohë, që fermeri i ri i kishte hedhur sytë tek dhia alpine, derisa krijoi një tufë të vogël, prej 50 krerësh. Pjellja tek ato, sapo ka filluar, duke shpresuar që çdo gjë do të shkojë mbarë. Inventarit total të blegtorisë i shtohet dhe ndonjë lopë, apo kalë, për të kuptuar se tashmë ai ka fituar goxha eksperiencë dhe është plotësisht i aftë, të menaxhojë dhe ngarkesa të tilla, që janë për tu admiruar.

BAZA USHQIMORE

Normalisht, që ky numër jo i vogël i kafshëve të mbarështuara, krahas strehimit, të plotësuar më së miri, kërkojnë një seriozitet në të ushqyer. Denisi ka në përdorim gati 200 dynymë sipërfaqe toke. 50 dynymë i ka të mbjellë me jonxhë, ku vetëm një bllok i vetëm ka 35 dynymë. Përveç jonxhës ai e pëlqen dhe tërshërën, si kulturë bujqësore. E korr at në fazën e kallëzimit dhe e bën balla me mjetet e tij mekanike. Ai bën gjithsej deri 4000 balla, me 20 kilogramë secila prej tyre. Veç tyre, Denisi mbjell dhe 15 dynymë hasëlle, për ti pasur si ushqim për qengjat në pranverë.

Në dispozicion të sigurimit të bazës ushqimore është një repart i kompletuar mekanik, që ai vetë e përdor. Në përbërje të tij janë dy traktorë, dy kamioncina, korrëse dhe lidhëse dhe mbledhëse bari, pa llogaritur plugje, freza, brena e të tjera të këtij lloji, që shërbejnë për përgatitjen e tokës për mbjellje.



Në fillimet e tij, dikush mund të qe shprehur se Denisi vetëm i ka dëgjuar zërin blegtorisë, por tashmë çdo gjë është bërë e qartë për këdo. Blegtori i ri e ka trasuar rrugëtimin e tij të jetës, përmes një biznesi, që e dashuron dhe i fali vitet e tij më të bukura. Nga zemra na del një urim i sinqertë për njeriun e punës, për të patur sa më shumë suksese e të ardhura për familjen e tij.

NJOFTIM PËR BASHKËPUNËTORËT!

Njoftojmë të gjithë bashkëpunëtorët dhe korrespondentët tanë se shkrimet duhet t'i sjellin në redaksi para datës 20 të muajit.
Për çdo rast, komunikoni me redaksinë!

Dëshironi të **BOTONI PAK KOPJE LIBRI**,
por nuk mundeni sepse shtypshkronjat ju kërkojnë të paguani për një tirazh të madh...
Tani nuk është nevoja të prisni...
JU OFROJMË BOTIME NGA 1 KOPJE E VETME!
Njëlloj si në shtypshkronjë... Çmime të favorshme dhe shpejtësi!
Telefono: **068 65 08 441** ose shkruaj email: **mbbotime@gmail.com**

portret

Dhe pse ka lindur në Dohoshisht, Mensuri rrjedh nga shehlerët e dëgjuar të Ilnicës, të shquar për besim e urtësi. Ai donte tu ngjante sadopak paraardhësve të tij dhe e kuptonte që vetëm punët e mira mund ta afronin drejt atij froni. Po çfarë na bëri të shkruajmë për këtë njeri të thjeshtë?

Pensionisti që bën punë të mëdha

Nga **OSMAN XHILI**

Mensur Shehu, nga Dohoshishti i Dibrës, po u drejtohet të tetëdhjetave, por shpirtin e ka akoma të ri, trupin të fortë e zemrën të dhembshur për të bërë punë në dobi të komunitetit e të shoqërisë. Jeta e tij ka qenë vetëm punë e përpjekje, për të mbajtur familjen, por dhe për të qenë i dobishëm për të tjerët. Mensuri nuk bëri shumë shkollë, por fitoi shumë eksperienca në jetë, duke u shndërruar këto në universitete. Ai punoi në shumë ndërmarrje të kohës, por dhe më pas, derisa doli në pension në vitin 2004. Punoi në ushtri, punoi në ndërmarrjen e grumbullimit, punoi te spitali dhe gjithandej prezantoi anët më të bukura të karakterit, drejtësinë, ndershmërinë e sinqeritetin.

Dhe pse ka lindur në Dohoshisht, Mensuri rrjedh nga shehlerët e dëgjuar të Ilnicës, të shquar për besim e urtësi. Ai donte tu ngjante sadopak paraardhësve të tij dhe e kuptonte që vetëm punët e mira mund ta afronin drejt atij froni. Po çfarë na bëri të shkruajmë për këtë njeri të thjeshtë?



Mensur Shehu e ka shpirtin të ri, trupin të fortë e zemrën të dhembshur për të bërë punë në dobi të komunitetit e të shoqërisë...

Ai është njeriu bamirës mendon e mendon projekte të reja. Idetë e tija nuk ngelen kurrë në letër, siç ndodh shpesh me politikanët, por e gjejnë rrugën e realizimit. Ai vërtet e ka pensionin e vogël, por ka shpirtin e mirë dhe zemrën bujare, duke merituar respektin e njerëzve.

ÇEZMA E SHKOLLËS

Kur Mensuri doli në pension në vitin 2004, siç e përmendëm dhe më parë, pati një frikë se po shkëputej nga njerëzit, me të cilët kishte punuar gjithë jetën. I dukej vetja si një send i përdorur dhe i hedhur tej si i pavlerë. Brenda vetes ndjente se kishte akoma energji, se kishte akoma për tu treguar e për tu dhënë të tjerëve.

Për të dalë në qendër të fshatit e për të shkuar në qytet, ai duhej detyrimisht të kalonte pranë shkollës. Shpesh shihte nxënës që shkonin nëpër shtëpitë pranë për të pirë, apo për të mbushur ujë për pastrim, pasi shkolla nuk kishte. Nuk ishin pak asokohe, por të paktën 500 nxënës. A mundej ai ta rregullonte sadopak gjendjen, ta shuante etjen e atyre vogëlushëve. Në ëndërr shpesh shihte sikur kishte gjetur një burim të bollshëm uji te kodrat rreth fshatit dhe e kishte dërguar pranë shkollës. Dhjetra vogëlushë lanin duart, pinin ujë e freskoheshin, duke falenderuar njeriun e mirë, që kishte menduar për ta. Në mëngjezin e hershëm zgjohej dhe kuptonte që ajo kishte qenë vetëm një dëshirë, që donte shumë punë për ta realizuar.

Shumë kohë u end i vetmuar mbi kodrat e fshatit dhe ashtu siç kishte pikasur burime uji më parë, gjeti dhe një të mrekullueshëm për shkollën në kodrën Romanece. Mati distancën që atje dhe bëri një projekt të thjeshtë. Duhej bashkuar uji te burimi, duheshin 1700 metër tuba dhe po kaq kanal, që duhej ta hapte vetë. Ishte viti 2003. Dy vjet punë e përpjekje, pse jo dhe rreziqe, aty te burimi, ku mund ta zinte dheu përfund. Po sërish dhe në atë variant i fituar do të ishte. Do të ishte një dëshmor, duke u përpjekur për ujin e fëmijëve të shkollës.

Një fjalë të mirë do ta thonin për të brezat që do vinin. Kanali e lodhi mjaft. I takoi të punojë në kulmin e vapës, po ashtu dhe në dimër. Kujton se përdori dhe zjarrin për të shkrirë akullin, në të paktën 30 metër gjatësi. Së fundmi triumfoi. Kanali u hap në të gjithë gjatësinë e tij. Montoi tubat dhe uji i ftohtë, i pastër dhe i shëndetshëm, vërshoi nga burimi tek çezma e re, ngjitur me shkollën. Nuk do kishte më etje dhe shishe uji të marra nga shtëpitë. Ishte data 15 shtator 2005, dita e parë e shkollës. Njeriu i mirë kishte menduar për ta, ku e gjithë puna dhe shpenzimet kishin qenë të tijat dhe të familjes së tij.

URA E FSHATIT

Përroi që vjen nga Llixhat është mjaft i rrëmbyer, sidomos në vjeshtë dhe në dimër. Aty në qendër të fshatit është ndërtuar një urë, që lidh lagjet e tij, por shërben dhe për banorët e fshatit Selane për të ardhur në qytet e kthim.

Kishte hyrë muaji i bekuar i Ramazanit dhe Mensur Shehu shkoi në xhami për të falur teravinë e parë, bashkë me nipin e tij 14 vjeçar. Përroi ishte fryrë nga shirat dhe gjëmonte. Ishte errësirë dhe gjyshi e mbante nipin për dore, se mos humbte drejtimin e binte nga ura. Nipi e pyeti se përse nuk i kishin vënë mbrojtëse në të dy anët, pasi po të binte njeriu mbytej në atë përrua, që kishte marrë parmasat e një lumi. Gjyshi nuk i dha përgjigje. Ndoshta u ishin mbaruar lekët ndërtuesve të urës, siç na mbarohen shpesh ne shqiptarëve? Dhe sa kohë mund të vazhdonte ura të përbënte rrezik për njerëzit? Ndoshta gjithë jetën, nëse nuk do të kujtohej kush ta riparonte gabimin.

Një ditë, jo shumë kohë pas pyetjes së nipit, shkoi tek ura dhe bëri ca matje të thjeshta. Sajoi një preventiv të vogël në mendje dhe në një copë letër. Sa ishte gjatësia e njërit krah të urës? Po të dy së bashku? Sa tuba nga ata të mirat duheshin? Sa rrjetë teli nga ajo e mira me saldim? I shkroi të gjitha, i mori materialet dhe i vendosi aty ku duhej. Ishte 5 Nëntori i vitit 2018. E mori nipin për dore dhe shkuan te ura.



– Atëherë,o nipi im, atë natën e errët, kur u kthyem nga xhamia, ma bëre një pyetje e unë nuk ta dhashë përgjigjen. Sot besoj ta ka kam dhënë. Kështu dua dhe ti të bësh në jetë. Të bësh punë të mira, në dobi të njerëzimit. Pak muaj më vonë nipi u përplas në një aksident të frikshëm rrugor dhe përfundoi në spital. E gjithë kjo histori e trishtë u mbyll pa pasoja dhe ndoshta, vepra e mirë e gjyshit rezultoi shpëtimtare për nipin e tij.

RRETHIMI I VARREZAVE

Në pranverën e vitit të kaluar, tregon Mensuri, patëm varrimin e një shoku nga fshati. Varrezat ishin të parrethuara dhe blegtoria hynin e dilnin nëpër to sipas dëshirës, jo rrallë dhe duke i dëmtuar ato.

"Unë kisha qenë në Haxh, në vitin 2012, - vazhdon tregimin Mensuri - dhe po bëhesha gati të shkoja sërish, këtë rradhë në emër të prindërve. Ndoshta dhe për shkak të pandemisë, por jo vetëm, mendova që të bëja një "Haxh" ndryshe. Lekët që do të harxhoja në ritualin e rëndësishëm për muslimanët, do ti përdorja për rrethimin e varrezave të fshatit."

Ai nuk kishte mundësi ti bashkojë njerëzit e fshatit në një aksion të tillë. Vetëm veten e vet mundej. Sa herë që merrte të tilla vendime të mëdha i kërkonte ndihmë Zotit dhe ndihma e Tij asnjëherë nuk i mungonte. Sërish preventivi, tubat, rrjetat cilësore, dera, çimento, rërë e zhavor. Nuk ishin pak, por mbi 500 metra gjatësi. Këtë rradhë shifra totale e projektit ishte akoma më e madhe për xhepin e një pensionisti, që merrte vetëm 180 mijë lekë në muaj. I duheshin dy vjet ta mblidhte pensionin për ta kryer një volum të tillë pune. J'ua tregoi planin e tij disa miqve e bashkëfshatarëve dhe ata i thanë se kjo ishte e pamundur për fuqitë dhe mundësitë e tij. Por Mensuri ishte i vendosur në projektet e tij.

"Dhe sikur të ndërroj jetë, pa e përfunduar projektin, e kam lënë amanet tek familja dhe vëllezërit për ta çuar deri në fund idenë time".

E nisi punën. Ishte data 25 maj 2020. Punoi atë ditë, të nesërmen dhe të pasnesërmen. Më tej nuk mundi. Ishte dhe vazhdon të jetë një periudhë Kovidiane, nëse mund ta quajmë kështu. Virusi u fut në trupin e bamirësit Mensur Shehu dhe e mposhti për mbi dy javë. I këputi oreksin, e lodhi dhe e plogështoi mjaft. Mensuri nuk kishte frikë nga vdekja. E dinte që një ditë do të largohej nga kjo botë, andaj nxitonte në projekte e vepra bamirësie. Luste Zotin që ta përfundonte dhe këtë punë të mirë e prapë qetësohej dhe po të ndodhte më e keqja. E kishte lënë amanet, që puna të mbarohej.

Pak nga pak e mposhti sëmundjen dhe iu kthye punës si një luan i vërtetë. Punët i erdhën të mbara. Varrezat janë disi larg fshatit dhe ai ishte i detyruar ta sillte ujin që andej, me kosto shtesë. Rakip Bellova, një familje e vetme, që kishte shtëpinë aty pranë i hapi dyert.

"Nëse nuk të bëj ndonjë ndihmë tjetër, - i tha ai, - të paktën këtë problem të ta lehtësoj". Një tjetër njeri bujar, Eduart Zajmi, i solli gurë e rërë, pa asnjë shpërblim. Më datën 28 korrik të vitit të kaluar, pas dy muajsh pune intensive, në të nxehtin e madh të verës, gjithçka ishte e përfunduar.

* * *

Para pak ditësh bëra një vizitë në fshat dhe i pashë nga afër këto projekte bamirësie të këtij pensionisti. Lava duart dhe piva ujë në çezmën e tij, kaluam te ura e rrethuar nga dy krahët dhe bëmë një vizitë te varrezat e fshatit. Aty gjetëm dy specialistë që po montonin varrin e dikujt, që kishte ndërruar jetë. Nuk i pyeta, por varri i punuar me mermer të shtrenjtë mund të kushtonte rreth dy milionë lekë. Sa të tillë mund të kishte? Hodha sytë kalimthi dhe mendova që mund të ishin mbi njëqind të tillë. E shumëzuar me shifrën që përmendëm për të parin, rezultonte 200 milionë lekë. Sa projekte bamirësie mund të bëheshin me një shumë të tillë lekësh?! Dhe mos harrojmë, se jo vetëm nuk po u bëjmë ndonjë dobi shokëve e miqve tanë, që kanë ndërruar jetë, por u vemë pesha e ngarkesa të kota, që u shtohen peshës së mëkateve njerëzore gjatë jetës.

Mensur Shehu, njeriu bamirës mendon e mendon projekte të reja. Idetë e tija nuk ngelen kurrë në letër, siç ndodh shpesh me politikanët, por e gjejnë rrugën e realizimit. Ai vërtet e ka pensionin e vogël, por ka shpirtin e mirë dhe zemrën bujare, duke merituar respektin e njerëzve.

Keni një histori për të treguar? Një ngjarje apo problematikë që shqetëson komunitetin tuaj?

Na shkruani në email ose telefononi në numrat e redaksisë. Një gazetar i yni do t'ju ndihmojë që historinë tuaj ta bëni publike!

rrugaearbërit@gmail.com
069 20 68 603

"RRUGA E ARBËRIT"
ËSHTË GAZETA JUAJ!

Rruga e Arbërit nr. 174
kumtesë

Në pikëpamje planimetrike dhe tipologjike, stera e Kullës së Skënderbeut është e ngjashme me sterën e kalasë së fshehtë të Skënderbeut në Daulë të Kurbinit

Të dhëna arkeologjike *mbi disa fortifikime të* **periudhës së Skënderbeut** *në rajonin e Dibrës*

Nga **Adem BUNGURI**
Instituti i Arkeologjisë
Akademia e Studimeve Albanologjike

(vijon nga numri i kaluar)

Ka një pozitë të favorshme strategjike dhe në një farë mase, të mbrojtur në pikëpamje natyrore. Në anën veriore ai bie me faqe krejtësisht shkëmbore mbi zallin e Bulqizës, që e ndan atë nga Shkëmbi i Skënderbeut. Me faqe shkëmbore ai bie edhe në anën perëndimore mbi fushën përreth. Sipërfaqja e qytetit zbret me një pjerësi të zbutur drejt lindjes dhe jugut, ndërsa hyrja e tij, duke gjykuar nga pikëpamja topografike, duhet të ketë qenë në anën juglindore të tij. Sipërfaqja e qytetit ka formë përafërsisht eliptike, me diametrin veriperëndim-juglindje 82.5m dhe atë veri-jug 25m. *(fig. 29a)* Qyteti ruan gjurmë të sistemit të fortifikues të periudhës së vonë antike dhe asaj mesjetare. Muret e periudhës së parë rrethonin një sipërfaqe rreth 0.2ha dhe ndjekin vijën rrushkulluese të kodrës në trajtë eliptike Sot mund të flitet vetëm për gjurmë të shkëputura të tij, në anën jugperëndimre, verilindore dhe veriore. Trakti i më mirë i ruajtur i këtij muri, me gjatësi 1.50-1.60m, lartësi 0.80-1.00m, gjendet në anën jugperëndimore, por faqja e jashtme e tij është e dëmtuar. Muri është ndërtuar me gurë mesatarë të terrenit dhe lumorë, të lidhur me llaç gëlqeror, me teknikën *opus incertum*. Llaçi përmban shumë rërë lumi të pasitur, nuk është shumë i fortë dhe nuk ka cilësi të mirë *(fig. 29a)*. Gjurmë të këtij muri shihen edhe në anën verilindore, në hapësirat midis shkëmbinjëve natyrorë. Periudhës mesjetare mendojmë se i takojnë gjurmë të murrit rrethues të anës veriore, që mund të ndiqen në një linjë prej 22m, si dhe një kullë rrethore gjurmët e të cilës gjenden në pjesën më të lartë të skajit veriperëndimor të qytezës, kronologjikisht e lidhur me shek. XIV-XV pas Kr. *(fig. 29b)*. Me këtë periudhë lidhen edhe rrënojat e një kishe mesjetare, që ruheshin deri vonë poshtë qytetit, në krahun e majtë të zallit të Bulqizës[71] si dhe rrënojat e Kishës së Kojzakut[72], në rrethinën jugore të qytezës së Valikardhës. Qyteza e Valikardhës kontrollonte rrugën kryesore që lidhte Dibrën me Durrësin, të njohur si "Rruga e Arbërit". Në anën jugore të qytetit gjenden fshati i sotëm Valikardha, që ka trashëguar emrin e qytezës mesjetare *Vale Carda*, ndërsa 2-3 km në perëndim të tij fshati Vajkal, emra këto shumë të njohur për historinë tonë mesjetare. Bashkohemi me mendimin e shprehur më parë se pikërisht këtu duhet lokalizuar qyteza mesjetare e *Geties*, që sipas burimeve historike gjendej pranë rrugës Sfetigrad (Koxhaxhik)-Krujë, emër që më vonë u përvetësua nga fshati ***Godvi*** pranë kësaj qyteze[73]. Në mbështetje të këtij lokalizimi vijnë dhe burimet historike të periudhës mesjetare[74].

5b. Kulla e Skënderbeut[75] (x-41°30'47'', y-20° 18'46'', z-978m).

Kreshta shkëmbore e njohur me emrin " *Kulla e Skënderbeut*" me lartësi absolute 978m, ngrihet përballë qytezës së Valikardhës, në krahun e majtë të zallit të Bulqizës *(fig. 30a-b)*.



Fig. 30a- Pamje të shkëmbit të kullës së Skënderbeut; b- Pamje e faqes perëndimore të kreshtës së Kullës së Skënderbeut

Në vitin 1951, H. Ceka-J. Adami kanë shënuar se "*Kulla e Skënderbeut*" gjendet në një shkëmb të pangjitshëm përballë "qytetit" të Valikardhës[76]. Ajo ka një pozitë shumë të mbrojtur natyrore, me kontroll të plotë mbi Fushën e Vajkalit, gjithë luginën e Bulqizës dhe "Rrugën e Arbërit", që kalonte poshtë saj. Platforma e kësaj kreshte me planimetri poligonale, diametrat lindje-perëndim dhe veri-jug 16x65m, dhe sipërfaqe të shfrytëzueshme rreth 1000m^2, ka një pjerrësi të lehtë jugore. Shkëmbi i Kullës së Skënderbeut ka rrënje të thikta shkëmbore në tre anë, atë jugore, perëndimore dhe lindore, ndërsa në anën veriore, ndahet nga pjesa veriore më e lartësuar e saj, nga një kanion shkëmbor me thellësi 3.50-4.00m dhe gjërësi 10-12m. Më në veri të saj lartësohet "Maja e Tëmblave" nën të cilën gjendet "Çardaku" (i Skënderbeut), një shesh i vogël, me hapësirë shikimi mjaft të madhe. Kreshta ku gjendet "Kulla e Skënderbeut" ka një pozitë mjaft dominante. Prej aty kontrollohet lehtësisht e gjithë lugina e Bulqizës, nga Qafa e Buallit në perëndim (844m) deri në luginën e Drinit të Zi dhe qytetin e Dibrës në lindje. Komunikimi vizual është i dukshëm jo vetëm me qytezën e Valikardhës tek "Ura e Qytetit" dhe "Fushën e Vajkalit" që hapet pranë saj, por edhe me qytezat e Krajkës dhe të Sofraçanit, në krahun e majtë të zallit të Bulqizës dhe Fushën e Gurrës (Strikçan) në krahun e djathtë të luginës së këtij lumi. Ngjitja në "Kullën e Skënderbeut" fillon nga fshati Lepurak i Vajkalit, prej ku duhet të ecësh në një monopat të pjerrët për rreth 1.5-2 orë, deri tek "Rruga e fshehtë e Skënderbeut", rreth 200m nën platformën e kreshtës shkëmbore ku gjendet kulla. Kjo rrugë e fshehtë me gjatësi 50-60m dhe gjërësi 2.00-2.50m, ka pjerrësi të fortë, rreth 30-35°. Ajo fillon nga "Guri i dybegut" dhe arrin deri tek faqja perëndimore e kreshtës. Rruga e fshehtë ka qenë hapur në shkëmb dhe është e shtruar me rasa guri *(fig. 31a)*.



Fig. 31a. Pamje e rrugës së fshehtë të Kullës së Skënderbeut; 31b. Gur dybeku

Guri i dybegut gjendet rreth 200m nën faqen perëndimore të kullës, në një sheshpushim buzë "Rrugës së fshehtë të Skënderbeut". Është fjala për një shkëmb natyror me faqe të sheshtë, me përmasa 2.20x1.10x0.70m, në pjesën qëndrore të së cilës, është gdhendur një gropë cilindrike me diametër 23x23cm, thellësi 5.6cm dhe faqe të lëmuara. Është identik me dy gurët e dybekut të kalasë së Koxhaxhikut dhe mendohet se ka shërbyer për shtypjen e barutit *(fig. 31b)*. Kreshta shkëmbore e njohur me emrin " Kulla e Skënderbeut" ka sipërfaqe afërsisht poligonale (fig. 32a-b).



Fig. 32a-Pamje e Kullës së Skënderbeut



32b. Skicë planimetrike e Kullës së Skënderbeut

Gjatë surveit të gushtit 2018, u konstatuan dy struktura ndërtimore, si pjesë integrale e monumentit mesjetar:

a. Kullë vrojtimi. Në pjesën më të lartë dhe të skajshme veriore të Shkëmbit të Kullës së Skënderbeut, gjenden rrënojat e një kulle mbrojtëse. Kulla ka formë drejtkëndëshe me ball të harkuar, që i është përshtatur formës së terrenit dhe përfshihet në tipin e kullave në trajtë "U"-je ose në trajtë patkoi. Kulla ka orientim verior, gjatësi 5.50m dhe gjërësi 6.70m. *(fig. 33a-b)*. Murret e ndërtuara me gur të lidhur me llaç gëlqeror, ruhen në gjendje rrënoje, me gjërësi të lexueshme 0.40m. Në anën anën lindore të kullës, ruhet një trakt murri me gjatësi 2.00m dhe gjërësi 0.40m, që i vishet nga ana e jashtme faqes së shkëmbit natyror, i cili më parë është prerë vertikalisht *(fig. 33c)*. Në gjatësinë 5.50m, faqja jugore e kullës mbyllet me anë të një muri tërthor lindje-perëndim. Gjurmë të murit lindor të këtij fortifikimi, në trajtë rrënojash, vazhdojnë drejt jugut, dhe ndiqen deri në gjatësinë 10m. Në anën perëndimore të kreshtës, gjurmë në trajtë rrënoje të këtij muri mbrojtës, mund të ndiqen deri në gjatësinë 16m, tek shtegu hyrës i kreshtës së Shkëmbit të Kullës së Skënderbeut. Gjurmët e ruajtura në trajtë rrënoje të murreve mbrojtëse, tregojnë se fortifikimi ka qenë i pjesshëm dhe ka shfrytëzuar mjaft mirë vetitë mbrojtëse të terrenit. Kjo situatë arkitektonike, na shtyn të besojmë se thelbi i këtij fortifikimi përfaqësohet nga një kullë në trajtë «U»-je ose patkoi, ku mund të strehoheshin një grup i vogël ushtarësh, me detyra kryesisht të karakterit vrojtues dhe sinjalizues. (ëatching toëer). Kulla në trajtë U-je, ose gjysëmrrethore janë një tip planimetrik i zakonshëm në fortifikimet mesjetare, përfshirë edhe ato të lidhura ekskluzivisht me periudhën e Skënderbeut. Tipi i kullës gjysëmrrethore ndeshet në kalanë e Petralbës[77], të Petrelës[78], të Krujës[79], në kështjellën e poshtme të kalasë së Durrësit[80], ndërsa kullat në trajtë U-je mbrojnë hyrjen e qytetit të sipërm të kalasë së Shurdhahut (Sarda)[81] 82etj.



Fig. 33a-b-Pamje e murrit verior dhe lindor të kullës së Skënderbeut



Fig. 33c-Skicë planimetrike e murrit verior të kullës së Skënderbeut

b. Sterë uji. Në gjysmën jugore të kreshtës shkëmbore, ruhen gjurmët e një stere të nëndheshme uji, të ndërtuar me murre guri të lidhur me llaç gëlqeror. Stera ka qenë e mbuluar me qemer cilindrik gjatësor, sot i shkatërruar thuajse tërësisht nga thesarkërkuesë klandestin. Është fjala për një strukturë me planimetri drejtkëndëshe, me orientim verior, me 5° shmangje lindore nga aksi i veriut. Përmasat e brendshme të saj janë 3.97x3.47x2.50m (4.00x3.50x2.50m). Vëllimi i përafërt i sterës është 35m^3, me një kapacitet ujëmbajtës 35.000 litra *(fig. 34a-b)*.

Hapësira e brendshme e sterës ka qenë e suvatuar me horasan të përgatitur me pluhur tjegullash me veti hidroizoluese, i papërshkueshëm nga uji. Mbetje të këtij llaçi me sipërfaqe mirë të lustruar dhen ngjyrë okër në të kuqërremtë, sot ruhen vetëm



Fig. 34a-Pamje e përgjithshme e sterës



Fig. 34b Plan & prerje e sterës

në dyshemenë dhe pjesët fundore të sterës, përkatësisht në murin jugor dhe lindor të saj, ndërsa në pjesët e sipërme të mureve, edhe pse ka rënë, ky llaç ka lënë në faqet e gurëve, ngjyrën okër të hapur të tij, lehtësisht e lexueshme. Dyshemeja e sterës ka qenë e shtruar me llaç harasan i përgatitur me pluhur tjegullash me veti hidroizoluese, i njëjtë me atë të faqes së brendshme të mureve anësorë, shtresa e të cilit është mjaft e ngjeshur dhe e fortë. Në pjesët fundore të sterës, ruhet edhe shtresa e llaçit hidroizolues me trashësi 2.5-3cm dhe ngjyrë okër në të kuqërremtë, që ka veshur faqet e brendshme të murreve anësor të saj *(fig. 34c)*.

Gjërësia e murreve anësor të sterës është 0.60m, ndërsa gjërësia e murit jugor të saj është 2.00m. Ky murr i jashtëm jugor mund të ketë shërbyer si përforcues i strukturës së sterës ose si aksesor i largimit të ujrave të tepërta. Muret e sterës janë të ndërtuara me gurë gëlqerorë të terrenit, të lidhur me llaç të bollshëm gëlqeror, me shumë gëlqere dhe pak rërë lumi. Ndërsa muret jugor dhe verior kanë faqe vertikale, muret lindor dhe perëndimor harkohen lehtë për të formuar qemerin cilindrik ose gjysëmrrethor.



34c- Detaje të llaçit hidroizolues të sterës

Harkimi fillon në kuotën 0.98m (1.00m) mbi nivelin e dyshemesë. Lartësia e ruajtur e qemerit në anën lindore është 1.00m dhe në atë perëndimore 0.45m, ndërsa shigjeta e harkut të qemerit rezulton të ketë qenë 1.40m.

E gjithë hapësira e brendshme e strukturës, është e mbushur me gurë gëlqerorë të murreve si dhe me gurë çmërsi ranorë të qemerit. Këto të fundit janë të gdhendur, me faqe të sheshta dhe mjaft të lehtë në peshë, në përputhje me qëllimin e përdorimit të tyre në kupolën e qemerit. Gurë të të dy llojeve gjenden edhe në anën perëndimore dhe veriore të kësaj strukture**.** Sterat e ujit kanë qenë pjesë organike e nevojshme dhe e domosdoshme e fortifikimeve mesjetare në përgjithësi, përfshirë edhe fortifikimet e ndërtuara në kohën e Skënderbeut.

Duke e ditur se nevojat e domosdoshme fiziologjike për një njeri janë 2 litra në ditë[83], mund të llogaritet se stera e Kullës së Skënderbeut, me një kapacitet ujëmbajtës prej 35.000 litrash, mund të plotësonte nevojat e një grupi prej 50-60 ushtarësh për 30 ditë, edhe po të mos binte asnjë pikë shi. Në pikëpamje planimetrike dhe tipologjike, stera e Kullës së Skënderbeut është e ngjashme me sterën e kalasë së fshehtë të Skënderbeut në Daulë të Kurbinit[84], me atë të Modriçit[85], atë të kalasë së Skudrinës[86] në luginën e poshtme të Radikës (Dibër), me sterën e kalasë së fshehtë të Skënderbeut[87], në Çidhën të Poshtme, me

(vijon në faqen 9)

Gjetja e saj në afërsi të qytezës së Valikardhës, dëshmon për një standart relativisht të lartë ekonomik e kulturor të përdoruesëve të saj.

(vijon nga faqja 8)

sterën e vogël me qemer gurësh çmërsi në qytetin e Stelushit (Mat)[88], me sterën nr. 1 me qemer cilindrik të kalasë së Shkodrës[89] (e ndërtuar para rrethimit të parë të Shkodrës)[90], me sterën me qemer cilindrik të kështjellës së Matricës[91] në Rubik etj. Të dy strukturat e mësipërme të këtij monumenti, kulla në formë patkoi dhe stera e ujit, në pikëpamje kronologjike, lidhen ekskluzivisht me periudhën e Skënderbeut. Përveç tipareve teknike dhe analogjive të tyre të cekura më lart, mund të përmendim edhe dy objekte mesjetare të lidhura me Kullën e Skënderbeut, përkatësisht një gur dybeku (fig. 31b) dhe një mokër bloje (fig. 37c).

Grupi i punës në majën e "kullës se Skënderbeut"

Në mbyllje duhet të vemë dukje një veçori të fortifikimeve të ndërtuara apo rindërtuara në kohën e Skënderbeut. Është fjala për ngjashmërinë e fortë të skemës topografike dhe planimetrike e kalasë së Koxhaxhikut me kala të tjera të pranuara mirëfilli si të rifortifikuara apo të ndërtuara nga Skënderbeu, siç janë kalaja e Stelushit (Qafë-Murrë), kalaja e Petralbës (Mat), kalaja e Krujës, kalaja e Daules (Kurbin), kalaja e Petrelës (Tiranë)[92] etj.

Është e tepërt të themi se të gjitha kalatë e mësipërme të Skënderbeut gjenden në rajone malore, në mbrojtje të rrugëve të brendshme strategjike nga lëviznin ushtritë. Pjesa kryesore e këtyre kalave, disa prej të cilëve ishin njëherësh edhe qytete mesjetarë, përbëhej nga zona e fortifikuar ose „citadela", që gjendet në majën e kodrës dhe luan rolin e "akropolit" dhe „varoshi" ose qyteti jashtë mureve rrethuese, ku gjenden godinat e banimit dhe ato shoqërore dhe zejtare. Çitadela kishte përmasa modeste, me madhësi nga 0.1-0.2ha. Si element integral ajo kishte gjithnjë pusin apo sterën e ujit, zakonisht të furnizuar me tubacion qyngjesh qeramike nga burime të jashtme, dhe në ndonjë rast edhe me ujët e shiut. Përmasat e vogla të çitadelës janë në përputhje me artin ushtarak të Skënderbeut, i cili kurrë nuk i përqëndronte të gjithë forcat brenda saj. Aty ai linte një garnizon të vogël, ndërsa me forcat kryesore i ngrinte pusi armikut, duke e goditur atë në befasi, natën, në fushim ose gjatë marshimit, dhe duke e asgjësuar atë pjesë pjesë. Për ilustrim, po sjellim një tabelë mbi lartësitë mbidetare të disa prej kalave të Skënderbeut në rajonin e Dibrës, Matit dhe Krujës:

Nr.	Kalaja ose fortifikimi	Rajoni	Lartësia absolute (m)
1.	Qytei i Stelushit	Qafë-Murrë/Dibër-Mat	1225
2	Kalaja e Çidhnës së Poshtme	Çidhën/Dibër	1205
3.	" Koxhaxhikut	Zhupë/Dibër	1160
4.	" Modricës	Gollobordë/Dibër	996
5	" Skudrinës	Rekë/Dibër	1180
6.	Kulla e Skënderbeut	Vajkal/Bulqizë	978
7.	Kalaja e Petralbës (Gurit të Bardhë)	Gur i Bardhë/Klos	878
8.	e Krujës	Krujë/Krujë	610
9.	" Daules	Kurbin/Krujë	527
10.	" Petrelës	Tiranë/Tiranë	329

5c. Kisha e Kojzakut (x-41° 29′ 49′′; y-20° 18′ 32′′; z- 843m)

Kisha e Kojzakut, e njohur edhe si "Kisha e Kodrës së Gjelit", gjendet në majën e një kodrine konike, rreth 1 km në jug të qytezës së Valikardhës *(fig. 35a)*. E ngritur midis përroit të Valikardhës në lindje dhe rrugës që lidhte Valikardhën me Tërnovën në perëndim, kodrina ka pozitë dominante dhe kontrollon një hapësirë mjaft të gjërë. Kodra është e veshur me vegjetacion të dendur dushku dhe shkurresh të tjera. Në syprinën e saj gjenden rrënoja murresh të lidhura me llaç gëlqeror, që populli i quan "kishë". Monumenti është vizituar për herë të parë nga studiuesit H. Ceka-J. Adami[93]. Gjatë vizitës sonë, konstatuam se është fjala për një rrënojat e një kishe mesjetare njënefshe me përmasa të vogla, për fat të keq të shkatërruar nga thesarkërkuesit klandestin. Në rrënojat e saj u gjetën disa fragmente të suvasë polikrome që kanë zbukuruar faqet e brendshme të naosit. Fragmentet e mbetura të suvasë, ruajnë motive gjeometrike brezash linear të pikturuar me ngjyrë të kuqe tulle, gri të errët dhe të bardhë *(fig.35b)*. Për pozitën e saj dominante, nuk përjashtohet mundësia që gjatë periudhës otomane, pas islamizimit, kisha mund të jetë kthyer në ndonjë karakoll ushtarak në kontroll të rrugës së shkurtër Dibër-Tiranë, në linjën Valikardhë-Tërnovë-Martanesh-Bizë-Shëngjergj-Tiranë.

6. Objekte arkeologjike:

Sipas të dhënave arkeologjike, gjurmët më të hershme të banimit të luginës së Bulqizës i takojnë shek. XII-IX para Kr. dhe topografikisht lidhen me territorin e fshatit Vajkal (x-41°31′9′′, y-20°17′13′′, z-750-800m). Përveç tyre, në afërsi të Vajkalit janë



Fig. 35a. Pamje e kishës së Kojzakut
Fig. 35b. Suva polikrome të kishës së Kojzakut

gjetur edhe objekte të tjera, që dokumentojnë banimin e kësaj zone, në periudhat e mëposhtme prehistorike dhe historike:

a. Periudha e tranzicionit nga Bronzi i Vonë në Hekurin e Hershëm (shek. XII-IX para Kr.) Kësaj periudhe i përkasin dy objekte prehistorike, të gjetura pranë kodrinës "Suka e Lepurit" të fshatit Vajkal, përkatësisht një majë heshte bronzi dhe një kantar pseudominoen, që përfaqësojnë inventarin e një varri të shkatërruar ilir të periudhës submikene (1125-1050 para Kr.) ose protogjeometrike (1050-900 para Kr.).

a1. Majë heshte bronzi. Gjetur në fshatin Vajkal. Ruhet në Muzeun Historik të Peshkopisë (më tej: MHP), nr.inv.1472, fig. 36a, 1. Është e tipit fletë ngushtë në trajtën e gjethes së shelgut, me bisht tubiform me prerje rrethore. E gjithë fleta përshkohet nga një kurriz konik gypor, gjithashtu me prerej rrethore. Supet i ka të rrumbullakuara, ndërsa bishti gypor fare afër fletës, përshkohet horizontalisht nga dy vrima përçinash. Gajtësia e përgjithshme 20.5cm, gjatësia e fletës 10cm, gjërësia maximale e fletës 2.4cm. Është një variant i majës së heshtës së tipit me fletë në trajtë gjethi. Është e ngjashme me heshta analoge të tumës IV të Pazhokut[94] etj. Datimi më i mundshëm: periudha submikene (1125-1050 para Kr.) ose protogjeometrike (1050-900 para Kr.)[95].

a2. Dyvegjake ilire e restauruar. Gjetur në fshatin Vajkal (Bulqizë). Ruhet në MHP. Nr.inv.1471, fig. 36a, 2. Lartësi 9cm, diametri i grykës 6cm dhe i trupit11cm. Ka trup dykonik të theksuar, qafë të shkurtër, buzë të drejta dhe fund konkav. Vegjët vertikale me prerje eliptike, që lartësohen mbi grykë, i ngjiten enës në zonën e shpatullave, mbi vijën shumë të theksuar të karrinimit. Është punuar me brum argjilor të pastruar, me pak grimca kuarci, me pjekje dhe lëmim të mirë. Mungesa e zbukurimit dhe dykoniciteti i theksuar, i japin enës së Vajkalit, veçori lokale në raport me enët analoge të kulturës ilire të kësaj periudhe. Datohet në periudhën submikene ose protogjeometrike, nga shoqërimi i saj me majën e heshtës të përshkruar më lart[96].

b. Periudha e zhvilluar e epokës së Hekurit (shek. VIII-VII para Kr.)

b1. Majë heshte hekuri me fletë në trajtë gjethi. Është gjetur në Qafën e Buallit, në skajin perëndimor të luginës së Bulqizës (x-41°28′54′′, y-20° 11′ 43′′, z-844m). Ruhet në MHP. Nr.inv.1471, fig. 36b. Gjatësia e përgjithshme është 19cm, gjatësia e fletës 11.5cm dhe gjatësia e tunit 7.5cm. Përfshihet në tipin e heshtave me fletë në trajtë gjethe plepi, me gjërësi max. 4.2cm, të përshkuar nga kurrizi gjatësor me prerje rombike, tun tubiform me prerje rrethore dhe diametër max. 2cm. Në anën e jashtme, përkatësisht në 1/3 e gjatësisë së tij, tuni është i hapur. Raporti i gjatësisë së tunit me gjatësinë e përgjithshme të heshtës është 1:2.5. Datohet në periudhën e zhvilluar të epokës së Hekurit, shek. VIII-VII para Kr.[97].



Fig. 36a1-2. Vajkal: Heshtë bronzi dhe dyvegjake ilire

c. Periudha mesjetare paraosmane dhe periudha e Skënderbeut (shek. XIV-XV pas Kr).

c1. Majë shigjete hekuri. Zbuluar nga punimet bujqësore në fushën e fshatit Vajkal. Ruhen në MHP, nr. inv. 44, fig. 36c, 1. Përmasat: gjatësia e përgjithshme 8.5cm, gjatësia e fletës 4cm, gjërësia e



Fig. 36b. Majë heshte hekuri (Qafë Buall); 36c. Maja shigjetash mesjetare (Vajkal)

fletës 2cm, gjatësia e bishtit konik 4.2cm, diametri i bishtit 0.6-0.8cm. Është e tipit me fletë në trajtë gjethi, me veshëza të zhvilluar, me bisht konik gypor. Fleta me prerje trekëndëshe, përshkohet nga një kurriz gjatësor me prerje ovale në të gjithë gjatësinë e saj.

c2. Majë shigjete hekuri. Zbuluar nga punimet bujqësore në fushën e fshatit Vajkal. Ruhen në MHP, nr. inv. 45, fig. 36c, 2. Përmasat: gjatësia e përgjithshme 7.2cm, gjatësia e fletës 3.2cm, gjërësia e fletës 1.7cm, gjatësia e bishtit konik 3.6cm, diametri i bishtit-0.8-1cm. Është e tipit me fletë në trajtë gjethi, pa veshëza, me bisht konik gypor. Në dallim nga maja e shtizës nr. 1, ka fletë me prerje trekëndëshe të shtrirë dhe kurriz shumë të lehtë gjatësor. Maja shigjetash me forma të ngjashme njihen në periudhën e hershme mesjetare, të zbuluara në varrezat e kulturës arbërore të Krujës[98], Lezhës[99], kalasë së Dalmaces[100], kështjellës së Pogradecit[101] etj, dhe vazhdojnë të përdoren edhe gjatë shek. XIV-XV pas Kr.

c3. Valikardhë (x-41° 30› 24»; y-20° 19› 8», z-625m). Enë e tipit ojnohe. Zbuluar nga punimet bujqësore në fshatin Valikardhë të Zerqanit (Bulqizë) (x-41° 30›24»; y-20° 19› 8», z-625m). Ruhet në Muzeun Arkeologjik, Tiranë, nr. inv. 16478. Përmasat: lartësi 13.5cm, diametri i trupit-9cm, diametri i fundit 7cm, pesha 290gr., fig. 37a. Ena ka grykë trifletëshe me diametër 5.5cm, lëfyt të holluar në majë, trup të fryrë sferik, që veçohet nga gryka me një profilim të lehtë, fund të sheshtë dhe vegjë biforata të thyer. Është punuar me brum të pastër argjilor me ngjyrë rozë dhe ka pjekje shumë të mirë. Ajo është lyer me angobë të hollë të kuqëremtë në rozë dhe është zbukuruar me glazurë polikrome të tipit *"maiolica arcaica"* [102]. Zona e zbukuruar përfshin të gjithë trupin e enës, nga fundi deri në buzë. Motivet me karakter gjeometrik përfaqësohen nga dy shirita në formë të germës"U", të alternuar me shirita të valëzuar vertikal midis tyre, të gjitha këto të realizuara me pastë të gjelbër. Fusha e shiritave në formë U-je, është e mbushur me pastë të bardhë, e cila nga pjekja në disa vende ka fituar qelqëzim me ngjyrë portokalli. Është enë e kushtueshme importi, e sjellë ose nga brigjet italike, ku enë të tilla gjenden në Pulia, Bari, Venecia etj, dhe datohen në vitet 1350-1450 pas Kr.[103]. Gjetja e saj në afërsi të qytezës së Valikardhës, dëshmon për një standart relativisht të lartë ekonomik e kulturor të përdoruesëve të saj. Enë të ngjashme, të zbukuruara me "*sgraffito polychrome*" vazhdojnë të përdoren edhe gjatë shek. XV dhe në fillim të shek. XVI pas Kr., kur shënojnë një përhapje mjaft të gjërë në gjithë Egjeun dhe Mesdheun Lindor[104]. Gjetja e saj pranë qytezës së Valikardhës, dëshmon për një standart relativisht të lartë ekonomik e kulturor të përdoruesëve të saj.

c4. Mokër bloje, e fragmentuar. Gjetur gjatë surveit të vitit 2018, në sipërfaqen e kreshtës së "Kullës së Skënderbeut". Përmasat: diametër 52cm, trashësi 6cm dhe diametri i vrimës së aksit-5cm (fig. 37b). Mokra të tilla bloje janë të zakonshme në vendbanimet mesjetare kudo në Shqipëri dhe më gjërë.



Fig. 37a-Ojnohe (Valikardhë)



Fig. 37b-Gurë mokre (Kulla e Skënderbeut)

(vijon në faqen 21)





Grupi i punës në majën e "kullës se Skënderbeut"

Referenca

71 Sadiku 1971, 222.
72 Ceka-Adami 1951, 6.
73 Botuesit e burimeve bizantine janë shprehur për lokalizimin e qytetit të Geties në fshatin Godvi të Bulqizës, i cili gjendet pranë rrugës nga kalonin ushtritë turke që shkonin kundër Krujës, e cila gjendet rreth 50km në perëndim të këtij qyteti. Krhs. Bozhori-Liço 1975, shën. 76, 330.
74 Sipas L. Halkokondilit *" Murati duke avancuar së pari rrethoi qytetin e Sfetigradit* (në origjinal : Sfeti) *dhe u propozoi të rrethuarve që ta dorëzonin atë dhe secili prej tyre do të shkonte në shtëpinë e tij. Ata nuk u bindën. Pastaj* (Murati) *sulmoi me jeniçerët dhe pushtoi qytetin plotësisht dhe e robëroi; të gjithë burrat i vrau. Pastaj duke avancuar mori me marrëveshje* ***Getien,*** *dhe mbasi i ktheu në skllevër ata që gjendeshin brenda në qytet, e drejtoi ushtrinë kundër Krujës".* Krhs. Halkokondili, *Lufta e Sfetigradit më 1448*, Cituar nga Bozhori-Liço 1975, 330.
75 Falenderoj miqtë dhe bashkëpunëtorët që më kanë shoqërur në dy vizitat e realizuara në këtë monument: (gusht 2018): Gazmend Sejdi (Drejtor i Shkollës 9 vjeçare "Sh. Tançi" Bulqizë), Sami Curri dhe Geri Emiri (gazetarë), Lulzim Hupi (pronar i bujtinës "Hupi"), dhe Ervin Kujtila (arkeolog); (shtator 2018): Gazmend Sejdi (Drejtor i Shkollës 9 vjeçare "Sh. Tançi" Bulqizë), dy nxënësit e Shkollës së Mesme Bulqizë, Renis Isufi dhe Bleon Zogu si dhe Dr. Elio Hobdari-arkeolog (IA-Tiranë).
76 Ceka-Adami 1951, 3.
77 Shikuar në terren nga autori.
78 Karaiskaj 2016, 118, fig. 128.
79 *Idem,* 141, fig. 157.
80 *Idem,* 161, fig. 185.
81 *Idem,* 129, fig. 140.
82
83 Karaiskaj 1985, 66.
84 Saraçi 1987, 210.
85 Bunguri 2009, 47, fig. 32.
86 Bunguri 2014, 297, fig. 8.
87 Bunguri 2011, 215, fig. 11.
88 Anamali 1967, 106.
89 Karaiskaj 1985, 60-61, 66-67, tab. I.
90 *Idem*, 67.
91 Hoxha 2016, 163, fig. 8b.
92 Anamali 1967, 108 ; Saraçi 1987, 205-206.
93 Ceka-Adami 1951, 6.
94 Bodinaku 1982, 79, tab.V,3.
95 Bunguri 1989, 67-69, tab. I, 1; Bunguri 2010, 253, tab. CIII, 1.
96 Bunguri 2010, 253, tab. CIII, 2.
97 Bunguri 2010, 256, tab. CVI, 12.
98 Anamali-Spahiu 1979-1980, 57, tab. IV, 7.
99 Prendi 1979-1980, 131, tab. XVII; 1-3.
100 Spahiu 1964, 82.
101 Anamali 1979-1980, 231, tab. XI, 5.
102 Crescenzo 1992, 38-49.
103 *Idem*.
104 Vroom 2005, 143, tab. 2.3.

Rruga e Arbërit nr. 174

reagim

Reagim rreth shkrimit “Golloborda dhe Dibra, një ngulmim për të krijuar një panoramë sa më të plotë dhe sa më të qartë njohëse historike””, shkruar nga Halil Teodori, gazeta “Rruga e Arbërit”, nr. 171, tetor 2020.

Ne, KALABARDHASIT, jemi lisa qindra shekullorë në tokën tonë amtare iliro-arbërore

Nga **KADRI DAUTI**

Do të shkruaj pak gjatë, se nuk mund të shkruaj dot shkurt, rreth shkrimit të Halil Teodorit titull: “*Golloborda dhe Dibra, një ngulmim për të krijuar një panoramë sa më të plotë dhe sa më të qartë njohëse historike*”, botuar në nr. 10 (171) tetor 2020 të gazetës “Rruga e Arbërit”. Do përpiqem të shkruaj si intelektual, dhe shpresoj të jem në nivelin e dëshiruar për lexuesit dhe autorin e shkrimit, por edhe për çdo intelektual tjetër që flet për identitetin e kalabardhasve (gollobordasve). Por para se të flas në mënyrë intelektuale, dua të them disa fjalë shpirtërore e ndjesie si kalabardhas për çdo intelektual tjetër që gënjen, që shpif për origjinën, historinë dhe kulturën tonë të kalabardhasve dhe pretendon se flet “me përgjegjësi profesionale dhe historike”. Natyrisht, gjatë këtij reagimi mund të shkel edhe ndonjëherë etikën e të shkruarit, por me gënjeshtarët, shpifarakët, të paditurit, fyesit dhe antikombëtarët do ta thyej disi. “Plumbi do plumb”, - themi ne, dibranët dhe shqiptarët.

Kur lexova artikullin e z. Halil Teodori, në fillim flisje gjatë për të vërteta historike dhe shtroje problemin e zajeve, mendova se vërtet do jeni objektiv në çështjen e identitetit të kalabardhasve dhe nuk e lexova me vëmendje këtë pjesë. E konsiderova të mirëfilltë të vërtetën, siç betoheshe ti në fillim. Pas disa ditësh takohem me një mikun tim kalabardhas, i cili ishte irrituar shumë me artikullin tënd. Rilexoje, - më tha - se është vërtet një mashtrim i gjallë, një fyerje për ne, kalabardhasit. Ai nuk di asgjë për Kalabardhën dhe flet paçavure. E rilexova artikullin dhe u irritova shumë. Po, po, vërtet u irritova pa masë dhe u befasova për absurditetin që ju, z. Halil, shkruani. Nuk desha të besoja se ti ishe një shqiptar, një patriot. Se kështu siç shkruani ju, vetëm një nacionalist i sëmur sllav, një bullgar i paditur apo i çartur nga mendtë shkruan. Dikush që e quan veten intelektual, dibran, shqiptar, patriot, nuk mund të fyej apo nëpërkëmbë asnjë popullsi, jo më një popullsi kaq fisnike, ndër më patriotiket në trojet shqiptare, siç është ajo e Kalabardhës (Gollobordës).

Ju them shkurt, fort e troç: ja fut vërtet kot, gënjen, mashtron, por edhe fyen rëndë. Nuk mendoj se ti i përket kategorisë së të shiturve tek sllavët, “rasputinëve” kalabardhas, batakçinjve, që s’kanë nder e dinjitet dhe shiten për pesë aspra për të folur me gjuhën e nacionalistëve sllavë. Nga ata që mohojnë gjakun e tyre, që janë gati të përdhosin varrin e babait të tyre vetëm të mbushin xhepat me lekë. Por po thoni të njëjtën gjë, si ata që paguhen me lekë nën dorë nga agjenturat sllave për të mbajtur paksa gjallë këtë frymë nacionaliste ndaj trojeve shqiptare, posaçërisht Kalabardhën. Siç shkroi serbi, M. S. Filipovici, i paguar nga qarqet fetare serbe apo nacionalizmi serb.

* * *

Zoti Teodori,

me ç´të drejtë tjetërson përkatësinë etnike të kalabardhasve? Me ç´të drejtë ua mohon gjakun, nënat, baballarët, gjyshërit, stërgjyshërit, katragjyshërit kalabardhasve? Çfarë borxhi të kanë kalabardhasit? A i ke pyetur ndonjëherë kalabardhasit për identitetin e tyre? Ti nuk qenke kalabardhas, megjithëse jeton që prej 580 vjetësh në Kalabardhë! Hasan Muglica nuk qenka kalabardhas, kur ka lindur, rritur, jetuar e luftuar për këtë tokë të shenjtë! Që ngriti në këmbë kalabardhasit për lirinë e trojeve të veta dhe gjuhën e kulturën kombëtare shqiptare! Që u varros i gjallë në truallin e Kalabardhës nga dushmanët sllavë! Qemal Stafa nuk qenka kalabardhas, që prindërit e tij u përzunë nga Zabzuni nga pushtuesit serbë? Këtyre u thua mendime intelektuale, z. Halil? Këto mendime mund t´i falen dikujt, që është lindur e banon qindra kilometra larg Kalabardhës, p.sh. nga Shkodra, Vlora, Saranda, por jo një “intelektuali” të “Grykës së Zajeve”.

Këto mendime mund t´i thotë një pseudohistorian, një injorant i historisë, një bujk apo blegtor, një mashtrues, një “rasputin”, një nacionalist sllav, por kurrsesi një intelektual, aq më pak që t´i thotë vetes shqiptar. Nëse ti merr përsipër të rreshtohesh në anën e të parëve, dije mirë se nuk je me të vërtetën historike, me objektiven, që aq shumë pretendon se e dashuron.



Shtrirja e Kalabardhës

Kalabardhasit janë 100% shqiptarë në gjak, në shpirt e në etnokulturë (norma e kanune, doke e zakone). Kjo është e vërteta e pakundërshtueshme. Në regjistrimin e vitit 1989, në Shqipëri nuk është regjistruar asnjë me kombësi bullgare, ndërsa 0.148% e popullsisë u regjistruan si maqedonas dhe ato jo në zonën tonë.

Sapo Shqipëria të bëhet vend i BE dhe nuk ka nevojë më kush për pasaportë sllave. Se të gjithë e dinë, se pasaporta bullgare kanë marrë më shumë shqiptarë nga Tirana, Elbasani, Durrësi, Shkodra, Fieri, Vlora etj., sesa kalabardhasit dhe të gjithë kanë ikur në vendet evropiane për punë, asnjë në Bullgari.

Kështu është kur flet e shkruan nga Amerika. Kur nuk e ke shkelur një herë krahinën e Kalabardhës; pa e njohur mirë historinë e popullsisë së saj kreshnike, që e ka mbrojtur vendin e saj, trojet e të parëve të tij, me jetën e gjakun e tyre ndaj sllavëve, serbëve, bullgarëve, maqedonasve dhe çdo lloj pushtuesi osman, italian, gjerman, austriak; pa i njohur rrënjët, ADN-në e vërtetë të kalabardhasve; pa e njohur shpirtin atdhetar e patriotik të kalabardhasve. Për ata që kanë ngritur flamurin shqiptar në kullat e tyre dhe janë vrarë për atë flamur. Për ata që në luftë shkonin me flamurin shqiptar në ballë. Për ata burra që kanë mbajtur të njëjtin kostum tradicional sikurse gjithë dibranët e tjerë, sikurse të parët e tu. Nëse katragjyshit e tu kanë strehuar një herë Skënderbeun, kalabardhasit e kanë mbajtur 25 vjet në kalatë, në shtëpitë, në sofrat e tyre, në zemrat e tyre. Atje ka pasur vendbanimet në rast luftërash e në kohë paqe, atje veronte dhe stërvitej ushtria e Skënderbeut dhe kalabardhasit jo vetëm i ndërtonin kalatë e tij, por edhe i bashkoheshin ushtrisë së Skënderbeut të luftonin në mbi 18 beteja kundër osmanëve.

Nëse ti ndjehesh i turpëruar të jesh kalabardhas është kompleksiteti yt. Ne, kalabardhasit, jemi shumë krenarë për origjinën, identitetin tonë shqiptar, për AND-në tonë iliro-arbërore, për dinjitetin tonë, për historinë tonë, për atdheun dhe vendlindjen tonë, Kalabardhën. Po, po, e themi me gjithë shpirt. Më krenarë se çdo kush në botë. Më krenarë se bijtë e Zeusit. Dhe ti, si intelektual, mund ta dish, që të jesh krenar me origjinën tënde do të thotë të jesh shqiptar, jo sllav. Pra, është një dëshmi tjetër për identitetin tonë iliro-arbëror, se si çka thënë dikush, vetëm ne, shqiptarët, krenohemi me kombësinë, jo me besimin si kombet e tjera të Ballkanit.

Dhe e meritojmë të jemi krenarë për vlerat mjaftë të arrira humane, kulturore e patriotike që kemi. Të jesh kalabardhas, do të thotë të jesh qelibar në shpirt, i besës, i nderit, paqësor, mikpritës, trim e fisnik, patriot, të jesh i ditur dhe i dobishëm për familjen, shoqërinë e kombin. Kalabardhasit janë të punës, të penës dhe të pushkës. Këto cilësi i gëzon çdo bir i Kalabardhës, qoftë ai që mund të quhet më i varfër ndër ne. Ne nuk jemi arrogantë, fodull, nuk na ka marrë koka erë. Ne nuk e kemi zakon të gërthasim shumë, por na detyroni ju të ngremë zërin për krenarinë tonë të mbështetur në sjelljet, arritjet dhe veprat tona. Ne jemi kalli plotë dhe këtë e kemi treguar me vepra. Ne na njeh Shqipëria, Ballkani dhe Evropa, se i kemi ndërtuar me duart tona të arta. Kush tjetër i ka cilësitë më të mira se këto?

Nëse nuk e di, ja si ne, kalabardhasit i këndojmë tokës arbërore:

“Rosa rosit, v’Arbanoshka zemja = *shi i imët bie në tokën arbërore*

shto na rosi cervenion bajrak = *që na e lagu flamurin e kuq*

rosa rosit, v’Arbanoshka zemja = *shi i imët bie në tokën arbërore*

shto na rosi kiteni svatovi... = *që na i lagu krushqit e stolisur*.

* * *

Tani le të hyjmë më në temë, për ato që ti zografis dhe pretendon të thuash të vërtetën për etninë e kalabardhasve (gollobordasve).

Kur stigmatizon: “*1. Gollobordasit janë sllavë*”, - ti gënjen, mashtron, spekulon, fyen kalabardhasit.

Sepse, **kalabardhasit janë 100% shqiptarë në gjak, në shpirt e në etnokulturë** (norma e kanune, doke e zakone). Kjo është e vërteta e pakundërshtueshme. Në regjistrimin e vitit 1989, në Shqipëri nuk është regjistruar asnjë me kombësi bullgare, ndërsa 0.148% e popullsisë u regjistruan si maqedonas dhe ato jo në zonën tonë.

Sepse, **nuk ka asnjë sllav në Kalabardhë**. Dhe këtë mësoje mirë ti, z. Halil dhe soji i atyre që flasin për sllavë në Kalabardhë. Mos flisni si i teket kokës tuaj, si ua do oreksi apo egoizmi, por flisni nëse keni fakte historike, flisni me dëshmi shkencore, konkrete. Mos flisni me terma të përgjithshëm, gjepura, se kalabardhasit janë sllavë, por nëse keni fakte thoni, *x.y.* është bullgar, *a.b.* është maqedonas, apo *c.d.* është serb. Dhe kështu mund të bëjmë analizat e ADN-së e të vërtetojmë shkencërisht, gjenetikisht, nëse janë vërtetë të tillë. Pra, do ta krahasojmë me vëllain, gjyshin, stërgjyshin, tetragjyshin, katragjyshin e tij historik atje ku prehet në vendet sllave apo me strukturën e ADN-së së bullgarëve, maqedonasve apo serbëve. Dhe do bindeni që e vërteta është kjo: **kalabardhasit janë shqiptarë të pastër**, se i përkasin ADN-së iliro-arbërore, racës shqiptare (halpogrupit E-V_{13}>E-Z5017 dhe përkatësisht nëngrupit CTS9320, trevës së Dibrës). Dhe mund ta dini, që vetë sllavët nuk kanë pranuar të bëjnë testin e kromozomit Y-it, se do u dalin të palarat me spekulimet me etninë e shqiptarëve në favor të synimeve nacionaliste të tyre ndaj trojeve shqiptare.

Sepse, po të ishin kalabardhasit sllavë, nuk do digjeshin tre-katër herë fshatrat e saj nga sllavët, nuk do vriteshin kalabardhasit nga ushtritë serbe apo bullgare, nuk do shpoheshin me bajoneta, nuk nxirreshin fëmijët me bajoneta nga barku i nënës, nuk do vriteshin barbarisht në Qafë të Përvallit 300 kalabardhas pleq, gra e fëmijë nga ushtria serbe, nuk do grabiteshin fshatrat e kalabardhasve nga pushtuesit sllavë. Nuk do të luftonin me mish e me shpirt, që fshatrat e tyre të mbeteshin në shtetin Shqiptar, kur kaloi komisioni Ndërkombëtar i Ratifikimit të Kufijve. Kështu, mësoje mirë se **Kalabardha nuk ka asgjë mbi tokë e nën tokë bullgare apo maqedonase**, por që ka qenë kala për Skënderbeun dhe mburoja e parë e trojeve arbërore ndaj armiqve.

Sepse, çfarë janë kalabardhasit shko e pyeti, shko e shiko pasaportat historikisht, shko shiko regjistrat e gjendjes civile, shko shiko në arkiva historikët e fshatrave e të fiseve, shko e pyeti vetë ata të ta plasin në fytyrë se kanë gjak shqiptari, ashtu siç i kam pyetur unë dhe i kam anketuar. Po, në Kalabardhë mund të gjendet ndonjë “bullgar”, veçse një i paditur, injorant i historisë, ndonjë pijanec, ndonjë i varfër, që ka nevojë aktuale për një pasaportë për të shkuar emigrant në vendet evropiane dhe thotë se do të jetë bullgar, por jo se është bullgar. Apo ndonjë “rasputin“, që kërkon të përfitoj para nga shteti Bullgar apo të bëhet deputet në parlamentin shqiptar, me ndihmën e Bullgarisë. Dhe kaq.

Do bindesh për këtë vetëm sapo Shqipëria të bëhet vend i BE dhe nuk ka nevojë më kush për pasaportë sllave. Se të gjithë e dinë, se pasaporta bullgare kanë marrë më shumë shqiptarë nga Tirana, Elbasani, Durrësi, Shkodra, Fieri, Vlora etj., sesa kalabardhasit dhe të gjithë kanë ikur në vendet evropiane për punë, asnjë në Bullgari.

Mosdija jote, me apo pa qëllim, mbështet politikën asimiluese dhe mohon identitetin gjenetik ilir të kalabardhasve, pavarësisht se ti predikon se për “mundësim i përvetësimit me pa të drejtë të historisë“. Me padijen tënde rreshtohesh në krahun e antishqiptarëve, gënjeshtarëve, shpifësve të tillë si: A. S. Filipoviç, I. S. Jastrebov, Aleksandër A. Novik, Nj. Limanovski, E. Milanov, Svietieva, Y. Xhemali & K. Steinke apo një farë Veselenka Tonçeva. Pra, je një gënjeshtar, një shpifës, një antikombëtar dhe po bën një krim intelektual. Kështu, ti e përdhos të vërtetën historike.

Kur thua: “*2- Gollobordasit kanë ardhur në këtë trevë, që ka marr emrin Gollobordë në shekullin e shtatë, kur vendi ishte nën perandorinë Bullgare*”, - gënjen, mashtron z. Teodori.

Sepse, kalabardhasit nuk kanë ardhur në këtë trevë në shekullin e shtatë, por janë ilirë-arbërorë, autoktonë në këto troje shqiptare dhe se bullgarët i gjetën ata aty. Carët bullgarë përdorën gjithë ushtrinë për t’i mposhtur kalabardhasit dhe vetëm pas disa dhjetëvjeçarë rezistence e luftërash shpërnguli me forcë popullsinë e disa fshatrave për 80 vite dhe i internoi në malet e Pindit. Kjo popullsi u rikthye në trojet e veta, se ishin etnik, ilir, arbëror. Nuk ishin sllavë. Në Kalabardhë kanë qëndruar vetëm ndonjë familje bullgare si punëtorë në tokat e të pasurve dhe disa barinj diku në malet e Jablanicës dhe ikën përsëri nga kishin ardhur. Dhe këtu mbaron historia e bullgarëve në këto treva.

Sepse, toka e Kalabardhës nuk ishte e shkret, por me popullsi të lashtë vendase, autoktone. Mbi çfarë bazash e thua, “mundësim i përvetësimit me pa të drejtë të historisë?? Kush po e vjedh historinë, ne iliro-arbërorët apo sllavët, bullgarët vjedhin historinë tonë? Në fakt ti po bën vetë krim intelektual, me të gjitha deklarimet e mësipërme.

Zona e Kalabardhës nuk ka qenë asnjëherë e pabanueshme dhe nuk është mbajtur asnjëherë vakëf.

Kur zografis: “*3- Gollobordasit flasin vetëm gjuhën e tyre, që është gjuhë sllave.*“, - përsëri gënjen, z. Teodori. Gënjen se vetë e pranon më poshtë, që e flasim gjuhën shqipe. Dhe e unë po të them e flasim bukur, shumë bukur gjuhën shqipe.

Po, z. Teodori, kalabardhasit flasin gjuhën e tyre, që është gjuha shqipe, gjuha amë, jo gjuhë sllave. Se edhe shqiptarët (kalabardhasit)

Shkruajta “në emër të mirënjohjes, në emër të thirrjes së gjakut, në emër të plisit, në emër të dinjitetit të vendlindjes“ time, Kalabardhës, të atdheut tim, Shqipërisë, të kombit tim shqiptar.

Po të ishin kalabardhasit sllavë, nuk do digjeshin tre-katër herë fshatrat e saj nga sllavët, nuk do vriteshin kalabardhasit nga ushtritë serbe apo bullgare, nuk do shpoheshin me bajoneta, nuk nxirreshin fëmijët me bajoneta nga barku i nënës, nuk do vriteshin barbarisht në Qafë të Përvallit 300 kalabardhas pleq, gra e fëmijë nga ushtria serbe, nuk do grabiteshin fshatrat e kalabardhasve nga pushtuesit sllavë. Nuk do të luftonin me mish e me shpirt, që fshatrat e tyre të mbeteshin në shtetin Shqiptar, kur kaloi komisioni Ndërkombëtar i Ratifikimit të Kufijve. Kështu, Kalabardha nuk ka asgjë mbi tokë e nën tokë bullgare apo maqedonase, por që ka qenë kala për Skënderbeun dhe mburoja e parë e trojeve arbërore ndaj armiqve.

në Bullgari flasin gjuhën bullgare, por ama janë dibranë, janë shqiptarë. Apo edhe ata janë bullgarë, sipas teje? Edhe shqiptarët (kalabardhasit) e Kalabrisë flasin italisht, por janë dibranë, janë shqiptarë. Apo edhe ata janë italianë?

E folura sllave në disa fshatra të Kalabardhës, nuk ka të bëjë fare me identitetin ilir, arbëror të kalabardhësve. **Në Kalabardhë nuk ka pasur asnjëherë e nuk ka asnjë diasporë popullsie sllave, as serbe, as maqedonase e as bullgare.** Zhargoni sllav është një mbivendosje gjuhësore, që e ka imponuar Perandoria Bullgare në kohën e pushtimit të kësaj zone në shekujt 9-11-të, me mjete të ndryshme. E folura sllave e një pjese të popullsisë së fshatrave të Krahinës nuk është “gjuhë e nënës”, por e huazuar, e imponuar nga rrethana historike, si nevojë jetike krahas gjuhës arbërore. Padyshim, përhapja e zhargonit sllav mbështetej nga pushtuesi në platforma etnike për spastrim etnik dhe shoqërohej me masa shtrënguese e detyruese.

Natyra e shqiptarëve, por edhe e kalabardhasve, në zemër të Arbërisë, ka qenë e tillë që në lashtësi, siç historiani i lashtësisë, Straboni, thotë se: “Fiset pellazge ishin bilingë ...”, sepse flitnin latinisht dhe shqip. Shqip kanë folur edhe filozofë e historianë të lashtë grekë, dhe ne do mund t’i quajmë shqiptarë?

Por ti, si intelektual, mund ta dish, që gjuha është elementi i pestë dhe i fundit në përcaktimin e identitetit etnik, kombëtar. Para saj janë lidhja gjenealogjike, trashëgimia e koherenca historike, trashëgimia kulturore dhe traditat, ritet e zakonet.

Kur shkruan: “*4- Golloborda, gjuhën shqipe e flet si gjuhë letrare.*“, - vetëm këtu nuk shpif, nuk gënjen. Por besoj se nuk ka asgjë të keqe të flasësh bukur gjuhën shqipe.

Po, ke të drejtë, z. Teodori, kalabardhasit e flasin gjuhën shqipe të normuar, gjuhën e lartë, zyrtare shqipe. Mund ta dish, se kalabardhasit historikisht e kanë dashur fortë gjuhën e të parëve të tyre, gjuhën shqipe. Kanë kontribuar në shkallë kombëtare për këtë gjuhë të bekuar të Zotit, duke marrë pjesë në të gjitha kongreset kombëtare si të Manastirit dhe Elbasanit, si dhe ato të Dibrës, për gjuhën. Për këtë gjuhë u mblodhën edhe në kuvende të posaçme të vitit 1909, siç ishte Kuvendi i Ujit të Bardhë në Fushë Klenjë. Kalabardhasit dërguan djemtë të arsimohen për përhapjen e gjuhës dhe kulturës shqipe, i kthyen shtëpitë e tyre në shkolla për këtë gjuhë të bukur, hapën ndër të parët në trevën e Dibrës shkollat shqipe, i sollën librat shqip nga të gjitha anët fshehurazi nga hasmi dhe nga bashibozukët e tjerë shqiptarë, dhanë jetën për të mbrojtur gjuhën dhe kulturën shqipe. Besoj se e dini, se përveç Hasan Muglicës, ka plotë martirë kalabardhas të gjuhës shqipe si Haziz Lila, Vasil Pleushku etj. Kalabardhasit shkuan edhe në trevat shqiptare tu mësonin të tjerëve gjuhën mëmë, gjuhën shqipe.

Kur shkruan: “*5- Golloborda nuk e flet gjuh*ën e *Dibrës”,* - përsëri gënjen.

Po, kalabardhasit flasin edhe gjuhën dibrane, e flasin në sjellje e kulturë, e flasin me penë e pushkë, e flasin sa herë ka nevojë atdheu dhe liria e Shqipërisë. Shiko si këndojnë kalabardhasit në gjuhën e Dibrës, kur ushtria bullgare kishte ardhur me pushkë të ndalonte përhapjen e shkollave dhe gjuhës shqipe në Krahinën tonë:

Fatime, motër ku të kam?
Qëndro vëlla, se këtu jam.
Hasmi ne na ka rrethue,
se harfe shqipe kemi kërkue.

Apo nuk është kjo gjuha e Dibrës, z. Teodori?

Edhe kur shkruan: “*6- Golloborda ka ritet e veta, zakonet e veta që janë ndryshe nga ato që ka Dibra.,* - gënjen përsëri.

Sepse, kalabardhasit, kalabërësit kanë njohur e zbatuar Kanunin e Skënderbeut, si mbarë treva e Dibrës. Njohin institucionin e besës e burrërisë dhe i çmojnë si të shenjta. Praktikojnë miqësinë, tolerancën dhe respektin e ndërsjellë. Në Kalabardhë nuk njihet gjakmarrja apo hakmarrja. Ata kanë derdhur gjak vetëm për mbrojtjen e trojeve të veta, lirisë së vatanit. Çdo vendim i kuvendeve të Maleve të Dibrës apo të Maleve Shqiptare historikisht është njohur, respektuar dhe kishte vlerë juridike në Kalabardhë.

Sepse, kalabardhasit gjithnjë kanë mbajtur flamurin shqiptar në shtëpitë e tyre, dhe asnjëherë nuk kanë lejuar të ngrihet ndonjë flamur i huaj. Nëse nuk e di, lexoje historinë e ngritjes së flamurit shqiptar në Ostren nga patrioti Elez Koçi me shokë, në Trebisht nga Hysen Destani, në Steblevë nga Haziz Lila etj. Jastrebovi, antishqiptari, vetë shkruan se kalabardhasve u printe në luftë flamuri shqiptar. Shikoje se çfarë flamuri ngrenë kalabardhasit në dasma dhe bindu për identitetin e kalabardhasve.

Sepse, ritet e zakonet e kalabardhasve janë të trevës dibrane, pavarësisht ndonjë riti që lidhet me kalendarin, ushqimin tradicional, filozofinë e jetesës. Edhe këto janë pasuri e kulturës së trevës dibrane.

Kur shkruan: “*7- Veshja e Gollobordës është karakteristike dhe përdoret vetëm nga kjo trevë.*“, - ja këput kot fare. Se çdo krahinë etnokulturore ka tiparet e veta në veshje, se nuk janë në një ushtri. Por kjo nuk e përcakton dot identitetin e kalabardhasve.

Po, z. Teodori, këtu ke të drejtë vetëm për veshjet e grave, që në Kalabardhë ka mbi 18 veshje të ndryshme, pothuaj e veçantë për çdo fshat. Por të gjitha me tipare shqiptare, me kolorit kuq e zi. Pasi kalabardhasit kanë qenë përherë të civilizuar, e kanë çmuar femrën dhe bukurinë e saj, e kanë respektuar atë. Kalabardhaset nuk kanë mbajtur kurrë perçe. Ata kanë qenë me kobure në brez e janë burrnesha.

Por besoj se e di, që kostumi popullor i burrave të Kalabardhës është po ai i dibranëve, i cili përbëhet prej: qeleshes së bardhë rrashtake, këmishës së bardhë prej pambuku me mëngë të rrudhura te kyçi i dorës, jeleku ose xhamadani të zbukuruar me gajtanë të zinj, mitani, mbathjet e gjata prej pambuku, tirqit, brezit të leshit të zbukuruar me disa ngjyra, çorape leshi, opinga prej lëkure lope me gjalma etj. Deri në vitin 1912 burrat e Kalabardhës kanë përdorur dollamat dhe fustanella. Apo edhe këto nuk janë dibrane, shqiptare?

E thënë me dy fjalë: Halil, çdo gjë që ke shkruar për Kalabardhën, janë të pavërteta.

* * *

Kur shkruan: *“..., zona ishte krejtësisht e pabanueshme, dhe mbahej si vakëf”,* - kjo është një shpikje e jotja. Sepse, trualli i Kalabardhës asnjëherë nuk ka qenë i zbrazur, vakëf. Historia ka dëshmuar se ka pasur shpërngulje të popullsisë pas rënies së vendit nën pushtimin osman, të rrënuar nga luftërat dhe qëndresa ndaj këtij pushtuesi, për t’i shpëtuar zhdukjes apo për të ruajtur besimin e tyre kristian, por kurrë nuk e kanë braktisur vendin e tyre. Lëvizje të popullsisë ka pasur në çdo krahinë, siç kanë ardhur edhe të parët e tu. Por asnjëherë popullsia e Kalabardhës nuk ka ikur në viset sllave, por në brendësi të vendit.

Kur thua se “popullsia e kësaj treve që përbën Gollobordën ka jetuar pothuajse gjithë kohën në kurbet” besoj se e ke fjalën vetëm për mjeshtrit e ndërtimit, jo për pleqtë, gratë dhe fëmijët e familjeve të Kalabardhës. Se ndryshe do të quhej një shkarje. Po, mjeshtrit kalabardhës kanë ikur në kurbet, si shumë shqiptarë nga trevat e tjera shqiptare, kanë ndërtuar veprat më madhështore kudo, Sofje, Selanik, Stamboll, Egjipt etj., kanë fituar dhe janë kthyer për te familjet e trojet e tyre dhe nuk kanë mbetur atje. Ata kanë ndërtuar shtëpitë e tyre, kanë ndërtuar kalatë për tu mbrojtur nga armiqtë sllavë, kanë ndërtuar Shqipërinë. Dhe gratë kalabardhase kanë qenë burrnesha e kanë mbajtur familjet të shëndetshme dhe kanë rritur e edukuar fëmijët e tyre me ndjenjat më të pastra njerëzore e

Gjuha është elementi i pestë dhe i fundit në përcaktimin e identitetit etnik, kombëtar. Para saj janë lidhja gjenealogjike, trashëgimia e koherenca historike, trashëgimia kulturore dhe traditat, ritet e zakonet. Kalabardhasit historikisht e kanë dashur fortë gjuhën e të parëve të tyre, gjuhën shqipe. Kanë kontribuar në shkallë kombëtare për këtë gjuhë të bekuar të Zotit, duke marrë pjesë në të gjitha kongreset kombëtare si të Manastirit dhe Elbasanit, si dhe ato të Dibrës, për gjuhën. Kalabardhasit flasin edhe dialektin dibrane, e flasin në sjellje e kulturë, e flasin me penë e pushkë, e flasin sa herë ka nevojë atdheu dhe liria e Shqipërisë.

patriotike.

Mos ki merak, z. Teodori, se askush nuk ka përse të të “njësoj me gollobordasit“ nëse ti nuk ke dëshirë, por edhe shqiptar mund të mos e konsiderosh veten, se helbete atje ku jeton mbase nuk ndihesh mirë. Kjo është thjesht ndjesi personale. Mos u shqetëso për këtë, mjafton që ua the të tjerëve dhe nuk besoj se ka kush interes të të njësoj ti gollobordas, pa dëshirën tënde. Këtë amanet tëndin, “nuk e tret as dheu“. Por ja që unë kam dëshirë të them gjithandej se jam kalabardhas, se vërtet jam i tillë. Dhe këtë amanetin tim, nuk duhet ta tres as dheu.

* * *

Meqë ju, z. Teodori, kërkon mendimin e intelektualëve për shtrirjen e Kalabardhës apo për “zajat“, mendoj se e ke fjalën për ata që kanë formim në fushën e historisë apo të etnologjisë, jo në fushën e bujqësisë, të blegtorisë apo frutikulturës. Se një agronom është specialist mund të flas p.sh. për buburrecat në bujqësi apo për luftën me vemjet në drufrutorët, një veteriner për ndërzimin artificial te bagëtitë etj. Por jo për identitetin e popullsisë, për përkatësinë kombëtare, për gjuhën, kulturën, për betejat e Skënderbeut në krahinën e Kalabardhës.

Edhe unë, për formimin dhe përvojën time, por edhe si bir i Kalabardhës, që kam lindur, rritur dhe jetuar në këtë truall, të bekuar, që kam dëgjuar mirë të thënat e tyre për identitetin tonë, që kam dëgjuar me mijëra grimca historike nga të parët tanë, nga të moshuar të zonës apo Krahinës, që kam hulumtuar në arkiva, që kam shfletuar qindra apo mijëra libra në fushën e historisë, që e kam shkelur çdo pëllëmbë të truallit të Kalabardhës, që kam pirë ujin e krojeve të saj, mund të jap mendimin tim për historinë e krahinës së Kalabardhës, për trashëgiminë historike të kalabardhasve apo për betejat e Skënderbeut, i vendosur vetëm të them të vërtetën historike. Por nuk mund të flas për prashitjen e ujitjen e misrit apo për luftën e karkalecave në bujqësi apo për racën e zgjedhur të dhisë në Krahinën tonë.

Unë nuk jam “intelektual“ i “Grykës së Zajeve“ dhe nëse më lejon të “prononcohem“ lidhur me “rivlerësimin njohës të kësaj përkatësie gjeografike dhe historike“, kujtoj se nuk ka emërtim “Gryka e Zajeve”, por gryka e zallit të Okshtunit apo të Borovës. Por për të parë se ku shtrihen “Gryka e Zajeve“, Borova, Zabzuni, Sebishti, Muglica, Okshtuni i Madh, Prodani, Shullani, Plepa, Oreshnja, Tërnova, Tërnova e Vogël, Smollniku apo Lubaleshi, ju kujtoj intelektualëve të “Grykës së Zajeve“ të shfletojnë vetëm Fjalorin Enciklopedik Shqiptar, botim i Akademisë së Shkencave të RPSSH, Tiranë, 1985, f. 313, në të cilin shkruhet: “*Shtrihet gati tërësisht në pellgun ujëmbledhës të përroit të Okshtunit. Kufizohet nga mali i Mirakës (1751 m) dhe i Lunikut 91628 m) në J, mali i Raduçit (2083 m) dhe maja e Zezë (2259 m) në L, mali i Kaptinës (1871 m) dhe pjesa L e malit të Lopës (2020 m) P, kurse në V hapet në pellgun e Dibrës. ... Qendrat kryesore të banimit janë: Klenja, Stebleva, Okshtuni, Ostreni, Tërnova, Çereneci, Zabzuni. ...* “ Këtu mund të shikosh se çdo lidhje kanë Kalabardha dhe “Gryka e Zajeve“. Këtu mund të shikosh se ishin apo jo Hasan Muglica, Qemal Stafa, Sabri Caka dhe Mentor Muglica kalabardhas (gollobordas) apo jo. Ju e dini besoj mirë shumë, se çfarë veprimtarie të shquar bëri Hasan Muglica për Kalabardhën (Gollobordën) dhe nëse do kishte mundësi do të çirrej nga varri për dëshminë tënde, sa të dëgjohej deri në New York e Washington. Por besoj se edhe gjyshi e stërgjyshi yt, do të çuditej me dëshminë tënde. Kur edhe Mustafa Qemali - Ataturku thotë se jam shqiptar, jam nga Kalabardha, besoj se edhe Hasan Muglica dhe Qemal Stafa do thonin të njëjtën gjë.

Për shtrirjen gjeografike e krahinës së Kalabardhës, nuk dua të përmend as dokumentimin e saj për herë të parë në defterin osman të vitit 1467, me 51 fshatrat e saj, (në të cilin futej e dhe Bulqiza, jo më Zerqani e Smollniku), as përcaktimin e historianëve më të shquar si Milan Shuflai etj., por për mendimin tim, Kalabardha shtrihet në hapësirën gjeografike: në veri deri në kryqëzimin e lumit Drin i Zi me zallin e Bulqizës, përfshi fushën e Gjoricës; si kufi lindor shërben lumi Drini i Zi, i cili e ndanë atë nga malësia e Kërçovës; në juglindje shtrihet deri në pellgun e Liqenit të Ohrit (i Sulmidit), në jug shtrihet deri në luginën e përroit të Llangës; në perëndim arrin deri tek shpatet e malit të Kaptinës.

* * *

Kur thua: “*Zona jonë ka nxjerrë heronj dhe figura të shquara, personalitete të rëndësishme të kulturës dhe dijes, guximit dhe vendosmërisë, traditës dhe atdhedashurisë. Kjo kolonë e gjatë dishepujsh të vlerave dhe krenarisë, i kanë shërbyer vendit, ...* “ nuk besoj se e ke fjalën për Kalabardhën. Se ajo ka nxjerr vërtetë heronj, vetëm të punës ka njëmbëdhjetë. Të gjithë i kanë shërbyer vendit, Dibrës, Shqipërisë. Po ti duhet të thuash për cilën zonë e ke fjalën?

* * *

E vërteta historike, identiteti i kalabardhasve është kjo që themi ne, vetë kalabardhasit, trashëgimtarët e të parëve tanë, jo pushtuesit sllavë dhe ata që kakarisin pas tyre.

Për konkretizim, po u tregoj ti dhe çdo intelektuali tjetër origjinën e fiseve të fshatit tim: Lladimericës, një fshat pothuaj në qendër të Kalabardhës, të cilin M. S. Filipovic e quan fshat serb. Një absurditet kozmik. Në fshatin tim banojnë dhjetë fise: Adilaj, Balaj, Dauti, Hoxha, Halilaj, Lika, Manaj, Sahitaj, Shahinaj, Shazimani. Ne e njohim mirë origjinën tonë të paktën prej gjashtë brezash. Fisi Adilaj ka ardhur nga Muhuri i Dibrës, rreth 200 vite më parë, i shquar për trimëri; fisi Dauti ka ardhur nga fisi Hoti i Lurës, rreth 250 vite më parë, i shquar për patriotizëm dhe trimëri; fiset Balaj dhe Hoxha janë degë e fisit Dauti; fiset Lika e Sahitaj kanë origjinën nga Okshtuni, të ardhur rreth 220-230 vite më parë, të shquar për patriotizëm dhe trimëri; fisi Manaj është degë e fisit Sahitaj; fiset Halilaj, Shazimani e Shahinaj janë autoktonë, vendas, shqiptarë të kulluar. Burrat e Lladimericës e përzunë nga fshati me hu edhe atë, që në 1991 guxoi të bëj shaka, se jemi maqedonas. Pra, ne jemi 100 % shqiptarë dhe ndjehemi të tillë në shpirt e në kulturë. Nëse dikush shkruan të kundërtën ne do ta marrim se do që të bëj shaka, por nëse e thotë seriozisht, i themi të shkoj te psikologu e të marrë aspirina, se nuk është në rregull nga mentë e kokës. Provoje edhe ju dhe shkoni në Lladimericë, dhe do shikosh vetë përgjigjen e bashkëfshatarëve të mi fisnik e atdhetarë.

* * *

Për sa më lartë, ne, kalabardhasit, jemi me kokën lartë. Askush nuk ka shanse të na nëpërkëmbë, të na fyej apo poshtërojë. Jo ti, por as Zeusi. Se ne, kalabardhasit, jemi lisa qindra shekullor me rrënjët thellë në tokën tonë amtare iliro-arbërore. Kemi qenë e jemi në gjendje të mbrojmë nderin e dinjitetin tonë. Jemi të punës, të penës dhe të pushkës. Në Kalabardha ka bu**r-rr**a, që i kanë dalë dhe i dalin zot vendit dhe vetes. Nëse nuk i besoni, mund t´i provoni.

U përpoqa si “intelektual“ i Kalabardhës t’u “përcjellë brezave nën dritën e fakteve dhe të vërtetave historike, ato elementë, ata faktorë përcaktues, të cilët janë jo vetëm bartës të së kaluarës, por edhe dëshmues të saj”, siç shkruani ju. Se e konsideroj të drejtë kur shkruan: “është një përpjekje është një angazhim, është kjo detyrë, ajo e cila na nxit të jemi ne ata që do të shkruajmë ato faqe të historisë që trualli na i ka besuar ne. Sepse vetëm ne mund ta matim dhimbjen e kësaj toke, ta dëgjojmë kushtrimin e këtyre maleve, t’u bindemi këshillave të etërve flokëbardhë, ta lehtësojmë dhimbjen e kësaj plage.“

Shkruajta “në emër të mirënjohjes, në emër të thirrjes së gjakut, në emër të plisit, në emër të dinjitetit të vendlindjes“ time, Kalabardhës, të atdheut tim, Shqipërisë, të kombit tim shqiptar.

Kadri Dauti, studiues historie

Rruga e Arbërit nr. 174
kulturë

Ky Ansambël është vlerësuar me çmime në dhjetëra festivale artistike folklorike mbarëkombëtare e ndërkombëtare

Ansambli Artistik **“Hazis Ndreu”- “Nderi i Kombit”** në 10-vjetorin e krijimit

Nga **Muharrem GJOKA**
President i Ansamblit





Në repertorin e tij numërohen me dhjetëra valle, këngë e interpretime të tjera krijuese, me të cila ky Ansambël ka “pushtuar” hapësirat mbarëkombëtare e ato ndërkombëtare si në: Turqi, Rumani, Bullgari, Itali, Kosovë, Maqedoni etj. Ansambli ka performuar në disa televizione ndërkombëtare e kombëtare si: Rai Uno, Tv Romania, TRT Turk, RTK Kosovë, RTV Koha Tetovë, Top Channel, Vizon Plus, Tv Klan, TVSH, etj.

Dhjetë vjet jetë kulturore artistike në aktivitet të pandërprerë, finalizuar me dhjetëra çmime kombëtare e ndërkombëtare, e kanë ngjitur Ansamblin Artistitik “Hazis Ndreu” - “Nderi i Kombit” në Panteonin e Vlerave. Për nga mosha mund të duket një ansambël i ri, por drejtuesit e tij, organizatorët, krijuesit dhe interpretuesit, pra stafi i tij ka një përvojë të vyer artistike, krijuese, ekzekutuese shumë vjeçare.

Nëse dhjetë vjet më parë (29 shtator 2010) Ansambli u krijua në traditën e shkëlqyer të Ansamblit “Kuvendi” të Zall Dardhës, një vit më parë ndjeva krenari legjitime, kur me propozimin tim trupa e tij u pagëzua me emrin “Hazis Ndreu”, - ikonë e artit e kulturës kombëtare që para tre muajsh do të merrte nga Presidenti i Republikës Ilir Meta dekoratën e lartë “Nderi i Kombit”.

Në repertorin e tij numërohen me dhjetëra valle, këngë e interpretime të tjera krijuese, me të cila ky Ansambël ka “pushtuar” hapësirat mbarëkombëtare e ato ndërkombëtare si në: Turqi, Rumani, Bullgari, Itali, Kosovë, Maqedoni etj. Ansambli ka performuar në disa televizione ndërkombëtare e kombëtare si: Rai Uno, Tv Romania, TRT Turk, RTK Kosovë, RTV Koha Tetovë, Top Channel, Vizon Plus, Tv Klan, TVSH, etj ku ka spikatur edhe në koncertet e mëdha festive, e ato të Vitit të Ri, duke kulmuar në momentin kur akrepat trokasin për ndrrimin e Vitit.

Ansambli Artistik “Haziz Ndreu” - ‘Nderi i Kombit’ ka marrë pjesë në realizimin e disa videoklipeve me këngëtarë të njohur si: Arif Vladi, Zef Beka, Lek Pecnikaj, Elizabeta Marku, Paro, Nertila Vreto, Visar Peja, Vera Laçi, Lirim Hoxha, Gentjana Gjergji, Edi Furra, Abedin Zenuni, Haxhi Maqellara e dhjetëra këngëtarë të tjerë të njohur në rang kombëtar.

Ky Ansambël është vlerësuar me çmime kombëtare në dhjetëra festivale artistike folklorike mbarëkombëtare si: -Me kupën fituese në Festivalin Mbarëkombëtar të Gjimnastradës, me rastin e 100 - vjetorit të shpalljes së pavarësisë, mes 32 grupeve pjesëmarrëse; me Certifikatë në Festivalin Kombëtar për fëmijët jetimë si dhe “Performanca më e mirë e Festivalit” në Festivalin Mbarëkombëtar në Rahovec, Kosovë .

Është vlerësuar dy vite radhas në Festivalin Mbarëkombëtar “Sofra Dardane”, (Çmim të Dytë në 2018 dhe me Çmim të Parë në 2019. Në kurorën e çmimeve të këtij festivali janë edhe: Çmimi “Dasma Shqiptare” në Festivalin mbarëkombëtar “Këngë Jeho”, Strugë; Çmimi i Dytë në Festivalin Mbarëkombëtar “Na bashkon Kënga dhe Vallja Shqipe”, Plavë e Guci -Mal i Zi; Çmim i Tretë në Festivalin Mbarëkombëtar të Talenteve të Reja në Pukë; Çmim i parë në Festivalin Mbarëkombëtar “Ruaj Traditën, Festo Ship”; Çmimi ‘Begatia e Festivalit’ në Festivalin Mbarëkombëtar “Burimet e Sharrit”, Tetovë; Kupa në Festivalin Kombëtar të organizuar nga bashkia e Tiranës etj. Në vitin 2015 Bashkia Kamëz e ka vlerësuar këtë Ansambël me Titullin “Artisti i Vitit”, ndërkohë që gjatë një dekade jetë artistike është vlerësuar me shumë e shumë çmime e diploma në festivale e veprimtari të ndryshme.

Ky bilanc mjaftë pozitiv është pasqyruar gjerësisht ne reportazhet e gazetarëve të mirënjohur Halil Rama e Sakip Cami, ku kanë spikatur edhe vlerësimet e Prof.Bujar Kapexhiut – Nderi i Kombit e të moderatorit të shumë talentuar Defrim Methasani.

Ansambli Artistik “Haziz Ndreu” - Nderi i Kombit ka përfaqësuar në mënyrë dinjitoze vlerat më të mira të folklorit, etnografisë e kulturës shqiptare në dhjetëra festivale ndërkombërate në mbarë Europën, ku vlerësimi ka qenë maksimal nga organizatorët e këtyre festivaleve. Pothuajse në të gjitha rastet Ansambli është vlerësuar me trofe e çmime, si në Turqi, Rumani, Bullgari, Maqedoninë e Veriut, Mal të Zi, Poloni, Itali etj.

Megjithëse 2020-ta ishte vit i trishtë si rrjedhojë e pandemisë Covid-19, Ansambli Artistik “Haziz Ndreu” - “Nderi i Kombit” ka marrë pjesë në tri festivale virtuale ndërkombëtare: në Stamboll në prill, maj dhe Nëntor, të organizuara për grupmosha të ndryshme dhe në të tri festivalet artistët tanë janë vlerësuar nga juritë ndërkombëtare të përbëra nga 17 anëtarë nga e gjithë bota, me çmim të parë dhe çmimin e madh “Grand Prix”. Në këto festivale pati vlerësim dhe për koreografin e ansamblit z.Avni Ndreu, që ishte pjesë e kësaj jurie ndërkombëtare (pa të drejte vote për Shqipërinë). Gjithashtu Ansambli Artistik “Haziz Ndreu” - “Nderi i Kombit” ishte i ftuar nga Ansambli ‘Federico Angelica’ Aviano, Itali për të përshëndetur virtualisht në ceremonitë festive me rastin e krijimit të këtij Ansambli.

Ansambli Artistik “Haziz Ndreu” - “Nderi i Kombit” ka qenë prezent në ceremoni zyrtare, organizuar për ngjarje, personalitete të shquara historike e shoqërore, në raste vlerësimi personalitetesh e kjo ka bërë që të ndjehemi të vlerësuar nga organizatorët kryesorë të këtyre veprimtarive.

Ansambli Artistik “Haziz Ndreu” - “Nderi i Kombit” është një Ansambël grupesh zinxhir (akademi) të organizuar në grupe nga mosha 5 vjeç e larte. Janë me mijëra artistë që kanë kalur në përvojën e këtij Ansambli në këto 10-vjet, duke mbushur skenat dhe sheshet e Tiranës, Kamzës, Ulqinit, Dibrës e mbarë Shqipërisë. Në shfaqjet e organizuara herë pas here nga ky ansambël kanë performuar artistët: Arif Vladi - Mjeshtër i Madh dhe “Kalorës i Urdhërit të Skënderbeut, Qerim Sula - Mjeshtër i Madh dhe “Kalorës i Urdhërit të Skënderbeut (pas vdekjes), Liri Rasha - Mjeshtër i Madh dhe “Kalorës i Urdhërit të Skënderbeut, Vera Laçi – Mjeshtër i Madh, Sherif Dervishi - Mjeshtër i Madh (pas vdekjes), Dardan Pepkola, Zaim Tollja si dhe këngëtarja dhe valltarja Erida Stana, valltaret: Adem Kurti, Fabjon Isufaj, Fatjona Ismailukaj, Eralda Jaurri, Serxho Rriçku, Ergys Doçi, Kristjan Kavalli, Marsida Zhgjuni, Orinda Prenci, Rexhina Qerimi, Livia Bushpepa, Ledion Zhgjuni, Jugers Muça, Sara Ndreu e tjere. Krijmtaria e këtij ansambli, e ardhur nga ajka e kompozitorëve si: Përparim Tomçini - Mjeshtër i Madh (pas vdekjes), Edmond Zhulali - Mjeshtër i Madh dhe “Kalorës i Urdhërit të Skënderbeut”, Kol Susaj - Mjeshtër i Madh, dhe udhëheqja artistike nën drejtimin e “Mjeshtrit të Madh” Xhelil Ymeraj dhe mjeshtrit të koreografisë Avni Ndreu ja kanë rritur vlerat dhe përmasat këtij ansambli duke i dhënë statusin e një ansambli kombëtar profesionist.

Krenarë për arritjet e këtij ansambli ndjehet edhe koreografja e valltarja e talentuar Earta Ndreu, edhe për faktin që Ansambli mban emrin e gjyshit të saj, Hazis Ndreu - këngëtar, koreograf, valltar, studiues dhe shkrimtar i përmasave mbarëkombëtare...



Ky Ansambël është vlerësuar me çmime kombëtare në dhjetëra festivale artistike folklorike mbarëkombëtare si: -Me kupën fituese në Festivalin Mbarëkombëtar të Gjimnastradës, me rastin e 100 - vjetorit të shpalljes së pavarësisë, mes 32 grupeve pjesëmarrëse; me Certifikatë në Festivalin Kombëtar për fëmijët jetimë si dhe “Performanca më e mirë e Festivalit” në Festivalin Mbarëkombëtar në Rahovec, Kosovë.

botim i ri

Në këtë libër me kujtime, në mënyrë të përmbledhur shkruhet edhe për takimet vjetore me shokët e shoqet e punës dhe të shkollës, vizitat tek të afërmit e tij jashtë shtetit,

Botohet libri "Një jetë maleve, Kujtime 4" me autor Bashkim Lleshi



Një vend të rëndësishëm në faqet e këtij libri zenë aktivizimi në kryesinë e Shoqatës LID, organizimi i Kuvendit Tekniko-Shkencor për Rrugën e Arbërit në maj 2007, ku ishte iniciatori dhe organizatori kryesor i këtij kuvendi, shkrimi i artikujve problematikë për ecurinë e kësaj rruge në gazetën "Rruga e Arbërit", marrja pjesë në aktivitete shoqërore si, në 60 vjetorin e Cetës së parë partizane të Dibrës në Zogje në qershor 2002, në promovimin e librit "Jeta dhe vepra e Aqif Lleshit" dhe ceremoninë e dhënies së titullit "Qytetar Nderi" i Dibrës së Madhe të shkencëtarit të shquar dibran Azmi Dibra...







Në dhjetor të vitit 2020, Botimet M&B botuan librin "Një jetë Maleve, - *Kujtime 4"* me autor Bashkim Lleshi, ku përshkruhen kujtimet e viteve të punës në Ndërmarrjen Gjeologjike të Tiranës, në vitet 1984-2008 dhe Drejtorinë e Albkromit Tiranë, në shtator 1998 - maj 1999.

Në 5 vitet e para në NGJ Tiranë gjatë viteve 1985-1990 autori ka dhënë një kontribut të rëndësishëm në drejtim të perspektivës për minerale të çmuar (platinoide, etj.) në zonën e Martaneshit, ku janë zbuluar objekte e shfaqje të reja mineralesh të çmuar në Krastë, Koxheraj, Kodra e Nënës, etj. Poshtë vendburimit të njohur të kromit Krastë u zbulua vendburimi Krasta e re, duke shtuar rezervat për mineralin e kromit në thellësi të vendburimit Krastë, si dhe u përcaktuan ligjësitë për gjetjen e shesheve perspektive për krom, nikel sulfur e minerale të çmuar në masivin dunitik të Martaneshit. Në vitin 1989 u dorëzua *Raporti me llogaritje rezervash i vendburimit të kromit "Krasta e Re"*, poshtë vendburimit të Krastës të zbuluar nga Ndërrmarrjet Gjeologjike Bulqizë e Burrel.

Pas 5 vite pune në Ekipin gjeologjik të Krastës së Martaneshit, një nga ekipet më të vështira të NGJ Tiranë, kolektivi i kësaj ndërmarrje, në mars 1990 nuk pranoi kandidaturën e paraqitur nga Ministria për drejtor ndërmarrje, por propozoi Bashkim Lleshin. Kur propozimi i kolektivit u dërgua për miratim në BP së Rrethit Tiranë, sekretari i parë Gaqo Nesho pyeti: -"*Kush e njeh Bashkim Lleshin që kolektivi i gjeologjisë e ka propozuar për drejtor të NGJ* ?". Sekretari i I-rë i KPR 2 Isak Shehu, që ishte dhe anëtar i BP Rrethit Tiranë, u ngrit dhe tha: *"Atë që nuk e bëri Partia për Bashkim Lleshin, kur ishte drejtor në Institutin e Gjeologjisë e bëri kolektivi i Gjeologjisë së Tiranës, që e zgjodhi drejtor të Ndërmarrjes."* Detyrën e drejtorit të Ndërmarrjes e kreu deri në vitin 1992, kur u ndryshua sistemi dhe u reduktuan deri në mbyllje punimet e kërkim zbulimit me shpime e galeri për shumë minerale të dobishme.

Pas vitit 1992 Bashkim LLeshi vazhdoi punën e inxhinier gjeologut për materialet e ndërtimit e mjedisin, derisa doli në pension në 25 gusht 2008, me përjashtim të periu-dhës 9 mujore, shtator 1998-maj1999, ku ka punuar drejtor i Drejtorisë së Përgjithëshme të Albkromit Tiranë.

Në vitet 1992-2008 ka dhënë një kontribut të rëndësishëm në studimin e gurëve dekorativë në shkallë Republike, në bashkëpunim me ISPGJ duke qenë autori kryesor i Studimit: "Gurët dekorativë të Shqipërisë, karakterizimi dhe përgjithësimi i tyre". Ka kryer disa projekte të kërkim-zbulimit dhe ka gjetur e konkretizuar disa vendburime gurësh dekorativë në zonën Milot-Tiranë si: Zall Dajti, Laç, Gjonëm, Mamuras, Lumi i Drojës, Kodra e Shulsit e Borizanë, duke përpiluar dhe raportet me llogaritje rezervash të këtyre vendburimeve.

Në vitet 1995-2008 është aktivizuar dhe me probleme të gurëve dekorativë e lëndëve të para të ndërtimit, gjeologjisë inxhinierike, hidrogjeologjisë e mjedisit, duke studjuar dhe dëmet e shkaktuara në ekonomi dhe mjedis nga shfrytëzimi pa kriter i inerteve në shtratet e lumenjve, si dhe duke propozuar masa konkrete për rehabilitimin e gjendjes. Në këto vite ka drejtuar projektet për Studimet e pasojave në ekonomi dhe mjedis, shkaktuar nga shfrytëzimi i inerteve të lumenjve Ishëm dhe Erzen dhe masat për rehabilitimin e tyre, projektin për Studimin e kërkim vlerësimit të lendëve të para karbonatike dhe ofiolitike të luginës së lumit Shkumbin për zevendësimin e inerteve lumore me inerte shkëmbore për t'u përdorur si lëndë ndërtimi në vitin 2003, etj. Ka qenë bashkëautor kryesor i grupit të Hartës së Rreëzikut Gjeologjik të Shqipërisë në shkallë 1:200 000 botuar në vitin 2000, etj.

Për këto studime, ka përgatitur referate të cilat janë mbajtur në konferenca e simpoziume shkencore brenda e jashtë vendit si: Simpoziumi "Pasuritë minerale të ofioliteve shqiptare" prill 1996, Konferenca e IIte Kombëtare "Rreziqet Gjeologjike dhe Mjedisi" nëntor 1997, Seminari "Gjendjen aktuale të prodhimit të mineraleve jo energjitikë në Shqipëri" tetor 1999, Simpoziumi IAEG (BGR) Hannover, Gjermani, tetor 2000, Kongresi i 8-të të gjeoshkencave dhe Seminari organizuar nga Fiera Del Levante, tetor e dhjetor 2000, Simpoziumi "Aggregate 2001" në Helsinki, Finlandë, gusht 2001, Konferenca e IIIte Kombëtare "Gjeomjedisi 2001" shtator 2001, Konferenca shkencore "Gjeologjia Shqiptare nëpër vite" nëntor 2003, Uork shopin e lumenjve në Tiranë, mars 2004, Konferenca ndërkombëtare "Mbrojtja e lumenjve sfidë për të gjithë" në Prishtinë, tetor 2004, Konferenca "Strategjia e zhvillimit të industrisë minerare një periudhë 15 vjeçare" mars 2005, etj.

Ka drejtuar grupin e Studimit në shkallë vendi "Vlerësimi i pasojave, ndikimit mjedisor, problemeve hidrodinamike dhe rehabilitimi i gjendjes në shtretërit e lumenjve" në vitin 2004, Studimin "Impaktet mjedisore të shkaktuara në luginat e lumenjve Erzen, Tiranë, Tërkuzë, Zezë si rezultat i veprimit të faktorëve të ndryshëm gjeologjike dhe humanë si dhe masat konkrete për zbutjen ose mënjanimin e këtyre impakteve" në vitet 2004 e 2005 dhe Studimin mbi shkëmbinjtë dhe mineralet industrialë të Shqipërisë në vitin 2005,

Nga janari i vitit 2000 prof. Bashkim Lleshi ka hapur studion private "Degalbanev Studio" ku ka kryer studime, projektime e konsulenca për mineralet e dobishme metalorë e jo metalorë, studime gjeologo-inxhinierike, hidrogjeologjike për ujë të pijshëm e industrial, të mjedisit, etj. për shumë objekte e zona të ndryshme të vendit tonë, si: Studimin "Mbi kushtet GJI dhe GJT të rrugës Tiranë-Dibër" në vitin 2003, Studime për lëndët e para të ndërtimit si gurë dekorativë, gëlqerorë, argjila, inerte lumore, në zonat Tiranë, Elbasan, Durrës, Lezhë, Berat, Dibër etj., Studime gjeologo-inxhinierike për disa objekte social kulturore e industriale në Tiranë, Durrës, Kavajë etj., Studime hidrogjeologjike për furnizimin me ujë të pijshëm e industrial të objekteve të ndryshme në Tiranë, Durrës, Lezhë, Mirditë, Gramsh, etj., Studime të ndryshme mjedisore, Studime për leje zbulimi e shfrytëzimi të mineraleve të dobishme metalore e jo metalore, etj. të cilat në mënyrë të përmbledhur jepen në këtë libër me kujtime.

Një vend të rëndësishëm në faqet e këtij libri zenë aktivizimi në kryesinë e Shoqatës LID, organizimi i Kuvendit Tekniko-Shkencor për Rrugën e Arbërit në maj 2007, ku ishte iniciatori dhe organizatori kryesor i këtij kuvendi, shkrimi i artikujve problematikë për ecurinë e kësaj rruge në gazetën "Rruga e Arbërit", marrja pjesë në aktivitete shoqërore si, në 60 vjetorin e Cetës së parë partizane të Dibrës në Zogje në qershor 2002, në promovimin e librit "Jeta dhe vepra e Aqif Lleshit" dhe ceremoninë e dhënies së titullit "Qytetar Nderi" i Dibrës së Madhe të shkencëtarit të shquar dibran Azmi Dibra, në dhjetor 2005 e prill 2006, në Konferencën "Dibra në optikën e të huajve" në prill 2008, etj.

Në fund të këtij libri me kujtime, në mënyrë të përmbledhur shkruhet, për takimet vjetore me shokët e shoqet e punës dhe të shkollës, vizitat tek të afërmit e tij jashtë shtetit, në Maqedoninë e Veriut, Gjermani, Itali, Greqi, USA, etj., për pushimet vjetore dhe marrjen pjesë në ceremoni gëzimi e hidhërimi të familjarëve, miqve dhe shokëve e shoqeve të punës.

B.Karoshi



SHITET

1 200 m² katror sipërfaqe e përdorshme për biznes dhe banim.
300 m² lokal, bar kafe dhe restorant, i përshtatshëm për dasma, 100 m² kuzhina.
4 apartamente, me dy dhoma të mëdha gjumi dhe 2 të tjera me një dhomë.
Restoranti ka katër banjo moderne dhe një dhomë ndërrimi.
Lokali në katin e parë është 200 m² + magazinë, qilari është 30 m².
Bari - 30 m² brenda dhe 140 m² ambienti i jashtëm.

Për një vizitë në pronë, kontakto: 068 65 08 441 ramizgjini@yahoo.com

Rruga e Arbërit nr. 174

kontribut

Një vështrim i përgjithshëm mbi zhvillimin e rolin e fisit Shehu-Bardulla.

Kontributi i **fisit Shehu për** çlirim kombëtar e **përparim shoqëror**

Nga **REXHEP BARDULLA, LAVDRIM SHEHU**

Fisi Shehu vjen nga fisi Lahi, që në gjysmën e dytë të Shek XVI, që jetonte në fshatin Palaman të Sllovës. I pari i këtij fisi, Leke Lahi, ishte katolik dhe përqafoi fenë islame. Dy djemve të tij u vuri emra myslimane: Hajrulla dhe Osman. Si rezultat i luftërave, reprezaljeve të pushtuesve osmane, Dibra po kalonte situata të tmerrshme ekonomike. Varfëria ekstreme, uria dhe sëmundjet e kishin goditur keqas këtë pjesë të krahinës. Si të vetmen mënyrë mbijetese, një pjesë e dibranëve, sidomos nga krahinat e Dardhës, Reçit, Luznisë, Çidhnës etj, kishin grabitjen me force të bagëtive nga krahina e Rekës etj. Në një inkursion të tillë merr pjesë edhe Osman Lahi, djali i Lekës. Në një çast grabitjeje, ai ndeshet me një familje shumë të varfër, në të cilën nëna, në mungesë të bukës, u jepte fëmijëve kuleçë prej hiri dhe i lutej Zotit për t'i shpëtuar fëmijët nga vdekja. I ndodhur para kësaj situate, Osmani u jep torbën me bukë e gjizë fëmijëve dhe bashkë me shokun e tij, betohen se do të heqin dorë nga ajo mënyrë jetese, duke përjetuar një proces katarsisi (vetëpastrimi shpirtëror) të shpejtë. Ndahen nga shokët e tjerë dhe falen, luten e shërbejnë në xhaminë e Dibrës së Madhe. Më vonë Osmani udhëton drejt Lindjes së Mesme, shkon edhe në Arabinë Saudite dhe fiton titullin Haxhi. Më pas bëhet ithtar i sektit "Kaderi" dhe rikthehet në Dibër e Peshkopi, ku krijon teqen e parë të sektit të lartpërmendur. Kështu, krijohet teqja e famshme e Shehlerëve të Peshkopisë. Deri në vitet '60 të shekullit të kaluar, banorët autoktonë të Peshkopisë, malësorët e Reçit, Dardhës, Sllovës etj betoheshin "për Haxhi Osman". Kështu, teqja e Haxhi Osmanit u bë teqja më e re e 7 teqeve të Dibrës.

Kur Peshkopia bëhet kryeqendër e Dibrës së Poshtme në vitin 1860, teqja e Haxhi Osmanit do të fitonte një lloj supremacie ndaj të tjerave. Në kohët kur lëvizjet për çlirim kombëtar zgjoheshin, djemtë e kësaj teqeje ishin në ballë të lëvizjeve çlirimtare. Prej gjysmës së dytë të shekullit të 18-të, Teqja e Peshkopisë u shqua për veprimtari atdhedashëse. Në shekullin e 19-të, kur lëvizja jonë kombëtare njohu zhvillime të shpejta, përfaqësues të fisit të shehlerëve morën pjesë aktivisht në këto lëvizje. Kështu, Bahram Abdullah Shehi, i shumënjohur si Bardulla, do të ishte në qendër të lëvizjes në Dibër. Ai mori pjesë në Kuvendet e organizuara për çlirim kombëtar. Dobësimi i perandorisë osmane do të shoqërohej me intensifikimin e lëvizjeve dhe kryengritjeve dibrane. Në luftën ruso-turke, në vitin 1887, Bardulla bashkë me Isuf Beg Karasanin, do të udhëhiqnin vullnetarët dibranë në betejën e Nishit, që populli e përjetësoi në vargjet e këngës: "Luftën e Nishit kush e bani, / çaj Bardulla e Karasani". Ndërsa për vëllain e Bardullës, Fejzullah Shehin, përjetësojnë vargjet: "Kush i dul Tunës matane, / Fejzullah Shehi, shahit në kambë".

Po në ato kohë, Zeqir Shehi, vëllai tjetër i Bardullës, do të helmohej nga shovinistët serbo-maqedonas gjatë rrugës Manastit-Shkup. Në qershor 1878, Bardulla, delegat në Lidhjen e Prizrenit, caktohet kryetar i komisionit të financës. Ndërkohe turkoshakët e Dibrës, të xhelozuar nga rritja e autoritetit të Bardullës, sarkazuan me vargjet: "O Bardull, o qafëgjat / s'asht Bellov' e s'asht Zagrad', / por asht Serb e Karadak", ose: "Ky Bardulla nji zorrekunop, / çoj në Dibër e murr nji top".

Në gjithë veprimtarinë e tij, Bardulla kishte mbështetjen e fisit, veçanërisht të Sheh Imerit, me të cilin koordinonin veprimet në fusha të ndryshme. Në xhaminë pranë teqes së Peshkopisë, është valëvitur flamuri kombëtar në ditët më të vështira për atdheun. Në ditët e luftës kundër pushtuesve serb u vra Xheladin Shehu, varri i të cilit edhe sot e kësaj dite ndodhet në Skërtec.

Pas shpalljes së Pavarësisë bie në sy veprimtaria patriotiko-politike e Shehat Shehut, djalit më të vogël të sheh Imerit. Shehati ishte i vetmi bashkëkohës që ishte arsimuar në



Variant i pemës së familjes, punuar me dorë nga Munir Shehu.



Gjenealogjia e fisit Shehu të Peshkopisë
Munir Shehu
Botimet M&B, 2020
ISBN 978-9928-307-16-3
Çmimi: 1000 lekë

Manastir dhe kishte ra në kontakt me idetë përparimtare të kohës.

Pas Kongresit të Lushnjës, kryeministri Sulejman Delvina e emëron kryetar bashkie për Dibrën e Poshtme. Me këtë cilësi ai u inkuadrua me kryengritjen e Arrasit, duke përfaqësuar qeverinë e Sulejman Delvinës. Pas suksesit të kryengritjes, Shehati lajmëron me telegram kryeministrin e kohës për fitoren. Pas vitit 1920 Shehati lidh miqësi (pi gjak me Elez Isufin) me Bajram Currin, Hasan Prishtinën dhe bëhet fanolist.

Gjatë periudhës së Zogut, djem të këtij fisi, edhe për arsye patriotike, u dërguan nga prindërit për studime ushtarake brenda dhe jashtë vendit. Kështu, Shefqet Shehu, Kadri Bardulla e Rasim Bardulla, Fehmi Shehu mbaruan shkollën mbretnore për oficerë, ndërsa Mithat Bardulla e Ruzhdi Shehu vazhduan studimet, pas mbarimit të shkollës mbretnore, në akademitë ushtarakë të Parmës e Torinos në Itali. Pas vitit 1924, Shehat Shehu u dorëhoq nga jeta politike dhe kryetar i bashkisë u bë Sulejman Shehu, kushëri i tij.

Fehmi Shehu, në vitet 1930 mori pjesë aktive në lëvizjen antizogiste të Fierit. Ndërsa në vitin 1941, në kohën e luftës Italo-Greke, në bashkëpunim me komandantin e batalionit Spiro Moisiu, u hoqi gjilpërat mortajave, dhe bashkë me një grup ushtarakësh u arratis në Greqi.

Sulejman Shehu ishte një nga kryetarët me autoritarë, që nuk njihte servilizmin dhe hipokrizinë. Për tendencat e tij autonome në kryerjen e pushtetit vendor, u eliminua fizikisht, duke shfrytëzuar një hasmëri të vjetër.

Në prag të pushtimit fashist, Kadri e Rasim Bardulla gjenden me shërbim në Durrës dhe marrin pjesë aktive në rezistencën kundër pushtuesit. Më pas Faik Shehu, Ramadan Shehu, Nexhbedin Shehu bëhen simbol të rezistencës kundër pushtuesit fashist në Peshkopi. Rasim Bardulla, arratiset në Bosnjë se kërkohej nga fashistët për veprimtari kundër tyre. Përpiqen ta joshin me detyra në shërbimin ushtarak, por i refuzon me vendosmëri.

Dy djem të rinj të Teqes, Abaz Shehu dhe Tahsim Shehu internohen nga nazistët në kampin e Prishtinës dhe atje ekzekutohen barbarisht. Vlen të theksohet se atyre iu propozua të liroheshin, mjafton të nënshkruanin se nuk do të mbanin lidhje me Luftën Nacionalçlirimtare, por ata refuzuan dhe pranuan vdekjen me nder. Vetëm sepse ishin bij të familjes Shehu, nuk u vlerësuan sa duhet nga qeveria komuniste.

Faik Shehu krijon batalionin territorial të Dibrës dhe merr pjesë në luftime kundër pushtuesit. Zgjidhet anëtar i Këshillit të Përgjithshëm Nacionalçlirimtar. Mban lidhje të ngushta me misionet anglo-amerikane. Pas luftës zgjidhet kryetar i Qarkut të Dibrës dhe deputet i saj në zgjedhjet e 1945. Ekzekutohet më 1947 me grupin e deputetëve. Po në 1946, arrestohen Ruzhdi Shehu, i cili dënohet me vdekje. Pasi i ulet dënimi në burgim të përjetshëm, kryen 15 vite burg. Shefqet Shehu vdes gjatë torturave. Haki Shehu, Imer Shehu, Rasim Bardulla dënohet me ekzekutim, sepse bashkë me Edip Tërshanën krijuan të parën parti demokratike në Shqipëri, me qendër në Peshkopi. Me parë, në Kretë, vritet oficeri Fehmi Shehu gjatë zbarkimit gjerman, ndërkohë që ai shërbente si koordinator i shtabit aleat të Mesdheut me shqiptarët që kishin dezertuar nga ushtria italiane.

Po në vitin 1947 arrestohet vëllai i Rasim Bardullës, gjoja tentative arratisje për në Greqi. Gjithashtu, arrestohet Nexhbedin Shehu, komandant i batalionit të katërt në Brigadën e 18 Sulmuese, që së bashku me kushëririn e tij, Sami Bardulla, kishin shkruar faqe heroizmi të vërteta në luftë kundër pushtuesve gjermanë për çlirimin e Gostivarit, Prizrenit, Kukësit etj. Po ashtu, arrestohen edhe Munir Shehu e Qamil Shehu. Vetëm gjatë shekullit të 20-të, gjatë diktaturës komuniste, nga ky fis janë vrarë 8 pjesëtarë dhe janë burgosur 7 të tjerë.

Kështu e pësuan bijtë e Teqes, të cilët edhe pse u renditen në kah të kundërta, ëndërr të vetme kishin Shqipërinë etnike, pluraliste dhe demokratike.

Pas çlirimit, edhe pse nuk shiheshin me sy të mirë nga qeveria hoxhiste, ata kontribuan dhe shkëlqyen në shumë fusha të jetës. Ne ekonomi: Mefat Shehu, Muhamet Shehu, Selami Shehu, Met Shehu, Neki Shehu, Pul Bardulla, Basri Shehu, Shuip Shehu; në historiografi: Munir Shehu; arsim: Bedri Shehu; në dramaturgji: Adil Shehu, Ulvi Shehu, Inajet Shehu; në muzikë: Munir Shehu, Melita Shehu, Isak Shehu, Arif Shehu; në sporte: Hazis Shehu, Rexhep Bardulla, Përparim e Flamur Bardulla, Bexhet Shehu, Taxhedin Shehu, Mufit Shehu, Njiazi Shehu, Visar Bardulla etj.; në politikë: Bajram Bardulla, Sheh Imeri, Shehat Shehu, Sulejman Shehu, Imer Shehu, Faik Shehu, Rasim Bardulla, Fehmi Shehu, Rexhep Bardulla, Lavdrim Shehu, Natasha Shehu, Genc Bardhulla, Tomor Shehu. Edhe në lëvizjen për demokraci, pa i përmendur të sipërpërmendurit, kujtojmë Sezair Shehun, Verdi Shehun, Visar Bardullën, Përparim e Flamur Bardullën etj.

Pa dashur të ngremë kulte e dekorata, këto ishin disa kontribute të shehlerëve për çlirim kombëtar e përparim shoqëror.

portret

Beshir Sufa që në fillim të Lëvizjes vihet në krye të forcave vullnetare çlirimtare për tërë krahinën. Aq trim sa ishte, po aq i dashur dhe i dhimbshëm ishte për tërë banorët cep më cep të Dibrës.

“Besa e dibranit musteqekuq”

Nga **SHAQIR SKARRA**

Familja e madhe e Ndreut në Sllovë përgjatë viteve gjithmonë ka nxjerrë njerëz që bënë emër në histori. Nuk ishte vetëm Elez Isufi e Sufë Xhelili, Cen Elezi e Dali Ndreu. Jo, sado të errësohet realiteti e vërteta është e vërtetë si dita dhe nuk mund të mbulohet dielli me shoshë.

Jo vetëm unë por i gjithë brezi im ka dëgjuar të flitet shumë për Beshir Sufën, jo vetëm në Sllovë por në të gjithë Dibrën dhe jashtë sinorit të saj. Në fakt ai quhej Beshir Ndreu por si djali i madh i patriotit të madh , heroit të luftrave të popullit tonë për liri e pavarsi, trimit legjendar të Dibrës që i përkiste fisit të njohur Ndreu në Sllovë, Sufë Xhelilit gjithmonë e thirrën në emrin e babës, Sufës dhe i mbeti në popull mbiemri Sufa, ku vazhdon ende të shkruhet e kujtohet si Beshir Sufa.

Dega nga vinte Beshiri ishte një degë e atij trugu të lisit vigan që buloj e u rrit krenar e madhështor, aty, anës së djathtë të luginës së Drinit të Zi, në lëndinat e gjelbëruara të Lisivalles, aty ku lumi merr vrapin për të hyrë në Lumë. Ishte një degë e shëndetshme e atij lisi shpatullgjerë nën hijen e të cilit nënat malësore mëkuan e përkundën djepet e trimave që vërtet bënë epokë jo vetëm në Dibër por dhe jashtë saj, pinjollë të shquar të kësaj dere të madhe e të ndritur që historia i mban në gjirin e saj duke i bërë kështu gjithmonë të pa vdekshëm.

Atë ditë dhjetori kur u vra Sufë Xhelili dhe mbeti i plagosur Elez Isufi nga forcat e reaksionit në Dibër, Beshiri ishte një djalë i ri, i bëshëm,me sy të kaltër që depërtonin deri në thellësitë e shpirtit njerëzor, tamam, tamam si i ati që sapo ishte mbuluar me dheun e ngrohtë të vendlindjes së tij.

Beshiri kishte qëndruar pranë atij burri qysh 15 vjeç kur u bë djalë për pushkë, kishte marrë pjesë në dhjetëra beteja, kishte vrarë me dorën e tij serbët pushtues të vatanit, kishte lëshuar, si i ati, atë piskamën tronditëse e frymëzuese “a besë-a besë”, që ngrinte në këmbë malet dhe mbushte burimet me gjakun e pastër të lirisë.

Në betejën vendimtare të Lanë-Lurës në tetor të vitit 1921, në rrethana tepër të vështira e delikate për kombin, Beshir Sufa qëndroi natë e ditë në krahë të babait të tij të nderuar duke luftuar me guxim të pa shoq dhe në kushte tepër të vështira e duke u rënë kryq e tërthor maleve të Runjës, për t’u siguruar nga ndonjë ndërhyrje e mundshme e forcave tradhtare.

Dhe djali i ri krenohej e madhohej kur burrnia më e zgjedhur dibrane vinin për ngushëllim dhe e ngushëllonin:

-Mos u mërzit, o Beshir Sufa! Të na rrojsh me gjithë vllazni! Të pastë Dibra!

Dhe e vërteta kështu doli në fakt. Beshir Sufa nuk i la gjë mangut të atit për nga karakteri, trimëria, besa e bujaria. Figura e tij po vinte gjithmonë duke u rritur në situata të tjera e kohë të reja por mjaft delikate e shumë të vështira.

Lidhur me figurën e Beshir Sufës ka mjaft rëndësi kompleksi i ngjarjeve dhe vetë rrethanave historike në të cilat u lind dhe u rrit. Janë rrethana mjaft komplekse në të cilat preken edhe mjaft çështjet dhe fatet e vendit, preket thellësisht vendlindja e tij Sllova dhe gjithë treva dibrane.

Kronika jetësore e Beshir Sufës është mjaft e gjërë dhe e lidhur fort me kontekset e zhvillimeve shoqërore që kalonte vendi.Ai pa dyshim mbetet një personalitet, cili la shenjën e tij prej burri atdhetar, i mençur, i pjekur, me njohje të gjëra dhe aftësinë për ti kuptuar me mjaftë inteligjencë zhvillimet e befasishme që në periudhën e tij ishin mjaft të befasishme në mjedisin politik shqiptar. Pamvarsisht “kurtheve” në të cilat koha kishte zënë dhe zinte mjaft nga njerëzit e rëndësishëm të vendit, Beshir Sufa ka shkëlqyer me pjekurinë dhe qëndrimet që ka mbajtur, duke qenë dhe njeri nga njerëzit më të rëndësishëm të Ujemujës, megjithatë goditja do të vinte pikërisht andej dhe nga e priste.

Qysh në vitet ’30, kur vëllai i tij më i vogël, Dali Ndreu, u përfshi në qëndresën antizogiste dhe më vonë në lëvizjen Çlirimtare pas



Qëndrimi i tij në internim është një kapitull tjetër interesant i jetës së këtij burri, që flet e na mëson për qëndresën madhore të njeriut përballë vështirësive njerëzore, është një faqe e ndritur e jetës së tij që e lartëson Beshir Sufë Xhelilin, po aq sa rinia e tij përkrah një babai me emër e zë, e ngre në piedestalin e trimave që edhe dinë të luftojnë, edhe dinë të qëndrojnë me nder në rrethana të jashtëzakonshme, edhe dinë të vdesin me qerpik të papërlotur kurrë. I tillë ishte dhe i tillë mbeti Beshir Sufa, trimi, bujari, vizionari dhe bestari mustaqe kuq.

pushtimit fashist të vendit, ai u bë një ndër veprimtarët më të shquar të kësaj lëvizjeje mbarëpopullore.

Shtëpia e tij në Sllovë u bë qendra e mobilizimit të forcave ngadhënjimtare kundër fashizmit italian dhe, më vonë, atij të pushtimit nazist gjerman, djepi i lëvizjes Çlirimtare për tërë krahinën e Ujemujës dhe më gjërë. Me autoritetin dhe vlerat njerëzore që trashëgonte, me besimin që kishin dibranët te fjala e tij e, sidomos, për besën shqiptare që nuk e tradhtoi kurrë, ai gëzonte një respekt dhe përkrahje të gjithanshme duke grumbulluar rreth kësaj lëvizjeje djemtë më të mirë e më të vendosur të të gjithë Ujemujës.

Beshir Sufa që në fillim të Lëvizjes vihet në krye të forcave vullnetare çlirimtare për tërë krahinën. Aq trim sa ishte, po aq i dashur dhe i dhimbshëm ishte për tërë banorët cep më cep të Dibrës. Janë të panumërt ata që sot e asaj dite i mbajnë mend shumë mirë bamirësitë e tij për t’i shpëtuar nga vala e egër e komunizmit, që shpesh herë shpërthente duke rrëmbyer në vorbullat e saj djem krejt të pa fajshëm .

Sa e sa shtëpi nuk i dogji kjo flakë përvëluese, vetëm sepse kishte hyrë në mes Beshir Sufa, që i thoshin ndryshe dhe “besa e dibranit musteqekuq”. Forcat vullnetare të komanduara prej tij me një disiplinë e ndërgjegje të lartë ndihmuan në zgjidhjen e shumë problemeve që kishte populli në ata vite të sapo dala nga lufta, sidomos në shpërndarjen e furnizimeve që vinin nga Fronti i Lindjes, në emergjencat civile dhe në ndihmat që u shpërndaheshin familjeve në nevojë.

Beshiri ishte njeri i veprimit. Fjalët e tij ishin të pakta, por zinin vend si guri i rëndë në themelet e kullave, puna dhe veprimtaria e tij ishte e madhe.

Ishte njeri i punës, sepse veten e tij s’e quajti kurrë komandant, por një shërbyes për ta ndihmuar këdo e kurdo. Kështu e ka njohur Dibra Beshir Sufën dhe i tillë mbeti tërë jetën sa qe gjallë.

Ashtu si shumë shërbime të tjera, ashtu si shumë patriotë të nderuar dhe me vlera të mëdha njerëzore u harruan shpejt, u mohuan dhe u përbuzën nga një hakmarrje çmendurie për të joshur tekat e elitës që po vinte në pushtet pas gjithë atij gjaku të derdhur. Ndoshta, familja Ndreu është ndër më të goditurat e më të përgjakurat nga diktatura komuniste në tërë Shqipërinë, për të cilën mendoj që është me vlerë për kohën që ajo të njihet më gjerë dhe për atë të shkruhet më gjatë.

Sot nuk do të mjaftonin faqet e kësaj gazete të shkruhej me detaj vrasjet, burgosjet, internimet emigrimet e detyruara, konfiskimet e shumta që iu bënë kësaj familje të nderuar jo vetëm në Dibër por në të gjithë Shqipërinë. Shpata e diktaturës ra rrufeshëm mbi këtë familje fisnike që kishte derdhur gjak kundër pushtuesve të huaj e tashmë po derdhte përsëri gjak por për hatër të pushtetit që po instalohej në vendin tonë.

Shumë rëndë u godit familja e atdhetarit, heroit të luftës anti serbe Sufë Xhelili dhe nga kjo valë që vinte si llavë e kuqe edhe në Sllovën e largët nuk mund të bënte përjashtim as djali i madh i Sufës, Beshir Sufa.

Në vitin 1945 kur Shumbati u bë nënprefekturë Beshirin do ta gjejmë komandant për mbrojtjen e vendit, detyrë të cilën e kreu me përpikmëri.

Edhe pse ishte një periudhë mjaft e vështirë për vendin dhe detyrë e përgjegjësi e rëndësishme që kishte marrë mbi supe fitoi një respekt dhe simpati jo vetëm në Shumbat por në të gjithë krahinën e Ujemujës.

Në fakt deri tani kishte qenë rritja, dhe shkëlqimi i personalitetit të Beshir Sufës por tani do të fillonte zbritja e tij me shpejtësi, goditja e madhe dhe fatale jo vetëm për të por për të gjithë familjen e tij të madhe patriarkale.

Figura komplekse siç është aju e Beshir Sufës kërkojnë një hapësirë dhe qasje të gjerësishme për ti sjellë të plota, ku mjaft dëshmitarë okularë tregojnë se për këtë personalitet të madh kombëtar është shkruar fare pak, me mos thënë fare. Figura, veprimtaria, profili dhe autoriteti i këtij burri të Dibrës nuk mund të shikohen jashtë kontekstit të gjerësishëm të vendit në përgjithësi dhe të vetë Dibrës në vçanti, me vetë ngjarjet, zhvillimet, opinionet më shumë ngjarje dhe ndodhi gati gati në ekstrem që ndodhën në ato vite në Dibër. Pa dyshim që Beshir Sufa la shenjën e tij,është formuar me këto ngjarje dhe zhvillime por ishte dhe njeri ndër aktorët kryesor ku domosdo shkëlqeu dhe u rrëzua si një meteor.

Në vitin 1947, fill pas mbarimit të Luftës, për të kënaqur oreksin e Beogradit burgoset Beshir Sufa, ish-komandant i forcave vullnetare në Dibër, djali i trimit Sufë Xhelili, që kishte luftuar një dekadë të tërë me shovinistët sërb së bashku me djemtë e tij. Lirohet për pak kohë dhe në vitin 1956 ndodh gjëma e madhe për tërë familjen e tij dhe për tërë familjen e madhe të Ndreut në përgjithësi.

Vëllai i tij Dali Ndreu, një ndër gjeneralët e parë shqiptarë dhe udhëheqësi kryesor i Luftës Çlirimtare, arrestohet me të shoqen e tij një ditë vere tek po pushonin të shkujdesur në baçet e Beshirit në Sllovë, i rrethuar nga disa vizitorë të farefisit të tij.

Arrestimi i tij u bë me bujë të madhe dhe nuk kaluan veç pak ditë dhe vala e dëbim-internimit mori me vete familje të tëra nga fisi Ndreu. Familja e Beshirit dhe e vëllezërve të tij, si edhe ajo e Xhetan Ndreut e të tjera u internuan në Shtyllas të Fierit ku do të qëndronin deri në vitin ’90 duke punuar si argatë në arat e krypura e moçalishtet plot mushkonja të kënetave të Myzeqesë. Këtu e kaloi gjysmën e jetës së tij edhe Beshir Sufa deri sa vdiq larg vatrës së tij të dashur e të nderuar në vitin 1989, në moshën 94-vjeçare, ky burrë trim dhe i mençur, luftëtar i provuar në zjarret e luftrave për liri, një plak i hijshëm e fisnik, me një çehre që të imponte përherë respekt e dashuri, shtatdrejtë si lisi i kreshtës, me një humor të këndshëm.

Ai që e kishte kaluar jetën në luftë, me pushkë krahut e kollanin e fishekëve brezit, aty, në lëmishtet e Shtyllasit e shihje çdo ditë në mëngjes me shatë e drapër në dorë, në mes të arave duke derdhur djersën e ballit, pa iu ankuar askujt, gjithmonë i freskët dhe tërë shpresë e optimizëm për jetën, gjithmonë i qeshur dhe i dashur me këdo.

Mbrëmjeve dhe në kohë pushimi Beshiri ishte gjithmonë i rrethuar nga miqtë e shokët e shumtë që kishte. Qazim Bllaca, Astrit Delvina, Osman Kazazi, Drita Kosturi, Xhafer Vokshi, Sami Hysi, Faik Selenica e plot të tjerë ishin miqtë e tij të shumtë që e rrethonin përherë me dashuri e përkujdesje dhe e çmonin për vlerat që kishte. Megjithëse situata mjaft e vështirë kurrë nuk e braktisën as miq e bashkëfshatarë e bashkëmoshatarë nga Sllova. Bënë si bënë dhe erdhën edhe ata por ama tinëz në Shtyllas të Fierit, erdhën dhe u takuan e çmallën me Beshir Sufën, pinë kafe e qëndruan së bashku si dikur në bahçen e tij në Sllovë.

Ëndërronte shpesh Beshir Sufa, ëndërronte se një ditë do të vinte pranvera, do të kthehej ashtu siç kthehen dallëndyshet në folen e tyre, donte shumë të kthehej një ditë në Sllovë, aty, tek shtëpia dhe pronat e tij, aty ku kishte lënë rininë e tij dhe një pjesë të madhe të zemrës së plagosur, të shikonte për të fundit herë vendet nga kishte shëtitur e kishte luftuar, të dëgjonte këngën e fundit të atij bilbilit të dikurshëm që vinte nën pullazin e shtëpisë së tij, dhe, mes luleve të qershisë, sa zbardhte agimi, ia niste asaj melodie që vetëm ai di të këndojë.

Mjerisht, ëndrra e tij u pre një ditë vere pa perënduar ylli i komunizmit dhe pa lindur akoma drita e demokracisë dhe ndërroj jetë i përvëluar e i djegur nga malli për vendlindjen e tij të dashur dhe të shtrenjtë.

Qëndrimi i tij në internim është një kapitull tjetër interesant i jetës së këtij burri, që flet e na mëson për qëndresën madhore të njeriut përballë vështirësive njerëzore, është një faqe e ndritur e jetës së tij që e lartëson Beshir Sufë Xhelilin, po aq sa rinia e tij përkrah një babai me emër e zë, e ngre në piedestalin e trimave që edhe dinë të luftojnë, edhe dinë të qëndrojnë me nder në rrethana të jashtëzakonshme, edhe dinë të vdesin me qerpik të papërlotur kurrë. I tillë ishte dhe i tillë mbeti Beshir Sufa, trimi, bujari, vizionari dhe bestari mustaqe kuq.

Rruga e Arbërit nr. 174

“5 SKENARË...” të Bujar Kapexhiut

Nga pesë skenarët që Kapexhiu ka përmbledhur në këtë libër të llojit e stilit të veçantë, dy komeditë “Edhe kështu edhe ashtu” (1989) dhe “Dy herë mat” (1986) janë bërë filma, ndërsa tre të tjerët ai i vë në dispozicion të krijuesve që kanë dëshirën, pasionin, shijen dhe aftësinë për krijimet e artit komik.

Nga **Halil RAMA**

Libri “5 skenarë”, i sapobotuar nga Prof. Bujar Kapexhiu, vjen si dhurata më e mirë e këtij fillimviti për lexuesin e veçanërisht për autorët e rinj të veprave letrare.

Një libër nëpërmjet të cilit autori Kapexhiu, ikonë e artit dhe kulturës kombëtare, u dhuron bujarisht krijuesve të rinj përvojën e tij të suksesshme në shkrimin e skenarëve të filmave artistik.

Botimi i skenarëve letrarë të filmave artistik është një përvojë botërore. Tek ne kjo praktikë ka munguar. Skenari letrar i filmit artistik është një krijimtari e mirëfilltë letrare, plotëson me dinjitet artistik punën krijuese të autorit dhe, së fundi, justifikon një angazhim dashamirës të çdo lexuesi.

Botimi i Mjeshtrit Kapexhiu përmban skenarët dhe platformat regjisoriale të filmave “Dy herë mat” (kinokomedi), “Edhe kështu, edhe ashtu” (kinokomedi muzikore), “Bixhoz me dekorata” (kinokomedi), “Mozaiku” (kinokomedi) dhe “Pipiruku këngëtar” (skenar për film artistik për fëmijë), të shkruara me mjeshtëri e mjaft të arrirë artistikisht.

Duke na dhënë me detaje elementet e platformës regjisoriale, për shembull te kinokomedia “Dy herë mat”, si ideja, konflikti, kompozicioni, trajtimi figurativ etj., te loja e aktorëve do të mësojmë se si e bën Mjeshtri Kapexhiu pantelikën e tyre, si të Ilo Pincit, Sazanit, Kopit, Cukut, Rudinës, Besës, Takut, gruas së Kopit (si dhe të grupit të shahistëve), për lexuesin e sidomos për shkrimtarët që mund të pretendojnë t’i shndërrojnë në skenarë filmi romanet apo novelat e tyre, rëndësi ka stili i përdoruar nga Kapexhiu në përshkrimin e ngjarjeve.

Sot formatimi strukturor i skenarit të filmit ka ndryshuar, por Kapexhiu ruan atë formë me nuanca më të dukshme letrare, siç është shkruar skenari i filmit artistik në ato vite. Duket si një tregim i gjatë apo novelë, ku shtjellohet subjekti me të gjitha nuancat e përshkrimit të mjedisit, të veprimit dhe dialogut të personazheve. Kjo, thotë



Kapexhiu, “për të ruajtur dhe si dokumentacion autentik formën dhe stilin e të shkruarit të skenarit. Quhet skenar letrar, por të jemi të sinqertë e objektivë që nuancat letrare në skenarin e filmit janë të kursyera, sepse aty ka rëndësi, veprimi, aksioni, filli i subjektit dhe dialogu. Ekspresioni, psikologjia, meditimi i personazheve mbetet si detyrë e aktorëve në sheshin e xhirimit nën drejtimin e regjisorit dhe kompozimit të figurës nga operatori. Filmi ‘Dy herë mat’ tashmë është parë nga mijëra spektatorë në kinema dhe në ekranin e televizorit dhe është shoqëruar me përshtypjet më të mira në vlerësimin artistik për një komedi brilante e me nivel artistik nga të gjithë komponentët.”

“DY HERË...” APO “TRI HERË MAT”

Pakkush e di që filmi komedi “Dy herë mat”, që mban autorësinë e Bujar Kapexhiut, fillimisht ka qenë ideuar për “Tri herë mat”. Ndërsa flet për komeditë që ka realizuar në vite, e gjithë fytyra i merr një pamje hareje. Duket se humori është argument për të cilin pëlqen të flasë pa fund. “Më pëlqente gjithmonë të bëja humor në shoqëri e në familje, kujton ai. Interpretimi i filmit Dy herë mat ka qenë edhe si një vazhdë e punës sime si regjisor në Estradën e Tiranës. Aty u caktova, sapo mbarova shkollën. Gjatë gjithë këtyre viteve jam marrë me humorin, si me shkrimet, ashtu edhe me regjinë. Kështu që kur shkova në Kinostudio, fillimisht shkrova një komedi e cila u pëlqye mjaft. Atëherë isha regjisor, piktor dhe skenarist i filmit vizatimor. Mirëpo dëshira ishte që të kaloja regjisor në filmin artistik. Prandaj shkrova skenarin, që në atë kohë titullohej Tri herë mat. Por meqë filmi dilte shumë i gjatë, hoqëm një mat dhe e bëmë Dy herë mat. Por unë nuk e kisha menduar që do ta interpretoja vetë rolin kryesor të këtij filmi, e kisha taksur këtë rol për aktorin Agim Qirjaqi. Atë e kam pasur student në Institutin e Arteve dhe më kishte lënë përshtypje të jashtëzakonshme, si një student i rrallë dhe më vonë si një aktor i mrekullueshëm.

Mirëpo kur kërkova Agimin, ai ishte i angazhuar në një film tjetër. Kështu që u vendos që këtë rol ta interpretoja unë. Padyshim nuk është lehtë që edhe të interpretosh edhe të drejtosh. Gjithmonë duhet të kesh një sy tjetër që të shikon dhe të korrigjon. Por kam bashkëpunuar shumë me operatorin Lionel Konomi, i cili më ka ndihmuar në këtë drejtim dhe ka qenë ai që ka bërë syrin korrigjues gjatë filmit.”

KOHERENCA TE “BIXHOZ ME DEKORATA”

Mjaft tërheqës është skenari i kinokomedisë “Bixhoz me dekorata”, përfshirë në librin voluminoz me 544 faqe të Bujar Kapexhiut.

Ndonëse titulli mjaft sinjifikativ është në koherencë edhe me realitetin e sotëm të shoqërisë shqiptare, në parashkrimin që i bën skenarit të kësaj kinokomedie autori na njeh me kontradiktën themelore në këtë subjekt, që është përballja e dy koncepteve për moralin: “Ajo e gjeneralit Taho dhe e nipit, i cili me lirinë e të shprehurit që erdhi me vendosjen e demokracisë, merret me një biznes mjaft fitimprurës, me botimin dhe shpërndarjen e një reviste me përmbajtje erotike”.

Me mjeshtëri të rrallë autori vë përballë dy personazhe me karakteristika të veçanta e shumë larg nga njëri-tjetri, për sa i përket konceptit se ç’është e moralshme e ç’nuk është e tillë.

Linja tjetër që e bën më tërheqës subjektin dhe i jep karakterin komik ngjarjes është linja e kapterit Xhemal, që shkurt e thërrasin Xhemo dhe kur, me miqësinë e ministrit, rritet në përgjegjësi, në takimet me ushtarakët e NATO-s e thërrasin Xhejms. Dy komshinj, gjenerali Taho, që me të padrejtë, sipas reformës, e nxjerrin në pension të parakohshëm dhe kapteri Xhemo që rritet në përgjegjësi, paralelisht kalojnë në situata gazmore që ndërthuren me njëra-tjetrën duke zbuluar situata komike me të papriturat dhe batutat e zgjedhura humoristike.

Për sa i përket anës kompozicionale, Kapexhiu i vendos ngjarjet në mjedise të tilla si: Shtëpia e gjeneralit (dhoma e gjumit, dhoma e ndenjjes, kuzhina, anekse etj.); Hyrja para pallatit, Sheshi i pallatit, Sheshpushim midis apartamenteve, Repart rrobaqepësie, në Librari, Dyqan tapetesh, Shtëpia e kapter Xhemos etj.; mjedise këto ku zhvillohen dialogë tërheqës mes personazheve Sofika, Riku, Yllka, Taho, Piku, Ariani, Qefseri, Viola etj.

Këtu skenaristi përcakton qartë mesazhin dhe qëndrimin ideoemocionial që do të jetë i mjaftueshëm vetëm me interpretimin elegant, origjinal e gazmor të aktorëve, si dhe trajtimin regjisorial për gjithçka, ku duhet dora e vëmendja e tij, pa neglizhuar këtu edhe fotografinë dhe këndin e dinamikën e kameras.

Këto elemente i gjejmë edhe në skenarët e kinokomedisë muzikore “Edhe kështu, edhe ashtu”, të kinokomedisë “Mozaiku”, si dhe në skenarin për film artistik për fëmijë “Pipiruku këngëtar”, ky i fundit diçka e re, e parealizuar më parë në artin kinematografik tek ne. “Pipiruku këngëtar” në dukje ngjan film për fëmijë, por subjekti që shtjellohet në të ngjall interes edhe për spektatorin e rritur. Ky skenar ka një teknikë të kombinuar midis filmit me aktorë dhe filmit të animuar. Pra, figura reale e aktorit është përballë figurave të vizatuara. Personazhi i filmit të animuar, Pipiruku, tashmë i njohur me tre seritë e tij, ka dëshirë të bëhet këngëtar dhe me ndihmën e miqve të tij Bleta, Milingona dhe Zogu gushëkuq merr rrugën për të arritur në godinën e Televizionit që po përgatit festivalin e këngës. Dhe pasi kalon në situata të ndryshme plot humor realizon më në fund ëndrrën e tij, pjesëmarrjen në festival.

Botimi i këtyre pesë skenarëve vjen jo vetëm si dëshirë e autorit, për t’i botuar vetëm për vete, për t’i pasur në koleksionin e krijimtarisë letrare, por për të qenë edhe në duart e atyre personave pasionantë, fillestarë që kanë dëshirë të ndjekin rrugën e krijimit të skenarëve për film, siç e quajnë artin e shtatë. Kjo është përvojë dhe një kontribut për të ardhmen e artit kinematografik.

Nga pesë skenarët që Kapexhiu ka përmbledhur në këtë libër të llojit e stilit të veçantë, dy komeditë “Edhe kështu edhe ashtu” (1989) dhe “Dy herë mat” (1986) janë bërë filma, ndërsa tre të tjerët ai i vë në dispozicion të krijuesve që kanë dëshirën, pasionin, shijen dhe aftësinë për krijimet e artit komik.

BESIM

Sheh Iljazi i Vleshës

Nga **MEHDI MARKU**

“Një ditë do të ndërrojë regjimi, sa do i egër dhe i gjatë të jetë”!

Një figurë e shquar dhe shumë e njohur në Dibër e më gjerë qe edhe Sheh Iljazi, i biri i Shezumanit të Vleshës.

Sheh Iljazi lindi në Vleshë, më 1895. Ai qe një vazhdues i denjë i traditave popullore e patriotike, me shumë autoritet dhe me zgjuarsi të madhe. Gjithmonë në krye të vendit në konak, në odat dibrane e në mexhlise, qe mburojë e fshatit dhe e tërë krahinës. Banorët e fshatit Vleshë nuk e harrojnë kurrë pushtimin gjerman, më 1943.

Edhe sot e kujtojnë me trishtim ditën kur gjermanët hynë në fshat dhe qenë gati të bëjnë reprezalje mbi banorët e pafajshëm. Qe ndërhyrja e menjëhershme e Sheh Iljazit te disa autoritete vendase, që gjermanët të tërhiqeshin, duke mos shkaktuar asnjë incident.

Sheh Iljazi, i mbështetur dhe nga fshatarët, mbrojti me fanatizëm çdo pronë të fshatit apo të fisit. Një pronë e tillë qe edhe Bjeshka e Shehut. Kjo bjeshkë ishte një kullotë verore prej disa qindra hektarësh dhe zinte një nga faqet e malit të Korabit. Kjo bjeshkë kishte marrë këtë emër sepse Shehu, dikur herët, kishte ndërhyrë për të shuar një konflikt mes palësh, prandaj i qe falur bjeshka.

Si pasuri e rrallë dhe për resurset që kishte, pa fakte e pa dokumente pati një tentativë për përvetësimin e saj. Çështja atëherë kaloi në gjyq dhe vazhdoi plot 10 vjet, deri më 1938. Qenë fjalët e mençura të Sheh Iljazit dhe dëshmitë e dëshmitarëve që gjyqi të fitohej nga Sheh Iljazi dhe bjeshka të mbetej pronë e fisit, ashtu si kishte qenë më parë dhe është edhe sot.

Sheh Iljazi njihej me shumë krerë të Dibrës dhe së bashku me to, edhe pse në atë kohë mungonte informacioni, njiheshin me ngjarjet që zhvilloheshin në vend. Ai demaskoi ata që sollën farën e komunizmit në Dibër, duke e kuptuar qysh atëherë se çdo të mbinte nga kjo farë. Por, komunizmi kishte triumfuar mbi të vërtetën dhe do të godiste pa mëshirë të gjithë ata që nuk u pajtuan asnjë herë me idetë e tij.

Kështu u godit dhe Sheh Iljazi, duke e cilësuar “kulak”. Ky ishte një model i luftës së klasave, që sa vinte e ashpërsohej. Si hije e ndoqi nga pas ky titull plot dyzet vjet, deri sa vdiq. Një barrë tepër



e rëndë, për vete, fëmijët e të afërmit. U privuan të gjithë nga çdo e drejtë civile e shoqërore.

Sheh Iljazi, gjysmën e jetës së tij e kaloi i izoluar brenda mureve të shtëpisë, i veçuar nga të afërmit, fisi e shoqëria. Nuk mori pjesë asnjëherë në dasma e morte as në gëzime të tjera familjare të tyre. U vetizolua vetëm e vetëm për të mbrojtur nderin, për t’ju shmangur çdo lloj provokimi, që mund t’i bëhej orë e çast nga ata që mbanin pushtetin vetëm duke sajuar.

Sheh Iljazi njihet për vlerat që mbarte.

Një natë, aty rreth vitit 1962, erdhi i rekomanduar në shtëpinë e tij një historian i shquar. Ishte profesor Osman Myderizi. Një shkollë në Tiranë mban sot emrin e tij. Kishte ardhur profesori nga Tirana të bisedonte me Shehun për historinë e vendit, të kaluarën. Kishin biseduar tre-katër orë qetësisht dhe deri atëherë, profesori kishte marrë shumë material të çmuar nga goja e Sheh Iljazit. Por, papritur, u muar vesh se shtëpia e tij ishte e rrethuar. Në oborr e pastaj në dhomë, ku ishte miku, futen njerëz të armatosur.

Në shtëpinë e “kulakut” kishte ardhur një person i dyshimtë. Një situatë nga më të vështirat! Duhej qetësi e vetëpërmbajtje. Edhe profesori e kuptoi se ç’po ndodhte. Biseda u ndërpre. Pas disa minutash heshtjeje, biseda nisi, aty ku ishte lënë. Ndërsa biseda vazhdonte, personat që sollën atë situatë e panë se kishin gabuar rëndë. Para tyre fliste një akademik. Kishte ardhur të mblidhte fakte e ngjarje nga historia e popullit tonë në shekuj.

Pas viteve ’70, me dekret të veçantë u vendos që në shtëpinë ku kishte bujtur një natë patrioti i shquar Abdyl Frashëri, gjatë rrugës për të shkuar në Prizren, të vendosej një pllakë përkujtimore. Kjo ishte shtëpia e “kulakut”. Në këtë shtëpi u prit dhe u përcoll me nderime e bujari ky patriot i madh i kombit. Po, a do të vendosej pllakë në këtë shtëpi? Jo, kurrë! Pllaka u vendos në një shtëpi tjetër, shumë afër kësaj.

-Si ka mundësi, aty nuk ka bujtur Abdyl Frashëri!-thanë disa fshatarë.

-Çfarë hipokrizie !-thoshin disa të tjerë. Po atëherë kaq mund të thuhej. Atë e vendoste Partia!

Shtëpia, ku u vendos pllaka, ishte e vjetër dhe një natë me shi u shemb, duke zënë edhe rrugën e fshatit. Punuan disa punëtorë më shumë për të hapur rrugën se sa për të gjetur pllakën. E gjetën edhe pllakën, por tani, për ironi të fatit, e çuan shumë larg shtëpisë ku kishte bujtur Abdyl Frashëri. E çuan tek furra e bukës së fshatit, atje ku gatuhej bukë për kooperativistët. Qëndroi ajo pllakë atje me vite të tëra. U lexua dhe u stërlexua nga fshatarët që rrinin aty në radhë me orë të tëra për të marrë bukë dhe sa herë që nuk merrnin iknin në shtëpitë e tyre duke bërë humor: “Na ka nemur Abdyli, prandaj nuk ka bukë, se pllaka nuk e ka vendin këtu!”

U shemb sistemi komunist e bashkë me të u shemb edhe furra. E historia e pllakës më tej nuk dihet.

Shtëpia e Sheh Iljazit, pas viteve ’90 të shekullit të kaluar, u bë bazë e fuqishme për fillimin e lëvizjeve demokratike dhe më vonë, më 1995, në këtë shtëpi, ashtu siç u prit me nder e bujari patrioti Abdyl Frashëri, po me aq nder e bujari u pritën Prof. Dr. Sali Berisha, Anton Çeta e shumë të tjerë.

Sheh Iljazi qe martuar me Rabishe Litën. Kjo ishte e bija e Ali Litës. Ishte mbesa e Mustaf e Osman Litës, Zyber e Sherif Litës. Ishte motra e Zenel, Xhafer, Rushit, Hamzë e Jahe Litës, të gjithë nacionalistë e atdhetarë të shquar. E dhanë jetën se kishin vetëm një ideal: Luftë pa kompromis kundër komunizmit. Në një ditë Maj të vitit 1946, Rabishes iu vranë 5 vëllezërit brenda një ore. I qau Rabishja vëllezërit atë ditë me vaj e me kuje dhe lotët nuk iu thanë kurrë.

-Mos qajë!-i thanë partizanët,-pusho, se do t’i lidhim duart! Vëllezërit e tu ishin kriminelë e kriminelët nuk qahen.

-Do t’i qajë për jetë.-u tha Rabishja pa iu trembur syri.-Ata ishin vëllezërit e mi. Ju i vratë se ata se nuk e donin komunizmin.

Sheh Iljazi kishte lidhur miqësi në Dibër me Teqenë e Haxhi Osmanit dhe me teqetë e Tominit e të Brezhdanit. Kishte lidhur miqësi me Hidër Valterin në Mat, Shemsi Plakun në Sllatinë, Ali Maliqin në Kërçisht, Abdurrahim Tafën në Sohodoll e Hakik Hoxhën në Krujë, që jetoi në një oborr me Mbretin në Francë.

Sheh Iljazi njihej me Selim Kaloshin, Halil Alinë, Dine Hoxhën e Maliq Markun por idhull pati Mbretin Zog, me të cilin ishte takuar disa herë, kurorën e të cilit e kishte bekuar më 1928 babai i tij, Sheh Zumani.

Sheh Iljazi shpresonte shumë se një ditë do të ndërronte sistemi, sa do i egër e i tejzgjatur të ishte.

-Në të gjithë botën ndërrojnë sistemet.-thoshte ai. –Edhe këtu do të ndërrojë.

Vdiq më 1981 dhe nuk arriti ta shijonte demokracinë aq shumë të dëshiruar e të përfytyruar prej tij. Vdiq i pamposhtur, me mllef e përbuzje për atë sistem.

Edhe ditën e vdekjes, i survejuar, sikur të ishte gjallë. Atë ditë, të gjithë ata që morën vesh lajmin e vdekjes së Sheh Iljazit, në heshtje, thanë: “ Paska ndërruar jetë një burrë i madh!”

Sula e Bexheti morën veglat e varrit e shkuan të hapnin varrin e mixhës së tyre. S’kishte kush të shkonte tjetër! Pas pak te varri shkuan dy bashkëfshatarë: Abdurrahim e Ramazan Abazi. I vriste sedra e dibranit e nuk mund të bënin sehir.

-Ikni!- u thanë ata të dy Sulës e Bexhetit, duke ua marrë veglat nga duart. –Nuk ju takon juve të hapni varrin. Nuk ka ndodhur kurrë! Ju jeni bijtë e tij. Ju sot keni halle të tjera.

-Do t’ju shohin e gojët e liga do të flasin. Do t’ju marrim në qafë.-folën njëherësh Sula e Bexheti.

-Ne punëtorë kooperative jemi e ma poshtë s’kanë ku të na çojnë.-u përgjigjën bashkëfshatarët.

Respekt e mirënjohje për të dy. Kjo që bënë në ato kushte të vështira nuk do t’ju harrohet kurrë. Për atë kohë ishte një guxim i tepruar.

E përcollën atë ditë me dhimbje babanë e tyre për në banesën e fundit djem e bija, nipër e mbesa.

A e meritonte Sheh Iljazi i Veshës një varrim të tillë?!

Ky qe Sheh Iljazi. Kjo qe koha në të cilën jetoi ai. Kohë gënjeshtare e shumë e pabesë!

profil

46 vite mësues i gjuhës dhe letërsisë, drejtor e nëndrejtor në shkollat më të mëdhatë, në Dibër e Tiranë

70-vjetori i lindjes, publicistika dhe produkti letrar i Mevlud Bucit

Nga **HALIL RAMA**

Mevlud Buci është padyshim një emër i spikatur i elitës intelektuale dibrane e asaj kombëtare. Më 2 mars 2021 ai feston 70 vjetorin e ditëlindjes. Plot shtatë dekada jetë, ndër të cilat, pothuajse gjashtë të tilla janë të mbushura me ngjarje që kanë lënë gjurmë në personalitetin e tij krijues. Sepse Mevlud Buci nisi të shkruajë e të botojë që në moshën 10 vjeçare kur ishte nxënës i shkollës 7-vjeçare në Lunarë të Katër Grykëve, të cilën e kreu me rezultate të shkëlqyera. Më pas do ngjiste shkallës e dijes si nxënës shembullor në shkollën pedagogjike "Luigj Gurakuqi" në Elbasan, në fakultetin e Gjuhë –Letërsisë dhe specializimin për stilistikë dhe letërsi me rezultate të larta, po ashtu të gjitha kategoritë e kualifikimit të mësuesisë. Nga CV e tij mësojmë se në vitet 2011-2013, Mevlud Buci përfundon studimet pasuniversitare në fakultetin e Shkencave Humane të Zbatuara të Edukimit dhe mori gradën për Drejtim dhe Administrim në Arsim.

KARRIERË E SHKËLQYER PROFESIONALE SI MËSIMDHËNËS E DREJTUES I TALENTUAR I DISA SHKOLLAVE

Mevlud Buci ka një karrierë të shkëlqyer profesionale si mësimdhënës e drejtues i talentuar i disa shkollave. Plot 46 vite ka shërbyer si mësues i gjuhës dhe letërsisë, si drejtor e nëndrejtor në shkollat, ndër më të mëdhatë e të vështira, në Dibër e Tiranë. Breza të tërë nxënësish e mësuesish të shollave 9-vjeçare e të mesme: "Kadri Abdihoxha", Qafë Murrë, Selishtë, "Kolë Jakova" në Laknas, "Ataturk" e "Sandër Prosi", "Sadi Nuri", Yrshek, e "Murat Toptani" në Tiranë, ku ai ka përhapur dritën e diturisë, e vlerësojnë Mevludin si mësuesin e zellshëm e me talent, për përkushtimin e rrallë dhe profesionalizmin e lartë, si organizator dhe drejtues vizionar. Për këto merita ai është vlerësuar nga institucione, gazeta, revista, fondacione e shoqata të ndryshme me tituj Nderi, Medalje e Mirënjohjeje. Kështu ai mban titullin: "Mësues i dalluar", dhënë nga Ministria e Arsimit dhe "Anëtar nderi i Diasporës" dhënë nga gazeta "Emigranti".

Më 26 nëntor 2016, mori "Mirënjohje" nga shkolla e Sohodollit të Dibrës, ku dhuroi 700 libra dhe 128 revista shkencore. Më 28 shkurt 2018, u nderua me "Mirënjohje" nga Komuniteti Mysliman për ndihmën në shtypin e vëllazërimin fetar.

Mevlud Buci mban çmimin "Pena Budi", 2014, akorduar nga revista "Emathia", Burrel.

Më 30 tetor 2019, nderohet me "Mirënjohje" nga shkolla 9-vjeçare Vranjt, e Kastriotit të Dibrës për arritje në mësimdhënie dhe për botimin e librave të tij.

Më 12 shtator 2020 ka marrë "Çmimin e Karrierës" në konkursin "Muza Budiane 5" (organizuar në shkallë mbarëkombëtare).

PRODUKTI LETRAR I MEVLUD BUCIT, MJAFT I PASUR E CILËSOR

Si rrallë kush në Dibër, Tiranë e gjetkë, Mevlud Buci njihet për produktin e tij publicistik e letrar, të konkretizuar në 27 libra

Si rrallë kush në Dibër, Tiranë e gjetkë, Mevlud Buci njihet për produktin e tij publicistik e letrar, të konkretizuar në 27 libra me poezi epiko-lirike, fabula, epigram, fjalë të urta e shprehje frazeologjike, monografi e publicistikë letrare



QAZIM SHEHU:
"Vëllimi poetik më i ri i Mevlud Bucit shenjtëron, përmes një verbi të sinqertë e plot ndjenjë vendlindjen; vendlindjen si natyrë me male, gryka, përrenj, shkëmbenj, thepa, kreshta, lëndina, lule; vendlindjen përmes një zëri epik, me traditat, luftërat për liri, kullat, qëndresën dhe mbijetesën, për të ngritur lart virtytet e malësorit, të cilat u shenjtëruan nëpër shekuj dhe mbajtën gjallë karakterin e etnisë"

BOTIME TË AUTORIT MEVLUD BUCI

1. *"Krushqia e korbit", satirë*
2. *"Udha e mirësive", poezi*
3. *"Metafora e Shpirtit", aforizma*
4. *"Thirrje njerëzore", poezi*
5. *"Drita hyjnore", publicistikë*
6. *"Krushqia e korbit", ribotim*
7. *"Foleja e shqiponjës", poezi për fëmijë*
8. *"Koha thërret", satira*
9. *"Fletorja e artë Sandër Prosi", publicistikë*
10. *"Ylbere mençurie", aforizma*
11. *"Selim Brahja i Saukut-shenjtor i lirisë", publicistikë*
12. *"Metafora e shpirtit", aforizma*
13. *"Diplomat diplomacia", satira*
14. *"Dritare fisnikërie", publicistikë*
15. *"Fjalor me shprehje dhe njësi frazeologjike nga Dibra"*
16. *"Prova shenjtërie", publicistikë*
17. *"Myftinia e Dibrës dhe Ruzhdi Lata", studim*
18. *"Bukuria e universit të besimit", studim*
19. *"Alegoria e Luznisë dhe gjuha e zogjve", monografi*
20. *"Një jetë në pavdekësi", publicistikë*
21. *"Qëndrestarët e flamurit", studim*
22. *"Udhët e fisnikërisë", publicistikë*
23. *"Alegoria e Dibrës-filozofia e shekujve".*
24. *"Dritë jete, dritë vlerash", publicistikë*
25. *"Qesh e qaj me lot", poezi satirike*
26. *"Mexhit Capa dhe krahët e fisit", publicistikë*
27. *"Shenjtëria", lirika*

NË PROCES BOTIMI:
- *"Molla Bajram Buci", monografi.*
- *"I përfalem mirënjohjes", monografi.*
- *"Përvojë dhe tradita nga mësimdhënia, veprimtaritë dhe arti i drejtimit të shkollës në demokraci".*
- *"Testamenti i përjetësisë", poema*
- *"Ndrit Kaftalli në at' Kashnjet"*



me poezi epiko-lirike, fabula, epigrame, fjalë të urta e shprehje frazeologjike, monografi e publicistikë letrare.

Mbi 50 vite, ka shkruar në mjaft organe shtypi, lokale dhe qendrore, mban vlerësime në shtypin publik, ushtarak dhe nga revista shkencore. Ka shkruar me qindra artikuj në revistën"Hosteni" me pseudonimin "Runja"; në revistën "Obelisk", "Humor shkodran", "Kunji", "Mësuesi", "Humor e satirë", "Urtësia", "Gjuha jonë", "Emathia", "Arsimi sot dhe nesër", "Rreth e rrotull"etj. Për shumë vite ka qenë bashkëpunëtor i Radio "Kukësi" e Radio "Tirana", si dhe bashkëpunëtor shkencor i Akademisë së Shkencave (Instituti i Folklorit).

Mjaftë produktiv e me krijime cilësore shfaqet Mevlud Buci sidomos në librat "Alegoria e Dibrës-filozofia e shekujve", "Dritë jete, dritë vlerash" libër publicistiko-letrar me shkrime, skica, krijime për vlerat njerëzore; "Qesh e qaj me lot", libër me poezi satirike, fabula, tregime, aforizma; "Shenjtëria", libër liriko-epik, poezi me krijimtarinë e 50 viteve të botuara në shtypin letrar; "Udha e mirësive", libër me poezi lirike –filozofike,"Metafora e Shpirtit", libër me një mijë aforizma të krijuara si dhe me dhe në disa libra tjerë të tij.

Ndërkohë ai ka në proces botimi librat: "Molla Bajram Buci (Hoxhë Buci i Dibrës, dritëshenjtori për atdhe e flamur", (monografi)'; "I përfalem mirënjohjes", libër monografik; "Përvojë dhe tradita nga mësimdhënia, veprimtaritë dhe arti i drejtimit të shkollës në demokraci"; "Testamenti i përjetësisë", libër me poema; "Ndrit Kaftalli në at' Kashnjet" (Libër publicistiko-letrar për kullën e Gjokës, fisin Gjoka dhe traditat e brezave, atdhetarët Ndue Mark Gjoka dhe Llesh Ndue Gjoka).

KRENAR PËR TRADITAT DHE ORIGJINËN

Mësuesi, poeti, publicisti e radiokronisti i talentuar Mevlud Buci ka të drejtë legjitime të krenohet me origjinën dhe traditat e vendlindjes së tij. Ai është stërnip i Hoxhë Bucit (Molla Bajram Bucit) i cili njihet në histori si sekretar i Lidhjes së Prizrenit, shok i Iliaz Pashë Dibrës, zotërues i 7 gjuhëve të huaja. Me babanë e me të birin, Hoxhë Buci u vra për atdhe në shtator 1913, me të birin Mustafanë e Hoxhë Bodinin, në malin e Petralës (Petrino) në mësymjen e dytë kundër serbëve. Kulla e Bucit, historikisht, ishte bazë e patriotëve të Dibrës e më gjerë. Xhaxhai, Bajram Buci (I Riu) ishte luftëtar i lirisë qysh në njësitin e parë të çetës së Dibrës; shtëpia ishte bazë e luftëtarëve të lirisë të Dibrës, Matit, e më gjerë.

Mevlud Buci është nip i kullës atdhetare të Manukëve të Luznisë: Hazis e Demir Manuka, burrave të shquar e mentarë: Rrem, Destan, Naim, Sakip, Fetah, Maliq, Seit e Veli Manuka. Më 1920, dajat qëndrestarë e shndërruan kullën në kala qëndrese ku, në rrethim, u vra edhe komandanti serb, gjeneral, -thotë muza popullore.

Besnik i origjinës dhe traditës, Mevlud Buci, ndoshta si rast unikal në historinë e lëvizjeve masive të tri dekadave të fundit, pasi jeto e shërbeu për afro 25 vite në shkolla të ndryshme të Tiranës, si drejtor e zëvendësdrejtor, rikthehet për të banuar e jetuar në kullën e tij të vendlindjes në Lukanin malor të Katër Grykëve të Dibrës, fshati që ka si mburojë Runjën hijerëndë e kreshnikë 2048 metra mbi nivelin e detit., Me bashkëshorten e tij shembullore, Shahen, këtu i gëzohen gjithçkaje, ajrit të pastër që rigjeneraon mushkëritë e tyre, freskisë së maleve, zërit të bilbilave dhe unitetit të atyre pak banorëve që kanë vendosur ta vazhdojnë jetën në këtë fshat me histori të lavdishme, në zemër të maleve. Këtu frymëzimi i tij është i pashtershëm. Në atë votër të ngrohtë familjare ia merr këngës me çifteli dhe valles, si dikur kur debutonte shkëlqyer në festivalet folklorike lokale e kombëtare.

Pëlqimet e tij mbeten: Dashuria për njeriun, traditat, folklorin, misteret e psikikës e të pedagogjisë, mjeshtëria dhe takti në mësimdhënie dhe drejtimin arsimor. Këto pasione të tij i gjejmë të shprehura edhe në vëllimin e tij më të fundit poetik "Shenjtëria", në parathënien e të cilit, poeti dhe kritiku i mirënjohur letrar Qazim Shehu, duke e vlerësuar Mevlud Bucin si poetin e ngjyrave të vendlindjes, të dashurisë dhe patriotizmit brilnat, ndër të tjera shprehet se: Vëllimi poetik më i ri i Mevlud Bucit shenjtëron, përmes një verbi të sinqertë e plot ndjenjë vendlindjen; vendlindjen si natyrë me male, gryka, përrenj, shkëmbej, thepa, kreshta, lëndina, lule; vendlindjen përmes një zëri epik, me traditat, luftërat për liri, kullat, qëndresën dhe mbijetesën, për të ngritur lart virtytet e malësorit, të cilat u shenjtëruan nëpër shekuj dhe mbajtën gjallë karakterin e etnisë; poeti shenjtëron e shpalos dashuri, mall, përkushtim dhe mirënjohje edhe për sa njerëz të cilët i ka njohur, njerëz të thjeshtë po edhe të përmendur".

Rruga e Arbërit nr. 174
kujtesë

Ibrahim Kaziu ishte njeriut human dhe mjeku i përkushtuar, i cili gjithmonë, kudo ku jetoi, punoi dhe shërbeu, la gjurmë të çmuara të dashamirësisë, përkushtimit, korrektësisë dhe punës së suksesshme, duke qenë dhe duke mbetur një model i spikatur dhe shembull për gjithë.

Ibrahim Kaziu, mjeku që rron në mijëra emra dhe zemra

Nga **SHAQIR ÇERPJA**

Kush guxoi dhe tregoi?! Kush nuk duroi e tha dhe lajmin e dha?!

Kujt fjala, zëri dhe zemra i ngriu kur i thanë se ka vdek Ibrahim Kaziu?! Kush trillon e thotë se, Ibrahim Kaziu ka ikur nga kjo botë; se ai ka vdek e nuk është më në jetë?! Jo! Jo! Ibrahim Kaziu ka ndërru jetë, por nuk ka vdek, se ai rron në mijëra emra dhe zemra.

Po takoheshin dhe po ndaheshin stinët. Vjeshta po ikte dhe dimri po vinte. Ishte fund vjeshte, fund nëntori ishte. Ishte prag festash, por nuk ishte kohë festash, sepse viti 2020 erdhi dhe po ikte me dhimbje dhe lot. Ky vit i brishtë erdhi dhe ishte i trishtë. Na i zbehu festat dhe i pengoi festimet, i anuloi dasmat, i kufizoi lëvizjet, i trembi ditëlindjet dhe i shumëfishoi ditëvdekjet, i boshatisi shkollat dhe universitetet dhe i mbushi e tejmbushi spitalet, i ngriu buzëqeshjet dhe i mpiu lulet, i përloti orët, ditët dhe muajt, ...

Katër ditë, vetëm katër ditë para festave të nëntorit, pushoi zemra e doktorit, njeriut human dhe mjekut të përkushtuar, Ibrahim Kaziu. Lajmi për vdekjen e tij fluturoi si plumbi dhe si plumbi shpoi, plagosi e vrau zemrat e njerëzve, në Dardhë e Dibër, në Tiranë dhe anë e mbanë, jo vetëm Shqipërisë, por edhe jashtë vendit tonë, deri edhe në Amerikë. Edhe hëna u tremb, u dridh e u fsheh, dritë nuk lëshoi dhe nuk ndriçoi atë natë. Por lajmi i trishtë, dhimbja e madhe dhe pikëllimi i thellë nuk u ndalën, por ecën natën, nëpër errësirën e natës. Shkuan kudo ku shkonte lajmi. Në vendlindje, në Dardhë, njerëzit u thanë dhe u treguan pemëve, pemët u treguan zogjve, zogjët u treguan krojeve dhe krojet nuk rrodhën më ujë, por rrodhën lotë. Në Peshkopi, në qytetin e blireve, degët e blireve u tundën e gjethet u shkundën dhe pas lajmit dhe me lajmin shkuan. Prej disa ditësh, pacientët në spitalin rajonal të Peshkopisë vështroni nga korridori dhe prisnin të vinte doktori. Por doktori Ibrahim Kaziu nuk po dukej, po vonohej, nuk po vinte. Po, atë mbrëmje nëntori, lajmi i trishtë i shpërtheu dyert dhe dritaret e spitalit dhe shkoi e vajti në çdo kat, në çdo pavion, në çdo dhomë, tek gjithë personeli, tek secili koleg dhe tek secili pacientë, të cilët qanin me lotë për doktorin, për mjekun e tyre. Shpirti i tyre kishte ngrirë akull. Edhe loti në sytë e tyre ngriu. Edhe lëngu i surumeve ngriu në tubat përcjellës, sepse nuk qanin vetëm njerëzit. Qante gjithë spitali, muret, shkallët, orenditë dhe paisjet.

Ibrahim Kaziu ishte në punë, në krye të detyrës, midis kolegëve dhe pranë pacientëve, duke u shërbyer e duke i kuruar ata. Dhe, aty u takua me virusin, aty e kuptoi sëmundjen, aty e ndjeu dhimbjen, aty e parandjeu rrezikun.

* * *

Në një shpat të pjerrët në veri të Zall-Dardhës deri në kufi me Reçin, jo atje ku ndahet, por aty ku bashkohet Reçi me Dardhën, buzë Drinit, jo shumë larg derdhjes së Veleshicës, rrëzë Manrosit e poshtë Soricës, shtrihet fshati Shënlleshën, ku para disa shekujsh, këtu u vendos fisi Kaziu, një fis i vogël, por me shumë histori, nga i cili kanë dalë burra me zë dhe emër, si Ahmet e Shaban Kaziu, Ali e Murat I. Kazia, etj., të cilët kanë luftuar përkrah Elez Isufit, Suf Xhelilit, etj., por që në konakun e tyre kanë prit dhe përcjell burra të shquar të kombit, si Bajram Curri, Hasan Prishtina, etj. Por edhe më vonë, nga ky fis kanë dalë njerëz me reputacion, që kanë lënë gjurmë dhe emër, jo vetëm në historinë e Dardhës, por edhe më



gjerë, si Rexhep M. Kaziu, Ramazan Kaziu, mjekja pediatre, Huzrie Kaziu, etj. Historinë e këtij fisi e nderon dhe e lartëson deri në admirim, emri i mjekut me personalitet të spikatur njerëzor, intelektual dhe profesional e shkencor, Ibrahim Kaziu.

Në këtë fis të fisëm, më 18 maj 1952 u lind Ibrahim Kaziu, mjeku, i cili, gjithë jetën e tij ia kushtoi dhe ia dedikoi jetës dhe shëndetit të njerëzve, shërbimit ndaj tyre. Ibrahimi u lind në një familje të madhe tradicionale dërnjane e dibrane, me zë dhe emër, me rreth të madh e të zgjeruar fisnor, shoqëror e miqësor; një familje bujare, me sofrën gjithmonë të shtruar, që priste dhe pret e që kishte harmoni, unitet e stabilitet. Familja e tij ishte e zhvilluar, e kulturuar, e përparuar dhe e emancipuar. I ati i Ibrahimit, Xhep Kaziu, në moshë të re ishte partizan në radhët e brigadës së 18-të sulmues, ndërsa pas çlirimit punoi në tregti në Zall-Dardhë, por edhe në ndërmarrje shtetërore, etj. për shumë kohë, për shumë vite me radhë ishte zgjedhur në organet e pushtetit dhe të ekonomisë, jo vetëm të fshatit, por edhe të zonës.

Ibrahimi, pasi kreu dhe mbaroi shkollën fillore dhe 7-vjeçare në Zall-Dardhë, vazhdoi mësimet në shkollën e mesme "Jani Minga" në Vlorë dhe pasi kreu e mbaroi shkollën e mesme mjekësore, u kthye në vendlindje dhe filloi punë e punoi ndihmësmjek në qendrën shëndetësore në Zall-Dardhë. Por punoi vetëm pak kohë, sepse u mobilizua ushtar dhe kreu shërbimin ushtarak.

Ndonëse i rritur në moshë dhe ndonëse kishte kryer edhe shërbimin ushtarak, Ibrahimi nuk hoqi dorë nga dëshira e madhe dhe ëndrra e tij e zjarrtë për të vazhduar studimet e larta. Dhe nuk u dorëzua. Këmbënguli, luftoi, fitoi dhe vazhdoi studimet e larta në Fakultetin e Mjekësisë në Tiranë. Pas përfundimit të studimeve të larta, tashmë i pjekur dhe i formuar si intelektual dhe me përgatitje të lartë profesionale dhe shkencore, rifilloj punë përsëri në qendrën shëndetësore Zall-Dardhë, jo vetëm si mjek, por për shumë vite edhe përgjegjës i qendrës shëndetësore Zall-Dardhë, ku përveç ambulancës, kishte dhe funksiononte edhe maternitet me shtretër dhe ushqim, shërbimi dentist, farmaci, etj. Shpirti i tij rinor, i mbushur dhe ushqyer nga dëshira për sukses dhe progres dhe ai, i ri, i gjallë, energjik, entuziast, optimist, me pasion, vullnet, me përkushtim dhe këmbëngulje, punoi me të gjithë forcat për t'u shërbyer njerëzve, jo vetëm të sëmurëve në spital, por edhe në shtëpi, në çdo familje në nëntë fshatrat e Dardhës. Përveçse specialist i aftë dhe kompetent, ai ishte njeri i dashur e dashamirës, i thjeshtë, modest, tolerant, i kulturuar në komunikim e shërbim, korrekt me njerëzit, me kolegët, pacientët, shokët ... Përveç shërbimit korrekt dhe cilësor, prania e tij u jepte të sëmurëve dhe familjarëve të tyre edhe kurajo, forcë, besim dhe shpresë. Me punë dhe nëpërmjet punës, ai fitoi respektin dhe mirënjohjen e të gjithë njerëzve.

Ndërkohë që punonte mjek dhe përgjegjës i qendrës shëndetësore në Zall-Dardhë, Ibrahimi u njoh me mësuesen e dalluar, Femije Dacin nga Shupenza, me të cilën u lidh dhe u martua dhe krijuan një familje model.

Pas disa vitesh në Zall-Dardhë, në vitin 1985 Ibrahimi transferohet në Shupenzë, ku punoi dy vjet mjek në spitalin e Shupenzës. Sigurisht, puna e tij në Zall-Dardhë dhe në Shupenzë ishte evidentuar dhe vlerësuar nga institucionet dhe organet kompetente në rreth dhe, nga Shupenza, Ibrahimi dërgohet për specializim dyvjeçar për phnemoftiziatër. Pas specializimit, caktohet me punë në spitalin e Peshkopisë, fillimisht përgjegjës i dispancerisë. Përveçse mjek në spitalin e Peshkopisë, ka kryer edhe detyra të ndryshme, si shef pavioni, tri herë ka qenë drejtor i spitalit rajonal të Dibrës, ka qenë edhe drejtor i shërbimit parësor të Dibrës. Në tri legjislatura ka qenë kryetar i Urdhërit të Mjekut për prefekturën e Dibrës. Gjithashtu ka qenë anëtar i këshillit bashkiak të Peshkopisë dhe mësimdhënës i jashtëm në shkollën e mesme të infermierisë në Peshkopi. Në fund të jetës e të karrierës së tij ishte edhe nëndrejtor i spitalit rajonal të Dibrës.

Mjeku Ibrahim Kaziu një jetë, gjithë jetën e tij, ia kushtoi dhe ia dedikoi jetës dhe shëndetit të tjerëve, shërbimit ndaj tyre. Edhe pse doli në pension, ai nuk e ndërpreu punën, sepse njerëzit kishin nevojë për shërbim dhe spitali kishte nevojë për mjek, sepse nevoja për mjek ishte shtuar e mjekët ishin pakësuar. Dhe vazhdoi të punonte me atë pasion, përkushtim, këmbëngulje dhe korrektësi, si edhe më parë. Por, veçanërisht gjatë vitit 2020, shërimi në spital nuk ishte punë, por ishte luftë. Luftë e gjatë, luftë e fortë, luftë e ashpër. Luftë me virusin dhe rrezikun e padukshëm, por kudo e gjithkund të pranishëm. Ibrahim Kaziu punonte dhe luftonte duke u shërbyer njerëzve, të kuronte e të shëronte të sëmurët, duke qenë i vetëdijshëm për rrezikun që mund t'i vinte e mund të kishte për vete, për shëndetin e tij.

Dhe, në fillim të nëntorit diçka shqetësues ndjeu, diçka serioze kuptoi, diçka të rëndë e të rrezikshme parandjeu... Dhe, nga dita në ditë ishte më i lodhur, më i këputur, më i pafuqishëm derisa një ditë nuk pati fuqi as t'i telefononte nënës dhe ta përshëndeste e ta pyeste për shëndetin. Mjeku Ibrahim Kaziu, i cili, gjithë jetën u kishte shërbyer pacientëve, nuk ishte më mjek, por si pacientët e tij, edhe ai vetë u bë pacient. Personeli dhe pacientët, të mërzitur, të shqetësuar, të trembur dhe të frikësuar, më shumë me shenja se sa me zë, merrnin dhe jepnin lajmin se doktori Ibrahim Kaziu ishte prekur nga virusi. Dhe, harruan veten dhe shëndetin e tyre dhe me shpirt e me zemër luteshin për doktorin dhe uronin që ai të përmirësohej, të shërohej dhe t'u shërbente përsëri pacientëve, t'i kuronte dhe t'i shëronta ata.

* * *

Ambulanca fluturonte drejt Tiranës, por edhe sëmundja ecte me shpejtësi në trupin e doktorit. Të rënda e të vështira, shumë të rënda e shumë të vështira ishin orët, ditët dhe netët në spitalin amerikan në Tiranë. Doktori-pacient përballej dhe luftonte me vdekjen, ndërsa familjarët, bashkëshortja e tij, Femija, vajza e mirë, Mira dhe djemtë Elvini dhe Eugeni nuk kishin fuqi të ushqenin shpresat e njëri tjetrit. Thuhet se shpresa vdes e fundit, por edhe shpresat e tyre ishin lodh e dobësuar. Dëshira dhe shpresa nuk rrinin e nuk ishin bashkë, ishin ndarë dhe ishin larguar nga njëra-tjetra.

Atë ditë të martë fundvjeshte dielli po perëndonte. Ashtu si dielli i asaj pasdite vjeshte, edhe doktori po numëronte çastet e fundit të jetës dhe nga çasti në çast zbehej, dobësohej... Po perëndonte dhe po shuhej jeta e tij. Dhe, atë pasdite të 24 nëntorit 2020, zemra e tij u ndal. Pushoi zemra e doktorit Ibrahim Kaziu, njeriut human dhe mjekut të përkushtuar, i cili, gjithmonë, kudo ku jetoi, punoi dhe shërbeu, la gjurmë të çmuara të dashamirësisë, përkushtimit, korrektësisë dhe punës së suksesshme, duke qenë dhe duke mbetur një model i spikatur dhe shembull për gjithë. Emri i tij është si një diell, që ndriçon në mendimet dhe kujtimet e njerëzve, buzëqeshja e tij është bashkuar me ngjyrat e ylbereve dhe është hapur mbi petalet e luleve, zëri i tij është bërë melodi e këngë në shpresat e pacientëve, ... Ai nuk ka vdekur dhe nuk vdes. Se, Ibrahim Kaziu rron në mijëra emra dhe zemra...

poezi

Poezi nga Nuhi Shehu

LIMJANI

Më ka marrë malli ...
Një mall tipik si prej ushtari.
Dhe ai që ma zgjon ndjenjën,
Limjani është i pari.

Nuk dua asgjë ... asgjë ...
Në këtë mall të trishtë njerëzor ,
Po dua ashtu si Nazim Hikmet
"Të shkoj n' vendlindje veç një orë."

Veç atje më shuhet malli
Në të voglin fshat tipik,
Ku formojnë një botë intime;
Këngët,muzgjet,vajzat, shtëpitë ...

Atje ke qejf të bredhësh vetëm
Kur të gjithë në gjumë kanë rënë,
Të shohësh yjet se si ndrijnë
Dhe vargje të shkruash nën hënë.

Si një frymëzim poezie
Rron ai në sfond të malit,
Dhe frymë merr brenda meje –
Nga mushkëritë e Korabit.

Tirane 1995

TI JE E GJITHA...

Ti je e gjitha pije e shenjtë
Në gotën e endjes ku të pi qetësisht.
Pa mëshirë qepenat moj do t'i shkallmoj
I dehur me ty barbarisht.

Qepenat kërcasin me gjuhë vajtimtare
Dhimbshëm mbulohet, ah fytyra jote...
Po perçe e metaltë s'i mposht sytë e mi
Për ta ndjerë shikimin e pamjes magjiplote.

Për sytë mëngjesorë etur horizontesh...
Muzgje dhe perçe të tilla s'do ketë.
Kur ti e gjitha plazmuar në mua
Aher' qepenat do bien përjetë.

22.04.1997

AMBICJE

Jagot janë përhapur në botë shumë.
Ligësht flasin për Otello e Dezdemonë ...
Dhe nxisin Makbethet që në gjumë
Dunkanët t'i vrasin natën vonë.

FYTYRËN TËNDE

Fytyrën tënde e dashur,
Relike të ditëve plot shkëlqim.
Si një medaljon të shenjtë e kam varur
Rreth qafës së shpirtit tim.

FILLIM POEME PËR MIFTAR KRASHIN

Hijeshuar kish shtatin me petk hynor!
Prej Zotit pagëzuar me emrin polic.
E deshi jetën e për hir të saj
Të keqen luftoi gjer në sakrificë.

Po në shmang priste pabesia
Fshehur medet përroit të Setës...
Aty ai ndaloi dhe nisi po aty –

Rrjedhën e amëshuar të "Lumit të Jetës".

BLIRI

Baladat janë të gjata, të trishta
Pothuaj mbarojnë, me nga një varr nën bli...
Agron Tufa

Fytyrëtrishtë shfaqet në balada...
I heshtur, i kyçur – dëshmitar i gjallë,
Për fatin e dashnorëve që treten nën dhé
Nga djali tradhtuar a duel i vrarë.

Me gjethet e blerta mermerin ngadalë
Vargje elegjie me zërin e mekur;
Me zërin e mekur si psallme, si lutje...
Si ngushëllim për varrin me vdektarin tretur.

Nëpër muzg bien këmbana kristali
Dhimbshëm diku, qan një sharki –
Qëndisur jehonat me nuanca malli
Për të riun varr ngritur nën bli.

03.10.1996

TI JE KAQ E BUKUR...

Prej bukurisë tënde
Statujat marrin jetë ...
Dhe djemtë po prej teje
Në statuja kthehen krejt.

ÇAST POETIK

Muzg i theksuar në mavinë e detit
I ndjeshëm si lirikë dashurie...
Paqësor e i dridhshëm – shpirt adoleshenti
Me drita vaporesh, stoli nusërie...

Piktorë, poetë, fotografë... hej
Kapeni muzgun që papërsëritshëm ikën!
Mrekullohuni nga ky bujar madhështor,
Me imazhe, emocione, që nuk përsëriten.

Perandoria e natës bie ngadalë,
Valët thërrmohen në bregun e shkretë...
Trishtë fari digjet në pritjen pafund
Për muzgun që s'kthehet, hej medet!

Durrës, 1999

KENGE

Ti je atje pas atij mali
Unë pas qelqit avulluar
Psherëtij dhe hesht ngadalë
Në kafenenë e preferuar.

Thonë se qetësohen shpirtërat
Kur prej qiejsh pikon shi.
Por nuk qenka krejt ashtu
Me mal përpara dhe pa ty.

Do t'i shemb të gjitha malet
Këngën time do shaloj,
Dhe dritë agimesh e ylbere
Dhuratë qiejsh do t'i çoj.

Merre ylberin ngjyra – ngjyra
Në flokë vere si karficë,
Se ti je krijesë qiellore
Paçka se linde në Ilnicë.

Në të largëtin fshat malor
Diku në kufijtë e shtetit
Linde ti për të ngjallur
Shpresën e vdekur të poetit.

Do t'i shemb të gjitha malet
Këngën time do shaloj;
Dritë agimesh dhe ylbere
Dhurate qiejsh do t'i çoj.

28.12.2000

Poezi nga Alide Lloga Dika



Artklub në Dibër Madhe me kryetar z. Nebi Samarxhiu ka në gjirin e saj shkrimtarë e poetë të njohur dibranë, që më krijimtarinë e tyre kanë lënë gjurmë në letërsinë shqipe.

Edhe plejada e më të rinjve, veçanërisht në poezi, si Delvina Kërluku, Arbëresh Turkeshi etj.

Një ndër poetet e njohura të këti klubi është edhe Alide Lloga, poetja dibrane që jeton e punon në Strugë. Poezia e saj është e ndjerë, me mendim e më mesazh të qartë artistik.

Adile Lloga ka botuar poezi në shtypin letrar në Dibër të Madhe, Tetovë, Strugë e Shkup.

Ajo ka botuar vëllimet poetike "Odeoni i çmendurisë", "Mes titujve të humbur" dhe në vitin 2020 botoi edhe vëllimin poetik "Përtej shikimeve", i cili u prit mirë nga lexuesi dhe kritika letrare. Është e përfshirë në disa antologji poetike, mes të cilëve edhe "Na bashkoi poezia - Dibra ime" (2020).

Krahas krijimtarisë poetike, ajo si regjisore ka realizuar edhe disa dokumentarë dhe filma për të rinj, ese filmike, të cilat janë transmetuar në kanalin televiziv TVM2.

Poezitë e botuara më poshtë janë një përzgjedhje e posaçme për gazetën "Rruga e Arbërit" nga Ilmi Dervishi.

Shikimi i trembur

Shuhet një dhimbje?
Shtresuar rri vdekja
e një jete...

shuhet një dhimbje?
Në nota t'arta dëgjohej
... një klithmë

shuhet dhimbja?
(pa)mbarim!

Shuhet...!

A shuhen vërtet dhimbjet njerëzore?!

Trazim kohe

jo në çdo urtësi fshihej uni juaj
jo më kot vdekjet s'rrëmbejnë- s'vrasin
Jetë është jetë...

e Sotmja
e Djeshmja
e Nesërmja
jo më kot u pagëzuan drithërima- shëndetliga
jo më kot duhet të tejkalojmë ujëra-ters
gjysmë zgjëndërr
gjysmë e zhgënjyer
gjysmake frymë
të gjymtë përgjithmonë

(nata mbulon yjet e jetës)
Njeri në mbiqenje të trazuar.

Ata të ikjes

Sytë hareshëm hedhin troket
n'dashuri!

Në sy jete më ishe fshehur
Në dritëz të syve të mij.

Kaherë shtruar-shtruar... ecje.

Syte e tu.
Sy te vegjëlisë, të përjetësisë.
Ata...!

Ka do gjëra në jetë që nuk rreshtim kurrë së dashuruari.

Pas jetës për një jetë

Trungu dergjej në atë dhè,
po në atë dhè dergjej dhe trupi yt

moshës kokën mos ia kthe
e ndër duar ti mos u kthe!

do të dergjej ai trup e në atë trung
ti ik dhe n'dhè le të dergjej trupi yt!

Rrugë nepërkë
Elegji për ato...

Mike e ditës së sotme!
Kaluan shumë kohë që fjalët u kthyen në heshtje.
Ka kohë që buzëqeshja u kthye në heshtje varri...

Sakaq s'tronditet hijëshia e kësaj bote-virgjërake
po aq sa drita në thellësi dishepujsh.
Ku mbeti sinqeriteti i shpirtit, fjalëve?
Në ç'vend t'i kërkoj sytë e asaj kohe?

M'u në mes të dritës
gjithçka rrezëllin terr, o mike!

Në horizonte pranverake vendosur pata qeshur,
këtë e varrosi e shkuara!
Me to u nisën edhe tufat e fjalëve,
puthjeve, qeshjeve, drithërimave, emocioneve,
grindjeve, përkëdhelive...,
me to u nisën edhe zhgënijmet.

S'do kohë as përshëndetja mëngjesore
as dhe klithma n'kryqëzime rrugësh.

Miqësia s'besoj se ekziston në të vërtetë!

Kujtesë kohe

Këmba m'rrëshqet mbi vellon e syve të mi
duartokitjeve të asaj kohe s'ua vura veshin
dhëmbët gjerdanor qeshnin

por këmba do t'më rrëshqet mbi vello të së djeshmes

s'ka hapa
s'ka sy
jo, jo s'ka
nuk ka jo

kjo këmbë seç rrëshqet pa marr pëlqimin tim
ç'tollovi?!

Kujdesi në jetë ta ndriçon rrugën.

Rruga e Arbërit nr. 174

histori

Historia e shkruar e Fisit Cakoni zë fill në fillim të shekullit XX.

100 vjet në luftë për liri dhe dinjitet kombëtar

Nga **ESAT RUKA**

As djegia e kullave, as burgjet e vitet e shumta të internimit që bënë burrat e Cakonëve nuk e mposhtën shpirtin liridashës dhe patriotik të tyre.

Sikundër fashizmi nuk mund tua falte shpirtin antifashist edhe komunizmi nuk mund tua falte shpirtin atdhetar dhe prozogist burrave e grave të nderuar të Derës së madhe Cakoni.

Jeta, që tashmë është futur në një epokë të re vlerësimi dhe praktikash, po na përball me humbjen e shumë njerëzve të dashur. Opinioni njerëzor, duke "harruar" ndonjëherë se Zoti që na ka falur jetën ka drejtën të na e marr, ngushëllohemi me shprehjen *"e dhimbshme, por humbje e radhës"*. Nëse Zoti bën të tijën, ne njerëzit e afërt duhet të bëjmë tonën. Ceremonitë tradicionale "na vënë në prove" për të bërë shërbimet më të mira.

Me gjithë trysninë e jashtëzakonshme që po ushtron minutë pas minute kërcënimi drithërues i COVID -19 në reduktimin e "dhunshëm" të njerëzve në ceremonitë e varrimit, përsëri njerëzit yshten nga tradita e mirënjohur e një solidariteti human. Të ndjerit "borxhli" i miqve, kolegëve e të afërmve dhe pjesëmarrja e shumë njerëzve padyshim e rrit moralin dhe e forcon durimin. Njëkohësisht nxit e ngulit në vetëdije detyrën për të përmendur emrin e mirë të prindit, familjes, fisit e gjithë species njerëzore si një krijesë që me shembullin që kanë lënë, i japin individit dhe shoqërisë kuptimin e jetës.

Para disa ditësh ndërroi jetë **Ibrahim Cakoni** nga Bazi**,** me banim në Fushë-Krujë në moshën 85 vjeçare. Ai i përballoi vështirësitë e jetës duke



Ibrahim M. Cakoni

prerë e furnizuar me dru zjarri banorët e atij qyteti. I ndjeri ishte fëmija i tretë i prindërve Met Ali Cakoni dhe Lihe Cakoni (Shema-nga Karica), pas Aliut dhe Pashes. Miqtë e vjetër dhe të rinj krutanë e kurbinas që e rrethonin u përpoqën t'ja lehtësojnë përballimin e jetës në konsolidimin e familjes së tij. Për këtë djemtë u drejtuan mirënjohjen e pakufishme bashkqytetarëve në ditën e varrimit të babait të tyre të shtrenjtë.

Daja Ibrahim me bashkëshorten Deje lindën dhe rritën 3 djem,të cilët falë edukatës së rrënjosur nga prindërit për të ruajtur e trashëguar tiparet më të mira të një fisi patriot e human, krijuan një shoqëri qytetare dhe përballuan me dinjitet kufizimet e shpërfilljen politike. Djemtë punëtorë, të thjeshtë e të dashur krijuan familje dinjitoze me fëmijë të shkolluar, disa prej të cilëve emigrantë në Evropë dhe SHBA. Sot ata gëzojnë respektin e të afërmve dhe të shoqërisë. Krahas punës së përditshme, bëjnë përpjeke për të vënë në vend dinjitetin e gjyshërve dhe stërgjyshërve dhe kontributet për liri, demokraci prosperitet.

Nëpërmjet këtij punimi do të njihemi me kronologjinë e kontributit atdhetar rreth 100 vjeçar për lirinë dhe pavarësinë e atdheut të tri gjeneratave të Fisit **Cakoni** të Bazit në Mat në luftë me turqit, austro-hungarezët, fashistët italianë dhe nazistët gjermanë.

Historia e shkruar e Fisit **Cakoni** zë fill në fillim të shekullit XX.

Ky fis u konsolidua nga rrethanat historike të luftrave të shumta që zbarkuan në hapësirat e Shqipërisë Etnike. Administrata turke dhe lakmitë e fqinjëve mbollën në botën shqiptare përçarjen dhe varfërinë e banorëve edhe të Bajrakut të Rranxës. Mungesa e një administrate vendase shtroi para rrazjanëve nevojën e një organizimi fisnor e më pas krahinor si alternativë e vetme për mbijetesë dhe mbrojtjen e vendit, nderit, pronës dhe dinjitetit .

Shembull për këtë do të bëhej *"kryekaçaku dhe kryeshënjestari shqipatr* në luftë kundër turkut"Marka Kuli,të cilit rreth vitit 1896 vendasit i dhanë tokë e truall në Fushën e Shtogjut-Bushkash **1)**

Ndër krerët e Rranxës që u vunë në krye të luftës dhe rezistencës kundër turkut për lirinë e Atdheut ishte **Mustë Tahiri** (Cakoni)**. 2)**



Mustë Tahiri (Cakoni)

Në vitin 1906 nga ana e administratës turke përsëri ndërmerret një ekspeditë për vendosjen e qetësisë dhe nënshtrimin e kryengritësve, por tashmë krerët e Bazit e Karicës kishin krijuar përvojë në përballjen dhe zmbrapsjen e armikut. Krosi i Ali Gjekës (Cakoni) dhe Halil Gjekë Cakoni me shokë zmbrasën ekspeditën e pushtuesit turk nga Rranxa,

Përkrah Ramadan Zaskocit dërgohet fjalë që forcat turke të mos kalonin në asnjë mënyrë në Mat e në Dibër. Mustë Tahiri dhe Kolë Gjini u bënë frymëzim për të gjithë malësorët e tjerë edhe të krahinave përreth. **3)**

Më 2 dhjetor 1912 te lisi i Shëlbumit në fushën e Shtogjut **Ali Musta** me



Ali Mustë Cakoni

djemtë e tij Cubin, Metën dhe Muratin së bashku me patriotë e atdhetarë të tjerë të Bajrakut, me matjanë e mirditorë marrin pjesë në manifestimin e ngritjes së Flamurit Kombëtar. **4)**

Më13 gusht 1911 u krijua **Çeta patriotike e Bazit** me kryetar Dodë Bardhok Daçin, ku si formacion luftarak rolin kryesor komandues e ka luajtur **Krosi i Ali Gjekës.**

Met Ali Cakoni ishte ndër krerët e kësaj Çete. Çeta do të kishte aktivitet të ndjeshëm edhe gjatë pushtimit austro-hungarez **5).**

Më **1917** në kodrat e Shullanit të Vilës kundër austriakëve plagoset rëndë**Cub Ali Musta**.

I ati, Ali Mustë Cakoni në luftë me austrohungarezët kapet rob dhe syrgjynoset në Kotorr të Malit të Zi. Pushtuesit ia dogjën kullat Mustë Tahirit dhe Sulë Vokrrit, por të tjerë luftëtarë matjanë do t'ua merrnin hakun duke ua djegur garnizonin në Trangë të Selitës.

Nga 1928-a edhe Rranxa filloi të ndjej forcën e shtetit të asaj periudhe.

U krijua një komunitet që u bënë ithtarë të Mbretnisë dhe të A. Zogut.

Metë Ali Cakonit iu besua detyra e mbledhjes së Taksave. Ai me



Met Ali Cakoni

zgjuarsinë dhe drejtësinë e tij e bindi popullin e Rranxës për këtë qëllim.... Shumë shpejt në saje të një trajtimi bindës u ndalua gjakmarrja, u rrit shumë interesi i shtimit e zhvillimit të bujqësisë, blegtorisë dhe pyjeve, vënies së tokave nën ujë etj. **6)**

"Met Ali Cakoni, portret i hollë i mençurisë popullore, personazh i skalitur në "Kanunin e Skënderbeut", një ndër organizatorët e Kuvendit Legalist në Shupalin e Tiranës, i burgosur dhe i internuar nga Italia fashiste, i burgosur edhe nga diktatura komuniste si " Armik i klasës".

Pikërisht në vjeshtën e vitit 1944 ai u vu në krye të më se 50 burrave rrazjanë për formimin e "Shtabit legalist" në Shupal të Tiranës. Kjo çetë për tre muaj rresht mbajti anën e të gjithë oficerëve zogistë me në krye Abaz Kupin**7).**

Që në vitin 1914 me princ Vidin, *shkruan në kujtimet e veta z. Hysen Selmani*, zë fill hyrja në histori e fisit Cakoni.

Autori trajton bisedimet e Preng Bib Dodës me Ahmet Zogun në familjen e Algjekajve në Baz më 22,23 dhe 24 prill 2014. Me vendosjen e Mbretnisë shtëpia e Algjekajve (Cakoni) dhe veçanërisht Krosi që atëherë kishte gradën e Togerit nërezerve, ishte e afërt me Mbretin.

Halil Xhekë Cakoni pas mbarimit të shkollës ushtarake shërben në Oborrin Mbretëror e më pas në Gardë. 7 Prilli e gjen me gradën e kapitenit, kur gjatë luftës shërbente në Kosovë. Gjatë pushtimit gjerman bashkohet me Legalitetin. Kushëriri i tij **Kurt**



Halil Xhekë Cakoni

Cakoni në gusht 1944 u bashkohet partizanëve dhe vritet në përpjekje me forcat gjermane në Borizane të Krujës.

Abaz Cakoni (Bardh) mbaron shkollën e aspirantëve në vitet e para



të Mbretërisë dhe shërben në Tiranë, Qafthanë e Qafmurrë. Pas 7 prillit i bashkohet Batalionit "Hakmarrja". Gjatë pushtimit gjerman bashkohet me Legalitetin dhe i plagosur dorëzohet te partizanët. Ndërsa 10 oficerë dënohen me pushkatim, Abazi i shpëton pushkatimit nga ish ordinanca e tij që ishte bërë funksionar i lartë i gjykatës në Peshkopi. E internojnë dhe lirohet nga internimi, por vdes nga tuberkulozi në vitin 1951.

Shpirti atdhetar i matjanëve të Rrazës e kuptoi se ***Ahmet Zogu*** mund të ishte shpëtimtari i vërtetë i integritetit të vendit dhe i krijimit të shtetit modern shqiptar. Fashizmi s'mund t'ua falte djemve të Rraxës këtë shpirt prozogist ndaj në dhjetor të vitit 1942 Krosi i Ali Gjekës, Met Aliu, ... u mbyllën në një burg fashist bashkë me Heroin e Popullit Manush Alimani. **8) Halil Mehmet Cakoni** (1914-1979-kushëri i parë i Cubit dhe Metës) ishte ndër intelektualët e parë



Halil Mehmet Cakoni

të Bajrakut të Rranxës. - E gjeje gjithnjë me një libër në dorë. Akademisti, komandanti i kompanisë IV të batalionit "Dajti" nga viti 1941 deri në vjeshtën e 43-it ishte në frontin e Luftës së Dytë Botrore në mbrojtje të lirisë së vendit e flamurit kombëtar, para të cilit ishte betuar. Pas kapitullimit të Italisë bashkëpunon me Legalitetin. Sapo përcolli Abaz Kupin drejt Italisë në vjeshtën e vitit 1943 do të ndahej me ushtarët e tij me fjalët: "Tri ditë që po vijnë janë të komunistëve. Punës tonë, të ne oficerëve nuk i dihet. Me ndonjërin ndoshta do t'i qëllojë të takohemi. Por si shokë, jo si komandanti me ushtarin". Filloi punë llogaritar në ndërmarrjen pyjore e më pas si llogaritar i parë i Kombinatit të Drurit në Elbasan, ku edhe doli në pension.

Cub Ali Cakoni (1895-1969), patriot e i mençur, luftëtar i zoti, i zgjedhur si plak fisi. Ai drejtonte gjyqet pop-



Cub Ali Cakoni

ullore me ndershmëri dhe asnjëherë nuk kundërshtohej për vendimet që merrte. Bujaria e tij ishte shumë më e madhe se "Sheshi i Shpardhes". Sa më shumë miq i vinin, aq më shumë këndonte kur bënte gati pesëdhjetëshet e rakisë-cermë për t'ju falë me fjalët shumë të dashura: „shumë jetë bashkë e mirë se u ka pru zoti".

Qëkur Bardhok Biba kishte bujtur në shtëpinë e Cub Aliut, kryeplakut me influencë në zonën e Bazit, ia kishte kërkuar **Stafën** ta kishte me vete. Stafa njihet si aktivist i shquar i rinisë në Mirditë. Pas vrasjes së Bardhok Bibës, inkuadrohet në radhët e Ushtrisë. Kapiteni i Parë **Stafë Cakoni** (1929-1997) e mbylli jetën si një ush-



Stafë Cakoni

tarak i rangut të lartë me dinjitet dhe karizëm të rrallë.

Tana, bashkëshortja e Cubit ishte bijë e familjes së nderuar karicjane Hysaj (Barlaçaj). Vëllau i saj Hysë Dikë Hysa i rënë në frontin e luftës në betejën e Kakarriqit të Shkodrës kundër hordhive malazeze e serbe është përjetësuar në këngë nga populli. Vëllau tjetër i Tanës Rama, u burgos nga fashistët italianë në Shkodër e në Gjirokastër.

(vijon në faqen 21)

Fortifikimet mesjetare dhe të dhënat arkeologjke të paraqitura më lart, dëshmojnë se gjatë epopesë Skënderbejane, rritet ndjeshëm numri i vendbanimeve dhe fortfikimeve ushtarake, dukuri që përputhet me burimet historike, sipas të cilave, Dibra, shëndrohet në këtë periudhë në një rajon strategjik të luftrave çlirimtare të popullit shqiptar

Të dhëna arkeologjike mbi disa fortifikime të periudhës së Skënderbeut në rajonin e Dibrës

(vijon nga faqja 9)

7. Edhe njëherë mbi lokalizimin e Vajkalit

Në fushën e Vajkalit brenda 5 muajve të vitit 1465 janë zhvilluar dy beteja të përgjakshme midis ushtrisë shqiptare të drejtuar nga Gjergj Kastrioti Skënderbeu dhe ushtrive osmane. Në betejën e parë (prill 1465), Sulltani Mehmeti II, dërgoi kundër Skënderbeut një ushtri prej 15.000 kalorësish dhe 3000 këmbësorësh, nën komandën e Ballaban Pashës (Baderës)[105], ndërsa ushtria e Skënderbeut përbëhej vetëm nga 4.000 kalorës dhe 1.500 këmbësorë[106]. Sipas Barletit Skënderbeu *"kishte zgjedhur gjithë veteranët dhe lulen e rinisë, në trimërinë e të cilëvet kishte shumë besim"*[107]. Po sipas Barletit,*"Kampi i skënderbegasvet ishte në një luginë të këndshme dhe të hapët, që zgjatej përpara dhe që e kish emrin Valkali"*[108], ndërsa ushtria osmane i *"kishte ngritur çadrat nga ana tjetër e luginës, pranë një mali, i cili i jepte fund Valkalisë dhe nëpër të cilin kalohej përmes grykash e ngushticash."*[109]. Beteja ishte e ashpër dhe e përgjakshme. Ajo u fitua prej Skënderbeut, edhe pse me humbje të mëdha në forca njerëzore. Përveç qindra ushtarëve, nga kampi i Skënderbut ranë në fushën e betejës edhe komandnti i përgjithshëm i ushtrisë, Moisi Golemi ose "*Moisiu i Dibrës, më i dashuri dhe më besniku për Skënderbenë"*, dhe 7 komandantë të tjerë të shquar, gjegjësisht "*Gjuric Vladeni* (Vladan Gjurica)*, që kishte lidhje gjaku me Skënderbeun, Muzaka i Angjelinës* (Muzakë Arianiti)*, nip prej motre i Skënderbeut, Gjin Muzaka, Gjon Perlati, Nikollë Berisha, Gjergj Kuka dhe Gjin Maneshi, të cilët me vdekjen e tyre e bënë Arbërinë më të përlotur se ndonjëherë më parë"*[110]. Në betejën e dytë të Vajkalit të gushtit 1465, ushtria osmane kishte 20.000 kalorës dhe 4.000 këmbësorë dhe ajo e Skënderbeut 8.000 kalorës dhe 4.000 këmbësorë[111]. Disa nga komandantët e kohortave të ushtrisë së Skënderbeut, në këtë luftë ishin: Tanush Topia, Zaharia Gropa, Pejko Manueli etj. Po sjellim disa rreshta të Barletit mbi këtë betejë: "*Ndërmjet Skënderbeut dhe Ballabanit ia nisi një përleshje shumë e madhe. Kërdia e burrave nga të dy palët po bëhej e pazakonshme. ....Më në fund, kur e pa se fitorja ishte padyshim e epirotëve (shqiptarëve) dhe se nuk mund t'i bënte ballë betejës, ai (Ballabani) i dha kalit dhe ia mbathi sa mundi më shpejt dhe gjithë ushtria, gjithë rradhët, të përziera dhe të ngatëruara, muarrë arratinë, duke u shpërndarë sa andej këndej nëpër luginë, nëpër fushë e nëpër male.* Të paktë *qenë ata që.....mundën të dilnin gjallë....gjithë barbarët (turqit) e tjerë ose u vranë, ose u zunë të gjallë"*[112]. Kjo betejë përfundoi me fitoren e ushtrisë shqiptare dhe shpartallimin e turqëve dhe të renegatit B. Pasha (Badera) dhe rikonfirmoi pathyeshmërinë e Skënderbeut dhe vazhdimin e qëndresës antiosmane të shqiptarëve.



Fig. 38. Pamje nga fusha e Vajkalit (Bulqizë)

Lokalizimin e Vajkalit, e ka bërë vetë M. Barleti, kur shkruan mbi betejën e parë të Vajkalit, midis Skënderbeut dhe renegatit B. Pasha (Badera): "*Kampi i skënderbegasvet ishte në një luginë të këndshme dhe të hapët, që zgjatej përpara dhe që e kish emrin Valkali"* ndërsa ushtria osmane i *"kishte ngritur çadrat nga ana tjetër e luginës, pranë një mali, i cili i jepte fund Valkalisë dhe nëpër të cilin kalohej përmes grykash e ngushticash."*[113] *(fig. 38)*. Në kohën tonë ky lokalizim është mbështetur nga H. Ceka-J. Adami[114] dhe në pikëpamje gjuhësore është argumentuar nga E. Çabej, që ka shënuar se *"forma më e vjetër e tij duhet të ketë qenë Valkal, Valchalia (te Marin Barleti (1537), emri i një lugine në krahinë të Dibrës, që përbën rrugë kalimi", emër si "luginë, udhë, rrugë kalimi", që mund të ketë ardhur prej latinishtes "vall(is) callis "luginë, rrugë"*[115]. Ndërkaq, O. Schmitt e vendos atë në fshatin Valikardhë, fqinjë lindor i Vajkalit[116]. Një pikëpamje krejt të ndryshme ka shfaqur K. Biçoku, që mendon se Vajkali duhet vendosur diku në lindje të Ohrit, hipotezë e pasqyruar edhe në Historinë e Shqipërisë të vitit 2002[117]. Sipas tij, emri *Valkal-Vajkal* rrjedh nga bashkimi i emrave *"val" dhe "kal"* dhe do të thotë *"luginë e kuajve"*, toponim që u dashka lokalizuar diku në lindje të Ohrit, ku *"kishte bar të bollshëm për të ushqyer kafshët"*[118](!), mendim i përsëritur edhe në një botim të kohëve të fundit[119]. Argument i pakundërshtueshëm i lokalizimit të betejës së Vajkalit në Vajkal, është pa dyshim vetë fshati Vajkal dhe Fusha e Vajkalit, si dhe përputhja e plotë e tyre me Vajkalin e përshkruar nga M. Barleti. "Kulla e Skënderbeut" e ndërtuar mbi luginën e Vajkalit, në kontroll dhe mbrojtje të luginës së Vajkalit dhe të "Rrugës së Arbërit" që kalonte përmes saj, është padyshim një argument i ri që e përforcon identifikimin e Vajkalit në Vajkal. Në të mirë të këtij identifikimi flasin gjithashtu edhe një varg toponimesh nga gjeografia historike, si "Vajkal", "Fusha e Vajkalit", "Valikardhë", "Fusha e kalasë" (Valikardhës), "Shkëmbi i kullës së Skënderbeut", "Kulla e Skënderbeut", "Çardaku i Skënderbeut", "Liqeni i Skënderbeut", "Përroi i Skënderbeut", "Gurra e Kuqe", "Gurët e Skënderbeut"[120] etj. Fortifikimet mesjetare dhe të dhënat arkeologjke të paraqitura më lart, dëshmojnë se gjatë epopesë Skënderbejane, rritet ndjeshëm numri i vendbanimeve dhe fortfikimeve ushtarake, dukuri që përputhet me burimet historike, sipas të cilave, Dibra, shëndrohet në këtë periudhë në një rajon strategjik të luftrave çlirimtare të popullit shqiptar, nën udhëheqjen e Heroit tonë kombëtar, Gjergj Kastriot Skënderbeut. Kërkimet e ardhshme arkeologjike, do të sjellin, pa dyshim, të dhëna më të plota mbi fortifikimet e periudhës së Skënderbeut edhe në rajonin e Dibrës.

REFERENCA

105 Barleti (1537), 1964, XI, 449.
106 *Idem,* 449.
107 *Idem,* 449.
108 *Idem,* 450.
109 *Idem,* 450.
110 *Idem,* 451.
111 *Idem,* 458-459.
112 *Idem,* 462.
113 Barleti (1537), 1964, XI, 450.
114 Ceka- Adami 1951, 3:"Valchalia. I përgjigjet plotësisht Vajkalit. Ngushtica në njerën anë ka një kodër të ultë me mbeturina muresh me llaç, që quhet "qytet", dhe në anën tjetër shkëmbin e pangjitshëm "Kulla e Skënderbeut".
115 Çabej 2008, 587.
116 Schmitt 2014, 171.
117 Biçoku 2002, 449-450. Paraqitja e pikëpamjes individuale dhe subjektive të një studiuesi, si mendim zyrtar dhe i institucionalizuar i historiografisë shqiptare, është sipas pikëpamjes tonë, i gabuar dhe jo në përputhje me kriteret shkencore të botimeve institucionale. Në një botim zyrtar, kërkohet më së paku, të paraqiten dy hipotezat e ndryshme mbi lokalizimin një vendbeteje apo lokacioni historik, dhe jo të paraqitet si e mirëqenë vetëm njera prej tyre dhe të injorohet mendimi i kundërt, siç ka ndodhur në këtë rast, aq më tepër, kur alternativa e dytë është, sipas bindjes sonë, krejtësisht e vërtetë.
118 Për më tepër po citojmë autorin e kësaj hipoteze: "*Kur përshkruan Valkalin, M. Barleci tregon se ishte luginë pranë malit Bigë (Furkë), emër mali e vargmali ky në lindje të qytetit të Ohrit....Vetë M. Barleci ka treguar se Valkali ishte luginë, prandaj ai toponim i latinizuar është i përbërë nga dy fjalë (Val dhe Kal), prej të cilëve, e para me siguri shqipërohet "luginë" dhe e dyta lidhet me "kalë". Të dyja së bashku zbërthehen në shqip ""Lugina e Kuajve". Ky emër dëshmon se në këtë luginë kuajt e ushtrive çlodheshin dhe se aty kishte bar të bollshëm për të ushqyer kafshët*". Krhs. Biçoku 2006a, 81-82; Biçoku 2006b, 82.
119 Biçoku 2016, 163.
120 Në vendin e quajtur "Gurët e Skënderbeut", në skajin jugor të luginës së Vajkalit, me datë 27.05. 2017 është vendosur monumenti i Gjergj Kastrioti Skënderbeut, në kujtim të dy betejave të Vajkalit të udhëhequra dhe të fituara prej Heroit tonë Kombëtar. Monumenti ka lartësi 3.00m dhe gjërësi 2.50m. Është punuar nga studenti i skulpturës nga Vajkali, E. Balja (fig. 39). ***Veprimtaria u organizua nga shoqata "Bulqiza" me kryetar z. Bashkim Lami, me bashkëpunimin e z. Azis Keta, Asllan Daxha, Sami Curri, Geri Emiri si dhe një grup i biznesit vendor.***

100 vjet në luftë për liri dhe dinjitet kombëtar

(vijon nga faqja 21)

* * *

Fashizmi nuk mund tua falte shpirtin antifashist të tyre. Komunizmi nuk mund tua falte shpirtin atdhetar dhe prozogist burrave e grave të nderuar të familjes së madhe Cakoni. Miqësia e tyre shtrihej që nga Elbasani e deri në Shkodër. Autoriteti i Derës së Cakonëve përbënte gjithnjë rrezik të papërballueshëm për falsifikatorët e historisë dhe shkelësit e interesave kombëtare, vrasësit e tradhtarët e idealeve patriotike të Shqipërisë Etnike.

Në vitet e komunizmit në Baz, Partia Komuniste gjithmonë nxirrte dyzina me "armiq të klasës". Të kufizuar, të anatemuar e përgojuar nga një shpurë njerëzish të dobët që zbatonin me fanatizëm një politikë poshtërimi e deformimi të gjithçkaje të vërtetë që lidhej me historinë e familjes Cakoni dhe jo vetëm në Bajrakun e Rranxës.

Kësaj liste nuk i shpëtuan Metë dhe Murat Aliu me të dy bashkëshortet, të cilat ishin bija familjesh nacionaliste në Mat. Për atdhedashurinë dhe patriotizmin e tyre patën si "dhuratë" burg dhe internim të egër. Metë Aliu dhe Murat Aliu u shpallën "armiq të popullit" dhe për çdo gjë të "keqe" që ndodhte në fshat, të parët që i përplasnin burgjeve, ishin pikërisht ata. Nga një persekutim në tjetrin. Fëmijtë e tyre u privuan nga çdo mundësi shkollimi dhe jete aktive sociale.

Profesioni "i zgjedhuri tyre" u mbeti prerja e druve të zjarrit.

Mustë Murat Cakoni, (1928-2011) e kreu internatin shkëlqyeshëm. Ai bashkë me moshatarë të tjerë iu bash-



Mustë Murat Cakoni

kua LANÇ. Por me gjithë prirjet e tij intelektuale, komunistët nuk mund t'i besonin tjetër përveçse të punonte në pyjet e Qafshtamës. Intelekti, libri dhe shoqëria e tij me njerëzit e kulturës e kishin bërë protagonist të mirënjohur në emisionet radiofonike për të kumtuar për historinë dhe traditat e matjanëve në vitet e pluralizmit.

Musta ishtë zëdhënësi i parë në Mat i frymës së demokratizimit të vendit, pas mjerimit dhe dhunës që shkaktoi diktatura pas Luftës së Dytë Botërore. Menjëherë pas formimit në Tiranë më 11 Dhjetor 1990 të Partisë Demokratike, ai kontakton z. Arben Imami dhe merr prej Tij orientimet për afrimin e elementëve në krijimin e Degës së PD në Burrel. Por mentaliteti provincial dhe politizimi i tejskajshëm njerëzve me të cilët u takua në Burrel qe një befasi dhe zhgënjim për Mustën**.**

* * *

A mund të ishin solidarë në drejtimin e punëve për ndërtimin e shtetit të ri pas Luftës djemtë e "armiqve të popullit" që tre breza kishin luftuar me armë në dorë për lirinë e vendit? Aliu, djali i madh i Metës, një burrë i urtë dhe punëtor i palodhur, prind shembullor e i respektuar nga bashkëfshatarët e tij, mbronte me çdo sakrificë autoritetin e një dere të nderuar, së bashku me Zojën, bashkëshorten e tij.

Djemtë e Murat Ali Cakonit ishin edhe nipat e Isuf Hoxhës, ish Sekretar në Prefekturat Kukës dhe Gjirokastër në vitet '30 të shek. XX, në kohën e Mbretit Ahmeti Zogu.

Si mund të shkolloheshin djemtë e nipat e Met Ali Cakonit kur ky ishte skalitur në kanunin e Skënderbeut nga Dom Frano Ilia, apo mik i ngushtë i Abaz Kupit dhe kundërshtari hapur e i drejtpërdrejtë i veprimeve e qëllimeve të komunizmit në Bajrakun e Rranxës, në Mat e Mirditë?

Cakonët vazhdonin që të ishin po kaq patriotë të mëdhenj edhe kur Shqipëria kishte halle të tjera si zhdukja e analfabetizmit dhe nevoja për emancipimin shoqëror.

Komandanti akademist Halil Mehmet Cakoni, i shquar në vitet e luftës NÇL, tërhiqet nga ai front kur njohu drejtpërdrejt qëllimin hileqar e vëllavrasës të komunistëve. Ky erudit mbi rrënojat e shtëpisë së Cubë Bardhok Daçit në Baz hapi shkollën e parë shqipe menjëherë pas luftës. Ndërsa shtëpia e patriotit Cub Aliu në Rreth Baz në vitet e para të çlirimit u bë streha e ngrohtë për mësuesit e fshatit: Haxhi Dan Zhila nga Lezha, Bilal Stana nga Rremulli dhe Rustem Cara nga Laçi i Matit.

As djegia e kullave, as burgjet e vitet e shumta të internimit që bënë burrat e Cakonëve nuk e mposhtën shpirtin liridashës dhe patriotik të tyre.

Varrimin e patriotit Met Ali Cakoni në Baz në vitin 1974 do ta bënin vetëm anëtarët e familjes dhe disa miq të tij nga Kruja. Familjet Llubani, Merlika etj, kishin sjellë me vete ushqimet edhe enët për përgatitjen e vërcallit. Kryespiunë të sigurimit të shtetit si Mëhill Stojani me shokë ruanin në krye të rrugëve për të mos lejuar të merrnin pjesë në funeralin e "armikut të popullit" nipat e mbesat, bashkëfshatarët e miqtë simpatizantë në zonë. Një akt pervers i shëmtimit të një tradite humane, që bie ndesh me çdo kod njerëzor e që njerëzit e gjakut tonë nuk mund ta harrojnë, sigurisht jo si hakmarrje.

* * *

Ndoshta të gjitha gjeneratat u mbeten borxh brezave paraardhës, por brezi ynë i çerekshekullit të XX e pas mendoj se duhet të kujdeset për të vënë në vend kontributet sublime të përbaltura padrejtësisht nga sistemi monist.

Këta protagonistë të nderuar kanë dëshmuar se e kanë patur të shenjtë mbrojtjen e Atdheut, lirisë dhe dinjitetit njerëzor. Kanë sakrifikuar për të lënë gjurmë në histori dhe për t'a patur më të lehtë rrugëtimin jetësor nipërit dhe stërnipërit e tyre.

Po e mbyll këtë shkrim të vonuar (nuk e di se nga ç'arsye) me një shprehje të Met Aliut, thënë që në vitet '50 të shek. të kaluar se "*Komunistët do t'i zejë nata udhës, por unë nuk do të jemë*".

Një e vërtetë profetike kjo e këtij patrioti të mençur.

Autori Jakov Milaj në librin Raca Shqiptare thekson se: "the*sari më i çmuar i një shteti nuk përbëhet prej pasurisë dhe prej mundësive të zhvillimit ekonomik, por prej njerëzve që ai shtet mban në gji, prej shpirtit që u jep gjallëri këtyre njerëzve, prej gjakut që qarkullon nëpër venat e tyre".* ***9)***

Teksa vështrojmë fotot e këtij fisi patriotësh dallohet një gërshetim interesant në simbolikat e tyre në veshje. Tri gjenerata nivelesh arsimimi e veprimi nëpër dekada të ndryshme, që kanë konverguar në një qëllim madhor, në një princip burrëror e fisnik, në atë të luftës për Liri e dinjitet kombëtar.

LITERATURA:

1. *Cakoni Sulejman. "Mati në vitet e pushtimit italian e gjerman" bot. Nacional, 2016*
2. *Elezi M. "Në gjurmë të historisë së Matit" Geer.2005*
3. Ll. Gjini: "Tungjat jeta Rranx' e Dritës"- monografi....
4. Këputa F. Mati në shekullin XX, bot Tiranë 2000
5. Nga biseda gojore të zhvilluara me bashkohës dhe pasardhës të familjarëve.
6. *Dr. Jakov Milaj: Raca shqiptare,(studim antropologjik e historic) bot. IV: Eugen- Tirane 2005,*
7. *Tira N. – "Në strofkat e fundit të armikut".*

REFERENCA:

1) *M. Elezi fq. 87, cituar nga prof. Aleks Buda.*
2) *Po aty fq. 89.*
3) Ll. Gjini: "Tungjat jeta Rranx' e Dritës", monografi.
4) *M.* Elezi *fq. 130*
5) M. Elezi fq. 131
6) *Elezi M. "Në gjurmë të historisë së Matit", Geer, 2005, fq. 136:*
6) *Elezi M. "Në gjurmë të historisë së Matit" Geer, 2005, fq. 136:*
7) Autori Llesh Gjini "Tungjatjeta Rranz' e Drites"
8) *Cakoni Sulejman. "Mati në vitet e pushtimit italian e gjerman" bot. Nacional, 2016, fq.* 17

Rruga e Arbërit nr. 174

In memoriam

Irena Puca, mësuesja e bukur

Nga **ARTAN GJYZEL HASANI**



Edashur Zysh…e dashur zysh Irena…e dashur Irenë…e dashur….

Më është e pamundur që fjala "e dashur" të mos jetë gjithnjë pranë emrit tënd. Besoj se kjo është letra e parë që ti merr pas vdekjes. Të paktën kështu dua të besoj në këtë ditë të parë të Ikjes tënde atje Lart...

Hedh një vështrim pas dhe kuptoj që e tërë jeta jote ka qenë një letër e gjatë dashurie për njerëzit.

Dashuri për familjen, nxënësit e tu, për kolegët dhe banorët e qytetit verilindor të Blinave, dhe për vetë atë qytet ku të hodhi destini i jabanxhiut.

Një letër dashurie që të paktën një herë në jetën e tij kush të njohu mendoi se i është drejtuar atij vetë. Dashuria jote për njerëzit me të cilët të lidhi jeta dhe puna ishte religjioni yt.

Dhe dashuria i bën të bukur njerëzit. Ata që e japin dhe ata që e marrin. Bukuria është dashuri, Zysh, dhe ti ishe E Bukura! Mësuesja me të cilën binin në dashuri të gjithë nxënësit e saj. Djem e vajza. Të parët shihnin te ty modelin e vajzës që do të donin të kishin në jetë, të dytat modelin se si donin të bëheshin.

Isha nxenesi yt i preferuar dhe nuk e di nese ne vendin tend do kishte qene nje mesues tjeter une do ta beja edhe ate krenar sic te beja ty. Diten kur ti Zysh u shfaqe ne klasen tone te anglishtes per here te pare une kuptova qe nxenesit kane nevoje jo vetem per mesues te mire, por edhe te bukur.

Nje dite nxenesi u rrit, nuk e pa per shume vite Zyshen e tij, por kudo që më hodhi jeta dhe fati nëpër botë dita e 7 marsit fillonte me telefonatën "Gëzuar, Zysh!" Për shumë vite me radhë dëgjoja në shkodranishte zërin tënd të ëmbël si lirikat e Mjedës në atë datë të shënuar.

"Ti zysh ke qenë dashuria ime e parë", të rrëfeva para disa vitesh, ndërsa flisnim në telefonatën tonë të radhës. Ti qeshe me zë të lartë dhe unë nuk e dija nëse duhet të heshtja apo të vazhdoja rrëfimin e mëkatit tim fillestar.

"Është kaq e bukur kjo që po ndodh brenda meje në këto çaste, Tanush! Është vërtet kaq e bukur! Kjo është poezia jote e munguar për zyshën!", ma ktheu zëri yt.

Mbaj mend herën e fundit që të pashë. Njëzet e ca vjet më parë. U lumturove kur të telefonova e ta bëra surprizë ardhjen time: "Zysh, ma hap derën!" Dera u hap dhe u gjënda në përqafimin tënd. Thinja argjendi të hijeshonin fytyrën e bukur. Duke të pranuar në gjirin e saj pleqëria ishte fisnikëruar më shumë nga sa e meritonte. Ndjeva të njëjtin emocion si atëhere kur isha fëmijë e ti më quaje "keci im i vogël".

Kaluan shumë vite të tjera pa u takuar dhe në një nga 7 Marset tonë të fundit më the :"Më pëlqeu shumë poezia jote "O grua e bukur!" Fatlume gruaja që i kushtohet ajo frymëmarrje cerebrale vargjesh. Në fakt mua m'u mbajt fryma, ndërsa e lexoja..."

"Është shkruar për ty, Zysh. Ti je ajo grua e bukur e atij qyteti të vogël...", t'u përgjigja unë.

"Epo atëhere nëse është kështu, kjo poezi është më e bukur nga sa kam qenë unë, Tanush! Qënka e thënë që unë të lumturohem veç nga ty në këto vite të fundit të jetës. Por ah, zemra ime...Zysha është plakur shumë dhe jam e sëmurë"

"Zysh...ti gjithmonë je e bukur..."

"Mire...Përderisa ne nuk mund të kishim bashkë sekrete të mëdha, kjo poezi le të jetë sekreti ynë i vogël...", tha zëri yt dhe qeshëm përsëri të dy.

E dashur Zysh! Kam përshtypjen që atë poezi e kam shkruar përgjatë gjithë jetës, kur si nxënës të adhuroja buzëqeshjen, dashurinë dhe përkushtimin tënd për ne vocrakët e shkollës, si adoleshent të ëndërroja bukurinë e fytyrës, trupit, dhe të ecurën tënde që nuk i ngjasonte asnjë gruaje tjetër që njihja, si i rritur kuptoja bukurinë e shpirtit, rrezëllimin aristokrat të krejt qënies tënde dhe atë mirësi tronditëse sipas së cilës në parajsë modelohen ëngjëjt...

Sot sekretit tonë të vogël unë po i jap krahët e dashurisë tënde, Zysh Irena, të bëhet ëngjëll në fluturimin e vet atje lart për te ty...

Vallë kush i mbron ëngjëjt?

A kanë edhe ata ëngjëjt e tyre mbrojtës?

Ti tani je në rrugëtim dhe nuk ka kush t'u përgjigjet këtyre pyetjeve...

Por në pranverë, në të gjitha pranverat e vrullshme të botës, ka ca mëngjese që, pasi ledhatohen nga mjergullat, u dorëzohen avujve të ngrohtë të dheut dhe mbeten pezull mes rrezeve të diellit. Koha ndalon dhe bëhet heshtje. Nuk pipëtin asgjë. Një qetësi madhështore ku mund dëgjohet vetëm çelja e sythave dhe dhimbja e lëkurës së blinave teksa rriten. Dhe atëhere unë do të kuptoj që, prej atje Lart ku ndodhesh, je duke iu përgjigjur letrës sime të parë...

O GRUA E BUKUR!

një kopsë e zbërthyer në këmishën e qiellit
dhe diellit i merret fryma mes gjinjve të tu...
...sa herë që ti hap buzët
xhindet dalin nga shishja
bota harron dy dëshirat e tjera
dhe qiejt lëkunden...
sa herë që ti gëlltitesh
burrat e qytetit zvogëlohen
dhe hija jote mbars me hiret e tua
cigaret që nuk dinë ku t'i shkundin...
sa herë që kohën vret me ne
vend varri për të nuk ka...
në orën e madhe të retinës tënde
akrepat dëshmojnë vetminë tonë...
por dikur mund të të mbarohen vështrimet,
dhe... o Zot...
ajo ditë mos ardhtë kurrë,
bëje të jetë natë...
se kush do t'ia fshijë pluhurin qytetit shëndetlig
nga vitrinat bosh të syve...?
ti zhvishesh
dhe qyteti mërdhin...
pastaj ti fle
dhe qyteti humbet gjumin...
o grua e bukur!

In memoriam

Agim Krajka: Amerika për mua është vetëm Shqipëria

Nga **ALBER ZHOLI**



Nëse gjithmonë e gjen tek "Lemza", lokali i tij i cili ka emrin e këngës së tij të parë në Festivalin e Radios, sot e takova në prezantimin e librit të poetes së talentuar Zhuliana Jorganxhi. Sipas tij "Lemza" është emër i veçantë, pasi kudo shikon që janë mbushur lokalet me lloj -lloj emrash të huaj, emra të çuditshëm që nuk i merr vesh kush. "Lemza" është i veçantë, ka një histori të bukur në këngë dhe me krijimtarinë e tij, pasi në Festivalin e Këngës së muzikës së lehtë në vitin 1961 ai mori pjesë me këngën "Lemza" e cila u këndua nga e madhja Vaçe Zela. Tek ky klub para pandemisë mblidheshin miq, shokë, të afërm. Tani takimet janë rralluar paksa. Këngëtarë, kompozitorë etj…i qeshur dhe plot ide ai se ndal asnjëherë punën. Pas një odiseje rreth 16-vjeçare në Amerikë, në vitin 2006 u kthye përfundimisht në Shqipëri në Tiranë, aty ku ka bërë epokë në muzikën e lehtë shqiptare. Para disa kohësh në koncertin Gala "Të gjithë e duan Agim Krajkën", presidenti Ilir Meta i dha artistit të madh dekoratën "Nderi i Kombit", e cila u dorëzua në skenën e "ArTurbina" nga ish-Ministrja e Kulturës, Mirela Kumbaro. Krijuesi i "Lemzës" së famshme dhe i dhjetëra këngëve të suksesshme shqiptare, i ka arritur të gjitha, por ai nuk rresht së foluri për këngën shqiptare, muzikën e lehtë dhe për atë polifonike.

-Një jetë me këngën, me kompozime nga më të ndryshmet. Kudo të presin me respekt, si nisi rrugën e bukur të kompozimit Agim Krajka?

Albert, ne bashkë kemi zhvilluar disa intervista dhe tashmë shumë gjëra dihen. Por le ti përmbledh me pak rreshta. Vitet 1960 ishin vitet kur muzika e lehtë mori një hov të madh. Tirana kishte ndikim edhe nga muzika ruse. Atë kohë unë i bija fizarmonikës në një lulishte në Tiranë. Flitet për kohën, apo më mirë vitin 1961, kur në Shqipëri kishte hyrë një farë liberalizmi, dhe një shef i Kulturës në Komitetin Ekzekutiv, konkretisht Skënder Gina, i cili më kishte dëgjuar shumë herë më thotë se duhet të hyja në konservator se kisha shumë talent. Unë shtanga. Askush nuk ma kishte bërë këtë propozim. Mbeta i dyzuar. Atë kohë kisha halle të tjera dhe kurrë nuk mund të mendoja për shkollë. Ishte koha kur unë kisha 6 motra në shtëpi, dhe mendoja se si të çoja një lek në shtëpi dhe të ndihmoja familjen. Doja që motrat e mia t'i ndihmoja. Nuk ja vura shumë veshin, por ai këmbënguli disa herë duke theksuar se isha djalë i talentuar dhe duhet të shkollohesha. I nxitur bëra një kërkesë kot pa menduar se çfarë do dilte. Kisha dëshirën vetëm që të vazhdoja punë dhe të çoja ndonjë lek në shtëpi. Dhe ja një mbrëmje, teksa luaja sërish në Bar me fizarmonikë, më vjen një shok dhe më thotë se më kishte dalë emri në liste për të konkurruar. U habita. S'e besoja. Të nesërmen shkova për të parë listën dhe nëse kisha emrin të konkurroja. Po, ishte e vërtetë. Më kishte dalë emri dhe zura radhën për të konkurruar në Konservator (ashtu quhej atë kohë). Për çudinë time fitova dhe a e dini sa isha? Plot 22 -vjeç kur u futa në shkollë. Me ndihmën e profesorëve të mëdhenj të Konservatorit arrita të mësoja shumë.

-Ju kur u futët në Konservator filluat të kompozoni. Po mbas përfundimit të Konservatorit ku u punësuat dhe cili ka qenë kompozimi juaj i parë që edhe sot diskutohet?

Ajo kohë dreqi e kishte një të mirë, sa mbaroje shkollën e lartë ta gjente punën të sigurt, por edhe i mbështeste artistët dhe artin. Në këtë kohë nisa të kompozoja muzikë të vërtetë filmash dhe nisa punë në Ansamblin e Shtetit. Për mua ajo ka qenë shkolla e vërtetë. Ansambli i Këngëve dhe Valleve mbetet institucioni më i rëndësishëm i artit shqiptar. Ato kohë ishin të arta ku ne punonim, krijonim dhe jashtë shtetit lamë gjurmë të pashlyeshme tek spektatorët e shumtë.

Aty kompozova shumë këngë por edhe mësova shumë. Ishte një Konservator i dytë. Mund të them se kam qenë me Ansamblin e Shtetit për 27 -vite, edhe si dirigjent, edhe si kompozitor, edhe si Drejtor. Në atë kohë të ishe pjesë e Ansamblit ishte një vlerësim i madh. Aty ishte ajka e artit shqiptar. Ansambli ynë njihej në gjithë botën. U largova nga Ansambli në vitin 1990 kur më pas shkova në Amerikë. Sot kur e shikoj më vjen që qaj. Legjenda është kthyer në karakatinë. Turp!

-Kur përkon kënga juaj e parë si kompozitor dhe kur keni marrë pjesë në Festivalet e RTSH-së?

Debutimi im i parë në festival ka qenë me këngëtaren e madhe Vaçe Zela. Ajo më dëgjoi tek luaja në fizarmonikë dhe më shtyu të kompozoja një këngë për të. Kështu nisi udha ime. Pra festivali i parë dhe kompozimi im i parë ka qenë kënga "Lemza" dhe është kënduar nga e madhja Vaçe Zela. E kupton çdo të thotë që në daljen e parë si kompozitor të të marrë këngën Vaçe Zela?! E mbaj mend si tani, ka qenë festivali i parë në RTSH, vitin 1962. Vite të çuditshme. Rinia e pëlqeu shumë atë këngë dhe pse menduan se e kisha kopjuar nga këngët e huaja. Të kapte tmerri kur ndalonin një këngë. Të bënin të mendoje thellë. E ndaluan tre muaj dhe njerëzit nisën të shkruanin parulla nëpër mure me emrin "Lemza". Ka qenë një protestë rinore shumë e këndshme. Më pas e lejuan të transmetohej dhe ishte një kënaqësi e madhe për mua. Kjo këngë më hapi shumë dritare. Filluan kërkesat një shikim më ndryshe nga instancat e larta. Fillova të kompozoj sërish. Nuk doja të rrija me aq. "Lemza" më dha shumë energji. Kështu lindi apo kompozova si këngë të dytë këngën e "Gjyshes". Edh kjo këngë u pëlqye, ndoshta jo sa e para, por pati jehonë. Tashmë kisha fituar një siguri në vetvete. Kompozimi i tretë ka qenë "Djaloshi dhe shiu" dhe me radhë në çdo vit.

-Në atë sistem a ke marrë ndonjë çmim të parë në Festivalet e RTSH-së?

Po! E kam marrë kur nuk e besoja. Kështu gëzimi vjen më i natyrshëm. Kur merr një çmim që as e din, as e ke kërkuar, kur ta japin surprizë, ndjen një ngazëllim të brendshëm. Çmimin e parë e kam marrë në vitin 1986 dhe ishte surprizë e papritur. Sapo isha duke u futur në shtëpi kur spikerja e festivalit, Zerina Kuke po anonçonte çmimet. U dhanë çmimet e treta, nuk u zura me gojë, po ashtu në të dytat nuk u zura në gojë dhe kur dha çmimin e parë ajo tha: çmimi i parë i jepet kompozitorit Agim Krajka. Gëzimi ishte i jashtëzakonshëm. Një klasë mature vjen mbas një orë e gjysmë në shtëpinë time dhe më uron. Kjo ishte kënaqësia më e madhe për mua. Rrija si i hutuar. Befasia më kishte kaluar në çdo qelizë. Momente reflektimi. Puna ishte vlerësuar në heshtje.

-Sa çmime keni fituar në festivalet e RTSH-së dhe si je ndjerë në këto festivale?

Për të qenë i sinqertë nuk jap shifër të saktë por të përafërt. Kam fituar rreth 20 çmime në festivale. Në to kam pasur ditë të paharruara, por dhe ditë të vështira. Gjithë koha e përgatitjes ishte një ankth ishim gjithnjë nën filtër. Komisione dhe juri të pafundme. Ka qenë një jetë profesionale e mbushur me shumë emocion. Në fillim të karrierës kënaqësia më e madhe e imja ishte që këngët më pranoheshin në festival, sepse nuk njihnim njeri dhe s'kishim as miq dhe as shokë. Pastaj kur u futa në valle filloi përgjegjësia. Nuk të falte njeri materiale të dobëta. Edhe përgjegjësia jonë ishte e madhe. Ishim nën presion por edhe shumë të motivuar.

-Festivali i 11-të mbahet mend edhe diskutohet shumë edhe sot. Si e kujtoni atë festival?

Në këtë Festival unë u paraqita me këngën "Kafe Flora burra plot". Ky Festival vërtet ishte për t'u çuditur pasi jo vetëm mes kompozitorëve, këngëtarëve dhe instrumentistëve por edhe në popull kam dëgjuar të diskutohet shumë. Ishte një festival që ndoshta tentoi të thyente disa korniza të kohës, por nuk mundi. Por jo se u bë një gjë e madhe. Krijuesit si gjithmonë ishin cilësorë por edhe veshja edhe instrumentistët edhe ritmi i muzikës, kishte një frymëmarrje më të madhe. Mund të them se ky Festival më i vështiri në jetën time si kompozitor, pasi krijuesi në atë kohë ishte gjithmonë në luftë me atë që do dhe me atë që mund të bëjë. Ishte një kënaqësi kur merrje çmim të parë, por do të prisje se çfarë do të thoshte një tjetër se e kishte të drejtën mbas një jave të qortonte, se mos të bëhej ndonjë plenum etj. Shumë shokë të mi ikën, u syrgjynosën nëpër burgje, u larguan nga muzika, i çuan në fshat me punë në bujqësi, disa i internuan.

Lamtumirë Nderi i Kombit, Agim Krajka!

Më datë 1 mars 2021, u nda nga jeta përfaqësuesi i shquar i komunitetit dibran të Tiranës, Agim Krajka, Mjeshtër i muzikës dhe Nderi i Kombit.

Agim Krajka lindi në Kavajë më 3 maj 1937, nga një familje me origjinë dibrane. Babai i tij ishte i apasionuar pas muzikës, dhe si amator luante në disa instrumente muzikore si violinë, mandolinë, fizarmonikë. Dashuria dhe pasioni për muzikën tek Agimi lindën që në fëmijëri, të cilën ia ushqeu edhe vetë babai i tij Rifat Krajka. Fizarmonika u bë shkak që vajti në Shtëpinë e Pionerit ku filloi të merrej seriozisht me të. Ne dhjetorin e vitit 1959, nën udhëheqjen e dirigjentit G. Avrazi, punoi për 2 vjet për themelimin e orkestrës së RTSH, deri në vitin 1961, duke dhënë disa vepra të arta në fushën e kompozicionit. Në vitin 1963 Agimi fillon studimet për teori e kompozicion pranë Institutit të Lartë të Arteve në Tiranë (sot Universiteti i Arteve). Degën e Kompozicionit e ka kryer nën drejtimin e të madhit Çesk Zadeja. Në vitin 1964 kalon pranë Ansamblit të Këngëve dhe Valleve Popullore, në fillim si instrumentist e më pas si kompozitor e drejtues orkestre.



Veprimtaria e tij muzikore është shumë e gjerë dhe përfshin një periudhë prej tri dekadash. Ka shkruar muzikë në shumë lloje dhe është bërë i famshëm si me muzikën e lehtë ashtu edhe më atë popullore, të përpunuar e orkestrale. Ka kompozuar mjaft pjesë orkestrale për fizarmonikë dhe me qindra këngë të muzikës së lehtë. Ka marrë pjesë në shumë festivale të muzikës deri në festivalet e fundit të pasviteve '90. Që nga kënga e famshme "Lemza", e kënduar nga Vaçe Zela në Festivalin e Parë të Këngës në Radio më 1961; "Djaloshi dhe shiu", kënduar po nga e madhja Vaçe Zela në Festivalin e Dytë në RTSH në vitin 1962.

E veçantë për atmosferën familjare dhe që mbahet mend nga të gjithë është "Kënga e Gjyshes", e kompozuar në vitit 1962 dhe e kënduar nga këngëtare Vaçe Zela.

Thirret në Ansamblin e Shtetit si firzamonicist. Ka patur fatin të punojë me korifenjtë e muzikës klasike shqiptare si: Çesk Zadeja, Tish Dahija, Tonin Harapi, Hamide Stringa. Pas përfundimit të studimeve në vitin 1968 dhe pas një turi artistik një vjeçar në Kinë (1968-1969) me Ansamblin e Valleve të Shqipërisë vazhdon punën si dirigjen. Gjatë periudhëes 1970-1991, me punën e tij si dirigjent dhe kompozitor në Ansamblin e Shtetit, janë realizuar dhe shkruar rreth 500 këngë, valle popullore si dhe pjesë të ndryshme instrumentale të valleve epike dhe lirike popullore. Agim Krajka ka një kontribut të veçantë në muzikën e filmave në kinematografi, duke shkruar muzikën e filmave "Çifti i lumtur", "Zonja nga Qyteti", "Shoqja nga fshati", "Njësiti gueril", "Udha e shkronjave", "Në pyje me dëborë ka jetë" etj. Në vitet 1980 janë shkruar dhe kompozuar dy muzikë baleti nga dora e Agim Krajkës të vënë në skenë nga artisti Skënder Selimi. Gjatë kësaj kohe janë shkruar rreth 70 uvertura të spikatura të muzikës së lehtë shqiptare. Ai është nderuar me mbi 17 çmime të dyta, 3 çmime të treta dhe vetëm një çmim të parë në Festivalin e RTSH të vitit 1987, me këngën "Nuk e harroj", të kënduar nga Irma dhe Eranda Libohova.

TITUJT DHE VLERËSIME PËR ARTISTIN AGIM KRAJKA:

- Në vitin 1984 iu dha titulli "Artist i Meritуar"
- Është vlerësuar gjatë viteve për punën e tij me çmimet si mjeshtër i Klasit të Parë, dhe me pas i Klasit të Dytë, si dhe urdhërin "Naim Frashëri të Klasit të Parë" në vitin 1986.
- Në vitit 2001 shpallet nga Presidentit i Republikës si "Ambasador i Kombit"
- Në vitin 2007, me dekret të Presidentit të Republikes, i jepet titulli "Mjeshtër i Madh"
- Në vitin 2009, me Vendim të Këshillit Komunal të qytetit të Gjakovës në Kosovë, shpallet "Krenaria e Qytetit të Gjilanit".
- Në vitin 2011, me vendim të Këshillit të Komunës Dibër e Madhe, Maqedonia e Veriut, shpallet "Nderi i Qytetit të Dibrës".
- Në vitin 2019, nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë z. Ilir Meta, dekorohet me titullin "Nder i Kombit".

SAIMIR SHATKU

Agim Krajka është Dritë që nuk do të fiket kurrë

Nga **KEZE KOZETA ZYLO**

Me hidhërim e morëm ikjen drejt parajsës të kompozitorit, artistit të shquar Agim Krajkës , "Nder i Kombit".

Brezi im është rritur me këngët e muzikës së lehtë të kompozuara nga mjeshtri Agim Krajka.

E kush nuk i mësonte dhe këndonte këngët e Agim Krajkës, shumica e tyre u bënë hite. Sa herë mblidheshim në mbremjet tona festive me nxënësit shumë prej këngëve të tij këndoheshin dhe kërceheshin me shpirt duke filluar me këngën e famshme "Lemza", kënduar nga artisja e madhe e Kombit Vaçe Zela



në Festivalin e Parë të Këngës në Radio më 1961. Kënga përshtatej shumë me rininë e tyre të hershme, me capkënllëqet e moshës, me dashuritë e para dhe të fshehura, me ndonjë papërgatije në mësim. Le të kujtojmë dy strofat e para, në fakt unë duke i shkruar po i këndoj si: "O ra zilja m'nisi frika/ kur mësuesi hyri në mësim/ dhe në vend si s'më ra pika/

Kur ai thirri emrin tim/ Unë asnjë fjalë s'kisha mësuar/ Se mbrëmë në takim isha me ty/

Po nisi lemza e bekuar/ Në d'rrasë të zezë shihja dy sy"…

Ai solli emancipimin në art, në muzikën e lehtë, popullore, të përpunuar e orkestrale. Kontributi i tij në art dhe muzikë përfshin një periudhë prej tri dekadash. Ai është vleresuar me mbi 15 çmime të dyta, 3 çmime të treta dhe vetëm një çmim të parë në Festivalin e vitit 1987, me këngën "Nuk e harroj", të kënduar nga motrat Libohova.

Agim Krajka ishte dhe një idhull si fizarmonist. Ai luante me gishtat në tastierë sikur bënte balet në ajër dhe pushtonte skenën duke sjellë emocione tek dëgjuesit e shumtë.

Edhe këtu në Amerikë në aktivitete të ndryshme i kam dëgjuar shpesh këngët të kompozuara nga Agim Krajka.

Në New York ku na hodhën fatet do të kishim shansin të takoheshim përsëri me Agim Krajkën. Ai jo vetëm që ishte një kompozitor i madh, por dhe njeri, patriot i shquar. Ai është në kujtesën tonë artistike dhe njerëzore. Një ditë Agim Krajka na telefonoi në kolegj në Brooklyn ku punonim të dy me Qemalin. Doemos e mirëpritëm me shumë gëzim telefonatën e tij. Pasi na falënderoi për organizimin me studentët për festën e Flamurit na tha se dëshiroj të vi te marrë pjesë me grupin tim për t'ju përshëndetur ju dhe të huajtë në atë kolegj me këngë shqiptare.Ardhja e tij në festën e Flamurit Kombëtar ishte shumë emocionante, i dha programit më shumë gjallëri dhe art. Agim Krajka shoqërohej nga bashkëshortja e tij, e ëmbla Ami dhe grupi i fëmijëve në violinë dhe piano si motrat simpatike Alba dhe Jona Çano si dhe Albert Stanaj me të motrën e tij të talentuar. Ata sot janë rritur dhe integruar plot kulturë në botën amerikane. Kur artistët e vegjël filluan t'u binin veglave muzikore nën drejtimin e Artistit të shquar Agim Krajka salla u elektrizua dhe filluan të duartrokisnin papushim.

Agim Krajka ishte dhe një orator i shkëlqyer, fjala e tij u dëgjua me shumë vëmendje, mesazhet e tij ishin dritëza shqipërie. Takoheshim në aktivitete të ndryshme me plot respekt dhe mirënjohje. Pas disa muajsh në emër të studentëve të Kolegjit në Brooklyn Qemal Zylo i dha pllake mirenjohje në shkollën shqipe që ishte e hapur në atë kohë në Bronx ku ata debutonin të dy me Amin. Çfarë mirësie buronte nga shpirti i tyre! Agim Krajka jetoi me familjen në New York për 16 vjet pastaj u kthyen përfundimisht në folezën e ngrohtë në Shqipëri që e donte aq shumë derisa dha frymën e fundit. Shpirti i tij do të behet dritë që s'do të fiket kurrë.

Artistët e mëdhenj jetojnë përjetësisht me veprat që lenë pas.

Lamtumirë Agim Krajka, artist i shquar i Kombit!

Rrëmujë. Fshesë. Ankth! Ç'a po ndodh? Kush e kishte radhën…Në festivalin e 11-të me të vërtetë u prit mirë kënga ime, ku u përgëzova nga artdashësit, por arrestuan shumë këngëtarë, shkrimtarë, piktorë, etj, dhe frika ka qenë e madhe. Edhe unë prisja të ndodhte diçka. Kisha një parandjenjë. Kisha një makth që më sëmbonte. Nuk besoja se do dilja pa lagur. Dhe ja, një ditë erdhën në punë dy të rinj dhe më thonë se në orën 11-të duhet të paraqitesha në degën e Punëve të Brendshme në Tiranë. Djersë të ftohta! Por nuk e dhashë veten. Por brenda vetes thashë: "E pat edhe puna ime". Kur ikën të rinjtë doja të qetësoja veten. Shkova tek klubi i punës dhe piva një dopio fërnet. Pasi u ngroha dhe u turbullova pak u nisa për tek Dega e Punëve të Brendshme. Sa shkel tek dera e Degës dy vetë që po më prisnin më thanë: "hë mor ti, çfarë është ajo këngë që na ke bërë?". Shtanga! I pashë me habi. Besoj ata nuk kishin haber fare nga kënga. Por kur pashë kapardisjen e tyre ju përvesha: Çfarë flisni kështu? Si mund ta quani imoralitet një këngë të tillë? Ajo është pogonishte këngë e mirëfilltë shqiptare me bazën në popull. Pra është ajo këngë pogonishte që kërceni ju, unë dhe babai im dhe hyra në zyrën e Kryetarit të Degës. Ai më priti tërë hundë dhe buzë. Rrinte turivarur. Vinte vërdallë dhe nuk më shikonte në sy. Edhe ai më tha të njëjtën gjë. Unë fillova t'i këndoj këngën. E këndoja me zell duke i dhënë atmosferën e pogonishtes. Pasi e këndova ai më tha se çfarë ishte kjo "parru pau" si refren pas fjalëve. Ajo është kthesa, pra kalimi ose përgatitja për strofën tjetër. Kryetari më shikonte me dyshim dhe mosbesim. Tundi disa herë kokën dhe pastaj duke shfryrë më la të lire, por më porositi ta kisha mendjen, se partia më kishte shkolluar. Pra partia më rriti, më shkolloi dhe duhet ta doja. Kur dola nga dera e Degës m'u duk se kisha 20 vjet brenda në errësirë. Ufffff…! shfryva. U lehtësova. Thashë mos do haja ndonjë internim. Pra me një fjalë kjo ka qenë kënaqësia e kompozitorëve shqiptarë. Pra ndjeje fillimisht kënaqësinë e emrit, këngës së re, lëvdatave të njerëzve, por të hidhurat i kishe gjithnjë nga pas. Asgjë nuk kishe të sigurt. Çdo gjë duhej të ishte brenda boshtit të parties, ndryshe… Por kishim dhe shumë momente të bukura, shumë. Jo çdo gjë ishte zi. Kudo na respektonin dhe populli na nderonte dhe na donte shumë. Kudo ku shkonim na prisnin me admirim. Popullin e kishim në çdo hap me vete, sepse populli e donte muzikën tonë dhe na përkrahte. Ndaj mund të them se Festivali 11 ishte një festival i parapërgatitur me qëllim spastrimi siç bëheshin spastrimet dhe në politikë. Ato kishin interesa t'i largonin disa figura nga postet politike. Lufta e bërrylave. Për mua ishte e qëllimshme, se përse i 11-ti duhet të ishte ndryshe nga të gjithë të tjerët. Ne ishim viktima të realizmit socialist. Shumë veta ikën kot, shumë u futën në burgje, u persekutuan padrejtësisht, etj. Këtë solli ky Festival që ka lënë gjurmë të pashlyeshme në historinë e muzikës së lehtë shqiptare.

-Ndoshta ishte kjo varfëri që ju detyroi të merrnit rrugën e mërgimit që në fillim të viteve 1990?

Sigurisht, kjo ishte çështja kryesore. Kjo ishte ajo që më nxiti më shumë. E njihja botën jashtë para shumë të tjerëve, e dija si ishte realiteti. Me kohë blu-aja se si të ikja. Në atë kohë në Shqipëri fukarallëku ishte kthyer në plagë për gjithë shqiptarët, veçanërisht për intelektualët. Duke qenë se unë i kisha kaluar shumë herë kufijtë shqiptarë me turnetë që bënim jashtë me ansamblin, duke prekur të katër kontinentet e njihja mirë jetën jashtë. Sigurisht që para '90-ës nuk kisha menduar ndonjëherë të arratisesha për shkak të frikës nga persekutimi ndaj familjes, por me ardhjen e demokracisë m'u krijuan kushte për t'u larguar. Ditën që u largova nga Shqipëria nuk ika me emocione, sepse ishte thjesht një kontratë e përkohshme për të fituar disa para në New York. Më ofrohej një sasi e madhe parash për një kohë të shkurtër dhe vendosa ta provoja. M'u dha mundësia të shkoja fillimisht në Australi, më pas të shkoja në Amerikë dhe të punësohesha në një lokal me pronarë shqiptarë, si instrumentist. Isha në Amerikë bashkë me tim bir që më ndihmonte duke i rënë pianos dhe baterisë. Tim biri iu desh që të kthehej më shpejt se vazhdonte konservatorin, në vitin e parë. Ka qenë dhjetori i vitit 1991 kur më mori në telefon, një javë pasi ishte kthyer në atdhe, duke më treguar për kaosin që ishte krijuar në vend dhe turbullirat e mëdha që po ndodhnin në Shqipëri. Më thotë se po të rrija në Amerikë do u hapja një dritë jeshile. Me anë të një miku kosovar arrita të gjeja një strehë për familjen time dhe më pas mundësinë për t'i tërhequr. Unë në emigracion shkova 52-vjeç. Më pyeti ime shoqe për emocionet dhe unë i thashë kur ajo mbërriti se, "unë Agim Krajkën e kam lënë në Shqipëri".

Pra fillova një punë shumë të thjeshtë. Punë e thjeshtë ishte, por ishte derivati i profesionit tim. Unë kompozitor u bëra nga fizarmonika. Edhe ushtar kur isha, falë atij instrumenti më mbajtën me hatër dhe më lanë t'i bija vetëm fizarmonikës dhe të përgatisja shfaqjet e ushtarëve. Më pas punova një vit në ansamblin e Ushtrisë dhe më pas në Radiotelevizion. Atje mora pjesë në festivalin e parë ku shkruajta "Lemzën" etj. etj dhe vazhdoi gjithë karriera ime. Unë me të vërtetë mbarova shkollën për kompozitor, por puna e përditshme ishte fizarmonika. Ndaj në Amerikë nuk ndërrova zanatin por pata fatin të çaja në këtë fushë ku kishte vështirësi të mëdha. Atje nuk bëhej muzikë e mirëfilltë, sepse pronarët e lokaleve donin jo muzikën e vërtetë shqiptare, por muzikë tallava. Ato shpesh ishin nga Mali i Zi apo nga Maqedonia dhe njihnin si muzikë shqipe vetëm atë lloj rryme. Me shumë përpjekje arritëm të formonim një grup të mirë me Parashqevi Simakun dhe Morena Rekën. Por dhe ky pati një periudhë të caktuar. Më pas iu ktheva punës në restorante amerikane duke interpretuar këngë italiane dhe detyrimisht muzikë amerikane filmash, këngëtarësh dhe xhaz. Veçanërisht këngët e Domeniko Modunjos që ishin të preferuara në ato lokale. Në restorantet e Neë Yorkut kam punuar rreth 12 vjet duke perfeksionuar më shumë repertorin dhe me muzikë kontemporeane.

Në Amerikë shkova dhe punova me një disiplinë të hekurt, sepse atje punohet ndryshe nga Shqipëria. Thonë shqiptarët që punojnë, por gjatë ditës i pinë nëpër kafene 3 gota me fërnet, kurse në Amerikë ka vetëm punë. Në Amerikë kam punuar gjithë këto vite vetëm për t'i siguruar të ardhmen dy djemve të mi. Ata i shkollova dhe i bëra të zotët e vetes. Nuk fitova asnjë dollar, por nuk mbeta borxh asnjë dollar.

- Agimi dhe Amerika. Për 16-vjet a e ndjetë ndonjëherë peshën e racizmit dhe kur u kthyet në atdhe?

Po kam qëndruar afërisht 16- vjet në emigracion, dhe se ndjeva kurrë, kurrë racizmin. Me thënë të drejtën edhe malli për Tiranën më kishte marrë shumë, shumë. E mbaj mend si sot kur jam kthyer. Ishte viti 2001, kur u bë ai koncerti "E dua më shumë Shqipërinë". Më kishte marrë malli shumë për vendin tim ndaj u përlota shumë.

Atdheu është një ëndërr. Por atë dhjetë vjeçar që kisha qenë larg mendova se gjërat në Shqipëri do kishin ndryshuar. Në kohën tonë të gjithë njerëzit ishin njëlloj, të gjithë të varfër. Kur erdha në Shqipëri kishin mbetur ato disa gjoja profesionistë që nuk dihet nëse kanë bërë ose jo shkollë, sepse kishin devijuar nga muzika e vërtetë. Tirana kishte ndryshuar pak, por kishte mijëra dyqane, pisllëqe, lulishte në qendër dhe më dukej vetja si në Afganistan. Ishin kryer masakra të tëra mbi arkitekturën e kryeqytetit. Dhe tani ka shumë lokale dhe restorante luksoze që nuk dihet se kush i frekuenton.

-Muzika e lehtë shqiptare dhe muzika e deformuar, tallava, mund të na sillni ndryshimet?

Ndryshimet? Së pari nuk kanë asnjë lidhje. Muzika jonë e lehtë ishte qelibar. Tërësisht shqiptare. Të gjithë e donin dhe e respektonin. Ato që hodhën themelet e muzikës së vërtetë shqiptare kanë qenë njerëz të mençur dhe kanë ditur që gjëja më e bukur dhe e rëndësishme e një populli është kultura e tij dhe ia kanë arritur qëllimit. Shqiptarët sot e kanë të drejtën të gëzojnë lirinë absolute por më duket se një pjesë e madhe e saj lufton për disa gjëra më imediate. Ka njerëz që po pasurohen me këtë krim që bëhet në muzikën e sotme shqiptare. Është më i fuqishëm ai që e prish këtë muzikë se ç'mund të jetë një Çesk Zadeja e baballarët e tjerë të muzikës shqiptare! Tek ne kultura kombëtare nuk ka më rëndësi. Për Ansamblin e Shtetit nuk investon askush, për institucionet tjera, gjithashtu. Nuk besoj se ky është arti dhe kultura shqiptare. Sot paratë investohen vetëm tek ato Vipa që vishen e zhvishen nëpër skena, huazimet, drita nalt e poshtë. Kjo nuk është kënga shqipe për mua. Në muzikën shqiptare nuk ka më konkurrencë. Në kohën time vetëm ndonjë kompozitor super i talentuar i pa shkollë mund të shkruante ndonjë këngë, të tjerët, absolutisht jo! Nuk luhej me muzikën, me artin, me atë që na lanë të mëdhenjtë e muzikës shqiptare. E kanë lënë amanet.

- Mbi dy dekada në Shqipëri, mendoni të ktheheni në Amerikë?

Amerika më dha shumë mundësi. M'u gjend në momente të vështira, por tani në moshën time Amerikë për mua është Shqipëria dhe vetëm Shqipëria.

(Marrë nga radiokosovaelire.com. Botohet me shkurtime)

BOTIME TË REJA



Botimet M&B
ISBN: 978-9928-307-56-9
Nr. faqeve: 96
Çmimi: 600 lekë



Botimet M&B
ISBN: 978-9928-307-81-1
Nr. faqeve: 80
Çmimi: 500 lekë



Botimet M&B
ISBN: 978-9928-307-09-5
Nr. faqeve: 128
Çmimi: 800 lekë



Botimet M&B
ISBN: 978-9928-307-11-8
Nr. faqeve: 248
Çmimi: 700 lekë



Botimet M&B
ISBN: 978-9928-307-77-4
Nr. faqeve: 96
Çmimi: 500 lekë



Botimet M&B
ISBN: 978-9928-307-79-8
Nr. faqeve: 120
Çmimi: 500 lekë



www.rrugaearberit.com

Na ndiqni *online*, falë ndihmës së z. Agim Deva, të cilin e falenderojmë për ndihmën dhe përkushtimin.

Informacioni për faqen online: **info@rrugaearberit.com**

Informacioni për versionin e printuar: **rrugaearberit@gmail.com**

Përdor KONTAKT PAGE për pyetje dhe sygjerime.

Shtyp butonin **"NDIHMO EDHE TI"** që gjendet në faqen e parë në versionin online për tu abonuar dhe kontribuar në botimin e gazetës, ose kontakto me redaksinë. Çdo kontribut bëhet publik.

Çdo lloje kontributi shkon në masën 100% në llogarinë e gazetës në Tiranë/Shqiperi në mënyrë të sigurtë përmes PayPal.

Website është një kontribut në shërbim të botimit të gazetës "Rruga e Arbërit", lobimit për ndërtimin e rrugës me të njëjtin emër, që do lidhë Tiranën me pjesën tjetër të Ballkanit në Lindje të Shqipërisë, si dhe zhvillimin e Dibrës dhe krahinave përreth.

Mund të na ndiqni edhe në Facebook duke kërkuar me emrin "Rruga e Arbërit" ose përmes lidhjes:

https://tinyurl.com/lcc3e2f

REKLAMO BIZNESIN TËND

Një faqe e plotë me ngjyra kushton 15000 lekë

Me **1000** lekë mund të rezervosh një reklamë gjatë gjithë vitit në format kartvizite (8x5cm)

NE jemi gazetë e lirë dhe e pavarur nga ndikimi politik. Pavarësia dhe liria jonë garantohet vetëm nga mbështetja e lexuesve...
BËJ PAJTIMIN TËND!

Një pajtim vjetor kushton: **600 lekë.**
Në Europë: **10 Euro.**
Në SHBA dhe vende të tjera: **15 USD**.
Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.

Botimi i gazetës është punë vullnetare, ndaj çdo pajtim vjetor ose dhurim, është i mirëpritur. Dhurimet pranohen vetëm përmes llogarisë bankare që gjendet më poshtë dhe për çdo rast ai do të bëhet publik.
Raiffeisen Bank, Rr. Kavajës, Tiranë. Sëift code: SGSBALTX.
IBAN(ALL): AL44 2021 1219 0000 0000 1003 6640

Bigmarket PESHKOPI

DI ÇFARË ZGJEDH!

GJITHMONË ME OFERTA...